



# **MANUAL PËR DREJTËSINË TRANZICIONALE**

**Konceptet, Mekanizmat dhe Sfidat**

**Prishtinë, *Dhjetor 2015***

# PËRMBAJTJA

Parathënie	8
Histori e shkurtër e konfliktit në Kosovë	9
<b>Kapitulli 1: Hyrje Në Drejtësinë Tranzicionale</b>	<b>11</b>
1. Kuptimi dhe qëllimi: trajtoje të kaluarën për të ndërtuar të ardhmen	11
2. 4 Shtyllat kryesore të Drejtësisë Tranzicionale	12
2.1. Ndjekjet penale	12
2.2. Masat për kërkimin e së vërtetës	13
2.3. Reparacionet	13
2.4. Reforma institucionale: krijimi i besimit në institucionet	14
3. Sfidat e Drejtësisë Tranzicionale	15
4. Një pasqyrë e DT-së në Kosovë	17
4.1. Ndjekjet penale të krimeve të luftës të kryera në Kosovë	17
4.2. Kërkimi i së vërtetës në Kosovë	17
4.3. Reparacionet në Kosovë	18
4.4. Reforma institucionale në Kosovë – ndërtimi i besimit ndaj institucioneve	18
<b>Kapitulli 2: Regjistrimi I Viktimave – Libri I Kujtimit I Kosovës</b>	<b>20</b>
5. Rëndësia e regjistrimit të viktimave dhe të kontributeve të LKK-së	20
5.1. Roli përkujtimor i LKK-së	21
5.2. LKK dhe rimëkëmbja e dinjitetit të viktimave	22
5.3. Përdorimi i LKK-së në ndihmë të viktimave:	22
5.4. Kontributi i LKK-së në ndjekjet penale	23
5.5. Kontributi i LKK ndaj kërkimit rajonal të së vërtetës	23
5.6. Kontributi i LKK-së ndaj pajtimit	23
6. Receta e LKK-së: metodologjia strikte dhe saktësia	24
6.1. Metodologjia dhe formati	24
6.2. Gjetjet e deritashme	26
6.3. Njohja ndërkombëtare e saktësisë së LKK	26
<b>Kapitulli 3: Ndjekja Penale E Krimeve Të Luftës</b>	<b>27</b>
<b>Pjesa 1: Gjykata Ndërkombëtare Penale Për Ish Jugosllavinë (ICTY)</b>	<b>29</b>
7. Mandati dhe juridiksioni i Gjykatës	29
8. Rastet	31
9. Trashëgimia e GJNPJ në Kosovë: të arriturat, kufizimet dhe kritikant	33
10. Përcjellja në vazhdimësi e GJNPJ: gjykimet vendore në Kosovë dhe Serbi dhe komisioni rajonal i së vërtetës	36
<b>Pjesa 2: Gjykimet E Krimeve Të Luftës Të Mbajtura Në Kosovë</b>	<b>38</b>
11. Gjykimet e EULEX-it: shkaku, mandati dhe funksionimi	38
12. Kontributi i EULEX-it për t'i dhënë fund mosndëshkimit: rastet	40
13. Kufizimet e ndjekjeve penale hibride të krimeve të luftës në Kosovë nën Misionin e EULEX-it	40

13.1. Ritmi i ndjekjeve penale, shkalla dhe natyra e akuzave: një ofrim i papërsosur i drejtësisë	41	<b>Kapitulli 5: Nisma KOMRA</b>	<b>81</b>
13.2. Mangësitë e procedurave dhe keqpërdorimi i viktimave	42	24. Qëllimet që ndiqen nga KOMRA	81
13.3. Çështjet në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve	42	25. Koalicioni për KOMRA-n, përkrahja publike dhe pronësia vendore	82
13.4. Kapacitetet vendore ende shumë të pakta	43	26. Miratimi i Statutit të KOMRA-s dhe sfida e përkrahjes politike	83
13.5. Humnera e kredibilitetit	44	<b>Kapitulli 6: Reparacionet</b>	<b>84</b>
14. Gjakata Speciale që do të formohet së shpejti	46	27. Format e ndryshme të reparacioneve që rimëkëmbin aspekte të ndryshme të drejtësisë	84
14.1. Përkundër shumë kritikave ...	46	28. Reparacionet materiale e rimëkëmbin një formë të drejtësisë materiale	85
14.2. Gjakata do të sjellë më shumë drejtësi për viktimat ...	47	28.1. Drejtësia materiale: Drejtësia në konkretësinë e saj	85
14.3. Është siguruar menaxhimi i kujdesshëm dhe masat mbrojtëse!	48	28.2. Varësia e reparacioneve nga regjistrimi i viktimave	86
<b>Pjesa 3: Gjykimet Para Gjykatave Serbe</b>	<b>49</b>	28.3. Rreziqet politike të reparacioneve	87
15. Juridiksioni i krimeve të luftës dhe vendimet e marra lidhur me Kosovën	49	28.4. Frustrimet individuale dhe deprivimi i shkaktuar nga reparacionet	87
16. Vlerësimi i efikasitetit të punës së ZPKL dhe e DKLJL	50	28.5. Kufijtë e kompensimit monetar	88
16.1. Efikasiteti i DKLJL dhe ZPKL: numri i rasteve dhe kohëzgjatja e procedurave	50	29. Reparacionet simbolike: thika me dy teha e memorializimit	89
16.2. Numri i vogël i të akuzuarve kryerës të krimeve të nivelit të lartë	51	29.1. Kontributi i memorializimit për paqen dhe drejtësinë	89
16.3. Hetimet defektuoze, gjykimet kontroverse dhe politika e dënimeve	52	29.2. Keqpërdorimi dhe të metat e memorializimit	90
17. Faktorët, të cilët e pengojnë DKLJL, dhe potenciali i ndikimit të ZPKL	53	<b>Kapitulli 7: Reforma Institucionale</b>	<b>95</b>
17.1. Mungesa e vullnetit politik	53	30. Trajtimi i mangësive individuale përmes procesit të verifikimit	96
17.2. Mungesa e burimeve financiare, njerëzore dhe teknike	54	30.1. Çka është verifikimi: krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut si kriter për reformën institucionale	95
17.3. Bashkëpunimi me Njësinë e Policisë	55	30.2. Karakteristikat e procesit të verifikimit me ndikim në efikasitetin e tij	98
17.4. Bashkëpunimi me UNMIK-un dhe EULEX-in	56	31. Reforma institucionale përtej verifikimit: trajtimi i mangësive strukturale	101
17.5. Çështjet që lidhen me përkrahjen e dëshmitarëve dhe me mbrojtjen e dëshmitarëve	56	31.1. Procesi i reformimit të strukturës së institucioneve publike: integriteti dhe ndërtimi i legjitimitetit	101
18. Shfrytëzimi i trashëgimisë së GJPNJ	57	31.2. Sfidat specifike të Çarmatosjes, Demobilizimit dhe Reintegrimit (ÇDR) dhe Reformat e Sektorit të Sigurisë (RSS)	102
<b>Përfundim: Gjykimet E Domosdoshme, Por Të Pamjaftueshme</b>	<b>61</b>	32. Reforma institucionale në Kosovë	103
<b>Kapitulli 4: E Drejta Për Të Ditur &amp; Komisionet E Së Vërtetës</b>	<b>67</b>	32.1. Besimi publik në institucionet e tyre: kriteri i vlerësimit të reformës institucionale	103
19. Qëllimet e kryera përmes të drejtës për të ditur	67	32.2. RSS në Kosovë: TMK, FSK dhe PK	105
19.1. E drejta për të ditur për zinë individuale: dobitë nga e vërteta	67	<b>Konkluzat E Përgjithshme</b>	<b>107</b>
19.2. E drejta për të ditur dhe për të kuptuar modelin dhe gjerësinë e luftës	67	<b>Burimet</b>	<b>310</b>
19.3. E drejta për të ditur për të parandaluar manipulimet politike	68		
20. Komisionet e së vërtetës: përkufizimi dhe mjetet në dispozicion	68		
21. Anët e forta dhe kontributet e komisioneve të së vërtetës	69		
21.1. KV-të sjellin të vërtetën dhe një platformë për viktimat	70		
21.2. Kontributi i KV-ve ndaj instrumenteve të tjera të DT-së: reformat institucionale, reparacionet dhe ndjekjet penale	71		
22. Kufizimet dhe dobësitë e KV-ve	72		
22.1. Përfitimet e diskutueshme të së vërtetës	72		
22.2. Kufijtë pragmatik lidhur me atë se çka mund të arrijnë KV-të	73		
22.3. Kufijtë e drejtësisë restorative dhe çështja e amnistive	74		
22.4. Çështjet e mandatit dhe të mjeteve: nuk ka recetë të përsosur për sukseset e KV-ve	76		
23. Udhëzime për sukses: rëndësia e komplementaritetit	78		

## PARATHËNIE

Një manual i tërë mund të shkruhet për secilin aspekt të ndërmarrjes së Drejtësisë Tranzicionale (DT) me qëllim që të jetë plotësisht shterues dhe që të mbulojë të gjitha aspektet e debateve që janë bërë lidhur me çështjen. Ky ese, para së gjithash, kërkon, duke zhvilluar një shqyrtim teorik të kërkimeve ekzistuese mbi DT, për të vënë në pah gërshetimin e ideve dhe të koncepteve të caktuara, përmes ekzaminimit të të gjitha objektivave të DT-së si dhe të të gjithë mekanizmave përkatës për t'i arritur ato objektiva. Qëllimi i këtij manuali është që të jetë pikë reference për të kuptuarit e asaj se çka është DT, çka përfshin ajo, cilat janë sfidat dhe grackat e saj dhe – edhe më e rëndësishme – përse është thellësisht e rëndësishme për të trajtuar të kaluarën në shoqëritë post-konfliktuale. Përmes katalogjizimit të instrumenteve të ndryshme në dispozicion, ajo shpreson për të treguar se si ato ndërveprojnë njëra me tjetrën si dhe për të dëshmuar karakterin e tyre komplementar. Përveç kësaj, ndërsa Kosovën e ka fokus qendror, ky dokument shfrytëzon disa shembuj të ndryshëm historik me qëllim që të vë në pah si vlerat universale të trajtimit të së kaluarës, ashtu edhe rëndësinë thelbësore të implementimit kontekstual dhe të ndjeshëm të DT-së, duke shmangur standardizimet dhe qasjet e një mase të përshtatshme për të gjithë. Derisa kjo vepër paraqet opsionet më parë se sa që siguron një gjykim, sidoqoftë, ajo është e frymëzuar nga kërkimet e mëhershme të autores mbi DT-në dhe ndërtimin e paqes dhe është ideologjikisht afër një vepre të mëhershme të publikuar lidhur me këtë çështje, duke përfshirë këtu ato të Mani-it dhe të Lambourne-s, të cilët evokojnë si alternativë modelet e DT-së.<sup>1</sup>

*Lorraine Degruson*

<sup>1</sup> Degruson (2014)

## HISTORI E SHKURTËR E KONFLIKTIT NË KOSOVË<sup>2</sup>

Drejtësia Tranzicionale (DT) është e interesuar për pajtimin midis ish armiqve; së këndejmi, është e dobishme që të shikohet në historinë e Kosovës për të kuptuar marrëdhëniet midis komuniteteve shqiptare dhe serbe, të cilat përfundimisht kanë çuar deri te lufta. Është, madje, edhe më e rëndësishme, megjithëkëtë, për t'ia hedhur një shikim historisë më të fundit, në veçanti zhvillimit të luftës dhe dëmeve të mëdha të shkatërrimeve të luftës tek të dyja palët, gjë që thellësisht i arsyeton përpjekjet e DT-së.

- **Një luftë shekullore**

Lufta midis asaj se kujt i takon Kosova daton që nga gjurmët e para të jetës në rajon. Historia e Kosovës, e vështruar nga elita serbe dhe shqiptare, në masë të madhe mbështetet në dy mite të kundërta propagandistike, të cilat i kanë frymëzuar për të luftuar për kontroll të rajonit disa herë gjatë historisë. Derisa konteksti i këtillë është substancial për të kuptuarit e konfliktit, është po ashtu krejt e dorës së dytë, krahasuar me zhvillimet më të reja në rajon, se ku versionet selektive të historisë të të dyja palëve kanë siguruar një truall të frytshëm për politikanët oportunist për të shfrytëzuar pakënaqësitë dhe frikën si dhe për të nxitur intolerancën, militarizimin dhe, përfundimisht, luftën. Derisa tensionet midis komuniteteve kanë qenë të zbutura gjatë sundimit të Titos, pas vdekjes së tij nacionalizmi ka lindur anë e kënd Ballkanit, duke çuar deri te manipulimi politik i masave nga elitat (në Kosovë kjo është bërë nga politikani Slobodan Millosheviq). Shqiptarët në Kosovë kanë protestuar kundër represionit në rritje të ushtruar ndaj tyre, fillimisht në mënyrë paqësore, dhe, nga viti 1996 edhe me dhunë – me krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që ka filluar revolucionin e saj me anë të vrasjes së udhëheqësve policor dhe paramilitar serb si dhe të shqiptarëve, të cilët bashkëpunonin me regjimin që, si rezultat i kësaj, ka shpënë deri te një hakmarrje e ashpër.

<sup>2</sup> HRW (2001)

- **Lufta për pavarësi**

Forcat serbe janë përgjigjur me masa të ashpra, duke kryer abuzime, siç janë hakmarrjet arbitrare për shkak të sulmeve të UÇK-së, rrahje të rastit në vende publike dhe sulme që cak i kishin politikanët shqiptarë. Kjo kishte arritur një shkallë të lartë në fillim të vitit 1998 me sulmin në rajonin e Drenicës, që karakterizohet nga shenjëstrimi pa dallim i civilëve. Këto masa kishin për qëllim për ta shtypur revoltën, por, në vend të kësaj, ato kishin shkaktuar radikalizimin e popullatës shqiptare, duke i zgjeruar radhët e UÇK-së, kapacitetet e së cilës po ashtu ishin rritur nga futja e papritur e armatimeve që vinin nga Shqipëria në vitin 1997. Në datën 28 shkurt të vitit 1999, luftimet në Kosovë zyrtarisht ishin shndërruar në një 'konflikt të brendshëm të armatosur', prag ky sipas të cilit forcat ndërluftuese në të dyja anët duhej të respektonin rregullat e mbrojtjes themelore të Ligjit të Luftës.<sup>3</sup> Megjithatë, asnjëra prej palëve nuk i respektonte ato rregulla. Grabitjet, vrasjet dhe shkatërrimet kanë qenë të shpeshta dhe janë kryer nga forcat e rregullta dhe paramilitare në të gjitha rajonet, si nga forcat serbe, po ashtu edhe nga UÇK-ja. Ç'është e vërteta, derisa shkeljet e forcave serbe ishin më të mëdha në numër dhe në shkallën e tyre, UÇK-ja po ashtu ka kryer shkelje të rënda të Ligjit mbi të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare (LDHN) gjatë luftës, posaçërisht me anë të marrjes së pengjeve, ekzekutimeve jashtëgjyqësore dhe dëbimit të qytetarëve serb dhe shqiptarë nga shtëpitë e tyre. Masakra e Obrisë së Epërme në muajin shtator të vitit 1998 dhe masakra e Reçakut e muajit janar të vitit 1999 kanë qenë përfundimisht një katalizator i një përgjigjeje të Bashkësisë Ndërkombëtare deri atëherë të përçarë, e cila e ka organizuar Konferencën e Rambujesë në muajin shkurt të vitit 1999 me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje paqësore të konfliktit. Ngaqë bisedimet për paqen kishin dështuar, atëherë kishin filluar sulmet ajrore të NATO-s në datën 24 mars. Pas një fushate të gjatë ajrore prej 77 ditësh, lufta në Kosovë ka përfunduar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës në datën 9 qershor të vitit 1999.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Në veçanti, ato që sigurohen me anë të Nenit të Përbashkët 3 të Katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, Protokollit II të këtyre Konventave, dhe rregullave zakonore të luftës.

<sup>4</sup> Roberts (1999)

## KAPITULLI 1: HYRJE NË DREJTËSINË TRANZICIONALE

### 1. Kuptimi dhe qëllimi: trajtoje të kaluarën për të ndërtuar të ardhmen

Drejtësia Tranzicionale (DT) është, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, një formë e drejtësisë e përshtatur për shoqëritë në transformim pas një faqeje të errët të historisë së tyre, që kërkojnë për të trajtuar të kaluarën me qëllim që ajo më kurrë të mos përsëritet.<sup>5</sup> Është një kornizë – ose një model i praktikave - për trajtimin e trashëgimisë së mizorive masovike dhe abuzimit me të drejtat e njeriut në shoqëritë, të cilat ndodhen në shërim e sipër nga konfliktet. DT ka dy aspekte: është një prapavështrim (ajo trajton ngjarjet e së kaluarës), por, po ashtu, edhe shikim përpara ngaqë ajo synon për të parandaluar përsëritjen e tyre. DT mund të përfshijë masa llojesh të ndryshme, siç është ndjekja penale (drejtësia retributive), reparacionet, kërkimi i së vërtetës (drejtësia restorative), memorializimi (përmes monumenteve, ceremonive, festimet, deklaratat publike etj.), dhe reformat institucionale (siç është verifikimi). Kjo larmi e instrumenteve ilustron larminë e qëllimeve të DT-së: për të siguruar përgjegjësinë penale dhe për të garantuar llogaridhënien, për të sjellë rivendosjen e së drejtës/reparacioneve për viktimat, për të ofruar të vërtetën e përbashkët lidhur me atë se çfarë ka ndodhur, për të promovuar pajtimin individual dhe kombëtar, për të promovuar mundësitë për paqen afatgjate dhe për të avokuar sigurinë dhe zhvillimin e qëllimeve (siç është Çarmatimi, Demobilizimi dhe Reintegrimi si dhe adresimi i pabarazisë socio-ekonomike) si dhe sundimin e ligjit. Të gjitha këto qëllime janë të prira për të trajtuar të kaluarën dhe për të ndërtuar të ardhmen.

<sup>5</sup> Davis (2014)

## 2. 4 Shtyllat kryesore të Drejtësisë Tranzicionale

Ashtu siç tashmë e pamë, ekziston një zgjedhje e gjerë e instrumenteve të DT. Ato mund të ndahen në 4 shtylla kryesore.

### 2.1. Ndjekjet penale

Ato mund të marrin forma të ndryshme. Ato mund të jenë ndërkombëtare, siç janë ato për gjykimet e mbajtura në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë (GJNPJ), Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ruandën (TNP) ose Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJNP). Ato mund të jenë lokale, siç është Dhoma e specializuar për Krime të Luftës e Gjykatës së Qarkut të Beogradit ose Departamenti për Krime të Luftës brenda Gjykatës Shtetërore në Bosnjë. Ato, po ashtu, mund të jenë hibride, me elemente të përziera ndërkombëtare dhe kombëtare, si në Gjykatën Speciale të Sierra Leones (GJSSL), ose gjykimet e mbajtura nga Misioni i Sundimit të Ligjit të EULEX-it i BE-së (EULEX) në Kosovë.

Rëndësia e ndjekjeve penale pas konfliktit rrjedh nga disa vëzhgime. Së pari, ndëshkimi i kryerësve e mundëson përforcimin e kulturës demokratike, i kontribuon legjitimitetit të organeve të reja pas konfliktit si dhe fuqizimit të sundimit të ligjit, mbi të cilin do të ndërtohet shteti i ri. Llogaridhënia për veprat penale të kryera në të kaluarën është fundamentale për sigurimin e një rendi të ri të bazuar në sigurinë ligjore dhe llogaridhënien për qytetarët. Ajo po ashtu shërben për të krijuar besimin në institucionet rishtazi të formuara si dhe për të themeluar strukturat shtetërore mbi normat ligjore ndërkombëtare. Duke i dhënë fund mosndëshkimit, gjykimet i frenojnë krimet e ardhshme dhe, së këndejmi, i kontribuojnë qëndrueshmërisë. Së dyti, gjykimet i realizojnë të drejtat fundamentale të viktimave para drejtësisë. Duke i vënë prapa grilave ata të cilët iu kanë bërë keq atyre viktimave, kjo rivendos drejtësinë për viktimat dhe është një pranim i rëndësishëm për ata që vuajnë dhe një nderim për kujtesën e tyre. Përmbushja e kësaj të drejte individuale është thelbësore për paqen dhe qëndrueshmërinë si dhe për atë që t'iu mundësohet viktimave për të shkuar më tej. Në fund, nga gjykimet po ashtu pritet për të arritur paqen sociale përmes pajtimit të ish armiqve, për arsye se ata

e individualizojnë fajin dhe, së këndejmi, e largojnë përgjegjësinë nga masat. Trajtimi i atyre personave që bartin përgjegjësinë më të madhe, është debatuar, e mundëson deflacionin e fajit kolektiv, fenomen ky që është tipar i cili përsëritet në luftërat bashkëkohore civile, përmes ekspozimit të rolit të lidërshiptit në përkeqësimin e armiqësive dhe manipulimin e opinionëve.) Në një kontekst post-konfliktual, normalizimi i marrëdhënieve midis dy komuniteteve në të kaluarën të kundërvëna njëra me tjetrën nuk mund të arrihet përderisa të dyja palët të mos jenë ndjekur penalisht, në atë mënyrë që mitet nga e kaluara, mbi të cilat të dyja komunitetet i kanë bazuar mendimet e tyre të papajtueshme, të mos shkatërrohen.

### 2.2. Masat për kërkimin e së vërtetës

Arritja e një versioni të përbashkët të historisë, të një kujtimi të përbashkët të së kaluarës, po ashtu është thelbësore për pajtimin dhe për të shkuar përpara. Kjo bëhet përmes proceseve të kërkimit të së vërtetës. Krijimi i një të vërtete zyrtare, rreth të cilës pajtohen të gjithë, mund t'i parandalojë gjeneratat e ardhshme nga rënia në revizionizëm, si dhe elitat politike për të manipuluar ngjarjet nga e kaluara për realizimin e agjendave të tyre politike. E vërteta po ashtu ua mundëson viktimave për të vendosur drejtësinë si dhe për të sendërtuar zinjë e tyre. Derisa shumë instrumente të DT-së i kontribuojnë kërkimit të së vërtetës (siç janë gjykimet ose, për shembull, shënjimi i viktimave), instrumentet më adekuate janë komisionet e së vërtetës.

### 2.3. Reparacionet

E drejta në reparacione është aspekt skajshmërisht i rëndësishëm i vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe, së këndejmi, një komponent thelbësor i drejtësisë tranzicionale. Në anën tjetër, reparacionet e dhëna viktimës i kontribuojnë në një formë simbolike pranimit të humbjes së tyre, duke e mundësuar shërimin nga traumat e luftës. Reparacionet ua mundësojnë viktimave për të ushtruar të drejtën e tyre për rivendosjen e drejtësisë dhe janë një mirënjohje për kujtesën e tyre. Në anën tjetër, konflikti i armatosur në përgjithësi ndikon mbi

grupet e varfra dhe të rrezikuara të shoqërisë në mënyrë më të dukshme dhe, së këndejmi, reparacionet janë një element i paçmueshëm i drejtësisë post-konfliktuale me qëllim që viktimat të jenë në gjendje për ta rikthyer dinjitetin, për të vazhduar jetët e tyre dhe për të marrë pjesë në shoqëri në mënyrë të barabartë.<sup>6</sup> Derisa kompensimi në të holla është forma më e zakonshme e reparacioneve, mund të përdoren një numër i madh i metodave (restitucioni, kompensimi, rehabilitimi, satisfaksioni dhe garancia e mos-përsëritjes), dhe të gjitha këto përmbajnë funksione të rëndësishme sociale dhe psikologjike të rehabilitimit, të reintegrimit dhe të respektimit të viktimave. Reparacionet simbolike përmes kërkimfaljes, pranimit dhe memorialët, janë po ashtu të dobishme për të nderuar kujtimet për viktimat dhe për të konstatuar faktet.

#### 2.4. Reforma institucionale: krijimi i besimit në institucionet

Gjatë trajtimit të mizorive masive dhe të trashëgimisë së konfliktit, po ashtu është e domosdoshme që në mënyrë fundamentale të ndryshohen ato institucione të përgjegjshme për abuzimin me të drejtat e njeriut me qëllim të rivendosjes së sundimit të ligjit dhe heqjes së kulturës së mosndëshkimit, e cila ka zënë vend. Ngaqë institucionet publike (siç janë policia, ushtria dhe gjyqësori) shpesh bëhen instrumente të abuzimit të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit, është thelbësore që pas tranzicionit për t'i hequr dhe për t'i reformuar ato. Reforma institucionale është, së këndejmi, një proces i ristrukturimit të shtetit në atë mënyrë që ai obligohet ndaj respektimit të normave të të drejtave të njeriut dhe dispozitave të shtetit ligjor, si dhe pastrimi nga kryerësit si për të realizuar llogaridhënien individuale, ashtu edhe për të siguruar mos-përsëritjen. Reforma institucionale mund të përfshijë masa të cilat i vënë në shënjestër mangësitë individuale (proceset e verifikimit me qëllim të eliminimit nga shërbimi publik i zyrtarëve abuziv dhe të korrupsuar), dhe mangësitë strukturale, përmes reformave organizative dhe ligjore (ristrukturimi i institucioneve, ligjet e reja dhe amandamentet, Reforma e Sektorit të Sigurisë, Çarmatimi, Demobilizimi dhe Reintegrimit, etj.), si dhe masat edukative. Qëllimi i reformave institucionale brenda DT është

<sup>6</sup> Stover (2005)

që të çojë mesazhin tek qytetarët se ata janë bartësit e të drejtave dhe për të ndërtuar besimin midis tyre dhe institucioneve të tyre.

### 3. Sfidat e Drejtësisë Tranzicionale

#### • Secili instrument i DT-së i ka kufijtë e vet

Derisa DT është një ndërmarrje tejet e rëndësishme, asnjëri prej mekanizmave të detajizuar nuk është perfekt dhe të gjitha ato i kanë kufizimet e tyre inhereente. Prokuroritë, për shembull, janë të krijuara për shoqëritë në të cilat pritet shkelja e ligjeve. Në konfliktet civile, siç është ai në ish Jugosllavi, ato shkelje bëhen normë dhe, së këndejmi, ndjekjet penale nënkuptojnë një përkushtim të madh të kohës dhe të resurseve, pothuajse e pamundshme për t'i siguruar, gjë që i ka çuar gjykatat ndërkombëtare për të proceduar me një qasje të madhe selektive. Për shkak të numrit të madh të krimeve, njeriu ka nevojë për të pranuar faktin se ndjekja penale gjithmonë mund të jetë vetëm një mënyrë e pjesshme e trajtimit të abuzimit sistematik të të drejtave të njeriut. Për më tepër, fakti nëse ato ndjekje bëhen lokalisht ose jashtë ka një ndikim mbi efikasitetin e tyre. Në fund, gabimet në menaxhimin e gjykimeve penale vendore dhe ndërkombëtar, (çështjet e terrenit, mbrojtja e dëshmitarëve, perceptimi i gjykatave nga viktimat) shpesh e kanë penguar efikasitetin e tyre.<sup>7</sup> Reparacionet po ashtu përmbajnë rreziqe, ngaqë ato mund të përkeqësojnë tensionet politike. Ato mund të perceptohen si paragjykuese nga viktimat. Përcaktimi se si të distribuohen reparacionet politikisht është sensitiv dhe mund t'i lë tejet të frustruar ata që mbeten jashtë, duke krijuar mosmarrëveshje midis komuniteteve dhe duke i përkeqësuar pakënaqësitë si dhe duke i marginalizuar edhe më tutje disa individë.

#### • DT vepron në një kontekst tejet të ndjeshëm

Nuk duhet ta harrojmë se DT është një ndërmarrje tejet e vështirë dhe sensitive në një kontekst jashtëzakonisht kompleks, të

<sup>7</sup> Orentlicher (2010)



paqëndrueshëm dhe të rimëkëmbjes. Harku i gjerë i objektivave, i cili më herët është detajizuar, qartazi është së tepërmi ambicioz për të qenë realist, për arsye se çështjet e larmishme, të cilat lindin pas konfliktit, janë jashtëzakonisht komplekse që të mund të zgjidhen vetëm me anë të një qasjeje të DT-së. Për më shumë, fusha e DT-së ballafaqohet me një numër të madh të çështjeve praktike: shkalla dhe natyra politike e krimeve, rreziku i ndryshimit të drejtpeshimit delikat politik dhe i krijimit të paqëndrueshmërisë si dhe rezistenca e cila mund të bëhet nga lidhshipi kombëtar. Menaxhimi i të pritmeve është një element thelbësor i perceptimit të suksesit të DT-së nga publiku i përgjithshëm. Për më shumë, nuk ka një shteg të vetëm, i cili mund të zbatohet në të gjitha kontekstet post-konfliktuale dhe secila shoqëri, e cila angazhon drejtësinë tranzicionale, duhet të zgjedh shtegun e saj vetjak, i cili i përshtatet kontekstit të saj kulturor dhe social. DT skajshmërisht varet nga konteksti specifik dhe nga viktimat. Ajo është për nga natyra e saj e ndjeshme, e politizuar dhe politike. Derisa ajo e ka për objektiv për të ofruar një mënyrë për të trajtuar të kaluarën për shoqëritë dhe për të arritur një transformim/tranzicion afatgjatë, ajo, po ashtu, ka potencial të madh për destabilizim, keqpërdorim dhe keq-menaxhim.

- **DT duhet të jetë e shumëfishtë dhe kontekstuale**

Nga të gjitha instrumentet e ndryshme të DT-së, asnjëri prej tyre nuk duhet të ketë preferencë, për arsye se të gjithë ata janë komplementar. Për shembull, derisa ndjekja penale e kryerësve është domosdoshmëri, kjo nuk është e mjaftueshme për të sjellë drejtësinë për viktimat, për arsye se e drejta në reparacione të drejta është një pjesë e veçantë dhe thellësisht e barabartë e sigurimit të drejtësisë post-konfliktuale për viktimat civile të krimeve të luftës. Njëmend, shumë studime tregojnë se kur pyeten, viktimat nuk e përkufizojnë “drejtësinë” vetëm si një dënim të kriminelëve, por, po ashtu, edhe si një tërësi të të drejtave sociale dhe ekonomike.<sup>8</sup> Në mënyrë të ngjashme, nëse disa kryerës dënohen, por institucionet shtetërore edhe më tutje është e përfshirë nga zyrtarë abuziv, DT do të jetë e mangët. Të pritmet e viktimave pas konfliktit janë të larmishme, për arsye se lufta ndikoj në viktimat në shumë mënyra të ndryshme dhe,

<sup>8</sup> Stover (2005)

së këndejsmi, përmbushja e objektivave të DT-së e kërkon përdorimin e mekanizmave të ndryshëm në dispozicion në një mënyrë holistike, kreative dhe të matur.<sup>9</sup>

#### **4. Një pasqyrë e DT-së në Kosovë**

##### **4.1. Ndjekjet penale të krimeve të luftës të kryera në Kosovë**

Ndjekjet penale të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë janë realizuar nga tri mekanizma të ndryshëm. Në njërin anë, gjykimet ndërkombëtare në GJNPJ kanë trajtuar rastet e profileve më të larta. Në anën tjetër, sistemi i drejtësisë së Kosovës ka qenë i angazhuar në ndjekjen penale të krimeve të luftës lokalisht me anë të ndihmës së UNMIK-ut dhe të EULEX-it. Në fund, gjykimet po ashtu janë mbajtur edhe para gjykatave serbe. Kohët e fundit, është bërë e ditur se procedurat penale vendore do të zgjerohen me anë të themelimit të një gjykate të re, e cila në publik është referuar si “Gjykata Speciale” ose “Dhomat Speciale”, të cilat do të trajtojnë krimet e kryera nga ish zyrtarët e lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe menjëherë pas konfliktit në Kosovë. Megjithë kompleksitetin e qartë të këtij sistemi, mungesa e transparencës, dosja e ndjekjeve penale për krimet e kryera në Kosovë ka qenë mikse. Shumë vëzhgues e kanë dënuar mungesën e rezultateve të GJNPJ (ICTY), dhe vlerësimi i punës së UNMIK-ut dhe të EULEX-it po ashtu është zvogëluar, duke ilustruar se sa komplekse është çështja e trajtimit të krimeve të së kaluarës në kontekstin e Kosovës.

##### **4.2. Kërkimi i së vërtetës në Kosovë**

Për shkak të karakterit rajonal të luftërave në ish Jugosllavi, duke e përfshirë këtu edhe konfliktin në Kosovë, si dhe për shkak të lëvizjes së viktimave dhe të kryerësve përgjatë rajonit, bashkëpunimi rajonal duhet të jetë një element esencial i çdo përpjekjeje të Drejtësisë Tranzicionale. Procesi KOMRA (Komisioni ndërshtetëror për Përcaktimin dhe Zbulimin e Fakteve lidhur me të gjitha Viktimat

<sup>9</sup> Davis (2014)

e Krimeve të Luftës dhe të Abuzimit të të drejtave të njeriut në territorin e ish Jugosllavisë nga viti 1991 – 2001) është iniciuar me qëllim që të sigurojë një përpjekje kolektive, rajonale të kërkimit të së vërtetës. Tash udhëhiqet nga Koalicioni rajonal për KOMRA-n me më shumë se 1900 anëtarë – organizata dhe individë nga të gjitha shtetet post-Jugosllave. Pas shumë viteve të lobimit, pritet se Komisioni Rajonal i së Vërtetës do të themelohet në të ardhmen e afërt. Objektivi i gjithmbarshëm i KOMRA-s është që të themelojë një konsensus rajonal të bazuar në faktet lidhur me të kaluarën; avancimi i procesit të përparimit midis komuniteteve të ndryshme dhe midis vet shteteve. Fatkeqësisht, agjendat kombëtare politike anë e kënd Ballkanit dhe ndërjegjja e varfër e projekteve rajonale brenda popullatës shpesh e pengojnë progresin në këtë fushë.

#### 4.3. Reparacionet në Kosovë

Në Kosovë, Ligji<sup>10</sup> i cili i siguron reparacionet e krimeve të luftës është i mangët e me shumë të meta dhe në veçanti me një përkufizim diskriminues të viktimave civile, duke përjashtuar shumë viktimave civile dhe në veçanti në disfavor të viktimave serbe të luftës në Kosovë. Paragjykimi i perceptuar kundër serbëve e bënë të përjetshëm narrativin e gabuar 'bardh dhe zi' lidhur me luftën, duke e parandaluar kështu një narrativ të saktë dhe të bazuar në faktet. Po ashtu, ai Ligj perceptohet si politikisht i motivuar dhe diskriminues, i tillë që krijon mosmarrëveshje midis viktimave të komuniteteve dhe aq shumë i dëmshëm për pajtimin midis dy komuniteteve. Përdorimi i reparacioneve simbolike, siç janë memorialët, është po ashtu shumë kontrovers në Kosovë për arsye se promovon një histori të njëanshme të luftës.

#### 4.4. Reforma institucionale në Kosovë – ndërtimi i besimit ndaj institucioneve

Në Kosovë, derisa reforma strukturale dhe ligjore është sendërtuar në kornizën kohore post-konfliktuale të menjëhershme si pjesë

<sup>10</sup> Emri i plotë i Ligjit është: "Ligji mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre ". Do t'i referohemi më tutje si Ligji mbi Reparacionet.

e përpjekjeve të ndërtimit të shtetit, reforma institucionale ende mungon në disa aspekte. Njëmend, atje nuk ka pasur proces të verifikimit, dhe shumë nga liderët politik etnik shqiptar të njohur kanë luajtur një rol aktiv në konfliktin e vitit 1999 si pjesëtarë të UÇK-së. Derisa disa prej tyre kanë qenë të akuzuar ose janë subjekt i hetimeve, shumë prej tyre kanë mbetur thjesht në pushtet dhe janë lider të shquar sot. Në frymën e rimëkëmbjes së besimit të qytetarëve në institucionet e tyre, duket se detyra ka mbetur e pakompletuar. Shumica e serbëve etnik besojnë se ekziston një mungesë e vullnetit të njëmendët politik për të mbrojtur të drejtat e komunitetit serb. Legjislativi i gjerë dhe sistemi institucional në Kosovë, i cili ka për objekt mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe të interesave të komuniteteve pakicë, asnjëherë nuk ka qenë plotësisht i zbatuar dhe efikas. Për shembull, derisa gjuhës serbe dhe shqiptare i është akorduar një status i barabartë zyrtar në letër, në realitet është e vështirë për t'iu qasur institucioneve dhe informacionit në gjuhën serbe. Përveç kësaj, popullata e shqiptarëve etnik po ashtu nuk iu beson institucioneve publike për shkak të skandaleve të përsëritura me korrupsionin. Disa komentues argumentojnë se një nga sfidat kryesore të Kosovës në interesimin e saj për përpjekjet e DT-së është që të krijojë një të vërtetë tillë.

## KAPITULLI 2:

### REGJISTRIMI I VIKTIMAVE – LIBRI I KUJTIMIT I KOSOVËS



Një aspekt i trajtimit të së kaluarës është regjistrimi shterues dhe i saktë i viktimave të luftës me qëllim të sjelljes së të vërtetës lidhur me atë se çka ka ndodhur dhe për t'u përballë me humbjet njerëzore të luftës. Në Kosovë, kjo është bërë përmes Librit të Kujtimit të Kosovës (LKK), një projekt i përbashkët midis FDH-së në Serbi dhe FHD Kosovë të iniciuar në vitin 1998 dhe i cili e ka për objektiv për të krijuar një regjistrim dhe dokumentim 4 vëllimor të të gjitha humbjeve njerëzore në lidhje me luftën në Kosovë midis datës 1 janar të vitit 1998 dhe datës 31 dhjetor të vitit 2000. Regjistrimi i viktimave në masë të madhe dhe në mënyrë specifike në kontekstin e LKK-së, i shërben një numri të madh të qëllimeve, të cilat më pastaj do të paraqiten në mënyrë të hollësishme. LKK, falë kontributeve të saj të shumfishta ndaj DT-së, është bërë një mjet i paprecedentë për ndërtimin e paqes.

## 5. Rëndësia e regjistrimit të viktimave dhe të kontributeve të LKK-së

Regjistrimi i viktimave është në shërbim të qëllimeve të ndryshme të ndërlidhura. Derisa qëllimi kryesor i LKK-së ka qenë krijimi i një memorie kolektive të bazuar në faktet si dhe për të rimëkëmbur deri në një masë të caktuar dinjitetin e viktimave, ai po ashtu i shërben qëllimeve të mëtejme për përkrahje të nismave të tjera të DT.<sup>11</sup> Njëmend, LKK, për shkak se siguron një bazë të të dhënave të

<sup>11</sup> Kruger and Ball (Kruger dhe Ball) (2014)

saktë dhe shteruese mbi viktimat e luftës, ndihmon në përmirësimin e përputhshmërisë me obligimet ndaj të drejtave të njeriut dhe llogaridhënies së njerëzve në pozita përgjegjëse si dhe krijon kushte (një regjistër për të gjitha viktimat) për nisjen e ndjekjeve penale, programeve të reparacionit dhe nismave të kërkimit të së vërtetës.

### 5.1. Roli përkujtimor i LKK-së

Një nga pengesat më të mëdha për pajtimin midis komuniteteve dhe paqes pozitive janë versionet konkurruese të së kaluarës, mohimi dhe manipulimi politik i shifrave. Njëmend, sjellja e tillë e mohon të qenët viktimë për shumë viktimat dhe i përjetëson ndarjet binare në shoqëri.<sup>12</sup> Në këtë pikëpamje, një regjistër i gjithanshëm i humbjeve individuale njerëzore nga konflikti në Kosovë është thelbësor për të kundërshtuar mohimin publik dhe manipulimin politik të viktimave, që po ndodh anë e kënd rajonit dhe i cili po e përjetëson ciklin e agresionit. Përmes sigurimit të një regjistri të tillë, një nga qëllimet kryesore të LKK-së ka qenë ndërtimi i një memorie historike të përbashkët për konfliktin e armatosur në Kosovë (1998-2000) – të ndarë nga të gjitha viktimat nëpër të gjitha grupet – me çka bëhet preventivi i revizionizmit të ardhshëm historik dhe i manipulimit me numrin e njerëzve të vrarë dhe forcërisht të zhdukur. Në këtë pikëpamje, regjistrimi i viktimave merr karakter përkujtimor.<sup>13</sup>



Muri i emrave, Memoriali Kigali (Roginek)

<sup>12</sup> Minor (2012)

<sup>13</sup> Minor (2012)



Memoriali Srebrenica (Degruson)

## 5.2. LKK dhe rimëkëmbja e dinjitetit të viktimave

Qëllimi i dytë kryesor i LKK-së, përmes regjistrimit të humbjeve njerëzore, është që të rimëkëmbë dinjitetin e viktimave dhe të familjeve të tyre përmes pranimit zyrtar të humbjeve dhe të vuajtjeve të tyre. LKK, përmes regjistrimit të viktimave të konfliktit të armatosur në Kosovë nga viti 1998 deri në vitin 2000, në bazat emër për emër, publikisht paraqet (dhe bënë njohjen publike për) të vërtetën lidhur me krimet e kryera në të kaluarën dhe i kontribuon përfundimit të pasigurisë së familjeve lidhur me fatin e më të dashurve të tyre.<sup>14</sup>

## 5.3. Përdorimi i LKK-së në ndihmë të viktimave:

Regjistrimi i viktimave në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sistematike është një mjet shumë i dobishëm në sigurimin e ndihmës për viktimat pas konfliktit dhe, në veçanti, në realizimin e të drejtave të tyre në reparacione. Njëmend, një strategji e përshtatshme politike për reparacionet mund të hartohet vetëm mbi të dhëna të sakta dhe të unifikuara lidhur me përfituesit.<sup>15</sup> Shumë shpesh në situatat post-konfliktuale, pengesa më e madhe për sigurimin e masave të reparacioneve është mungesa e një përmbledhjeje të të dhënave të sakta dhe të besueshme, ngaqë agjencitë e ndryshme dalin me informacione të ndryshme. LKK, falë regjistrimit sistematik që i ka

<sup>14</sup> Minor (2012)

<sup>15</sup> Minor, and Olgiati (Minor, dhe Olgiati) (2014)

bërë nga të dhënat e viktimave, duke përfshirë edhe hollësitë lidhur me atë se çfarë ka ndodhur, kujt, kur, ku, si dhe duke i gërshetuar të gjitha të dhënat ekzistuese në Kosovë me qëllim të shmangies së dyfishimit, lëshimeve dhe gabimeve, pra, LKK është bërë një mjet për të përmbushur nevojat e viktimave për ndihmë materiale.

## 5.4. Kontributi i LKK-së në ndjekjet penale

Materiali i mbledhur në LKK është, për të njëjtat arsye (saktësia, karakteri gjithëpërfshirës), i një dobie të madhe për ndjekjet penale.<sup>16</sup> FDH njëmend ka qenë në gjendje për të lokalizuar viktimat dhe kryerësit e krimeve dhe për të iniciuar akuzat penale të bazuara në informacionet e mbledhura në LKK.

## 5.5. Kontributi i LKK ndaj kërkimit rajonal të së vërtetës

Baza e të dhënave e LKK-së do të jetë skajshmërisht e dobishme për proceset e KOMRA-s, objektiv i të cilit është të arrijë një konsensus rajonal lidhur me të kaluarën, e cila bazohet në fakte. LKK, përmes regjistrimit të këtyre fakteve mbi vdekjet dhe zhdukjet në Kosovë, është duke e iniciuar këtë proces, duke krijuar, kështu, hapat nismëtar (një regjistër i të gjitha viktimave në Kosovë) për një proces më të gjerë rajonal.

## 5.6. Kontributi i LKK-së ndaj pajtimit

Ky regjistër është unik në kuptimin e regjistrimit të viktimave në Kosovë, për arsye se nuk bëhet kurrfarë dallimi midis serbëve dhe shqiptarëve, të cilët janë në një libër së bashku, pikërisht si luftëtar të UÇK-së, policë dhe ushtarë serb. Ky bashkim i viktimave e promovon idenë se secili njeri, i cili ka vuajtur nga lufta, e ka të drejtën në statusin e barabartë të viktimës, pavarësisht prej etnicitetit dhe fesë. Po ashtu ka një element të interesimit përmes përforsimit të idesë se, kur tashmë njëherë viktimat mbahen mend, arrihet një propozim i pastër dhe shoqëria e Kosovës mund të lëviz tutje me të kaluarën

<sup>16</sup> Minor, and Olgiati (Minor, dhe Olgiati) (2014); Minor (2012)

e saj në një mënyrë përfshirëse. Në këtë pikëpamje, LKK përpiket për të ndërprerë narrativin 'ne kundër tyre' dhe për të shpënë tutje pajtimin e komuniteteve në Kosovë.

Për ta thënë përmbledhtazi, regjistrimi i paanshëm dhe shterues i viktimave i shërben drejtësisë së viktimave, kujtesës kolektive, të vërtetës dhe pajtimit. Ky shfrytëzim me qëllim të shumëfishtë e tregon ndërlidhshmërinë e mekanizmave të ndryshëm të DT-së dhe faktin se nuk ekziston një dimension i vetëm i drejtësisë. Kjo aftësi e LKK-së për të ndikuar aq shumë në fushën e DT-së i detyrohet një metodologjie strikte, që e ka për objektiv saktësinë e plotë dhe karakterin gjithëpërfshirës.

## 6. Receta e LKK-së: metodologjia strikte dhe saktësia

### 6.1. Metodologjia dhe formati<sup>17</sup>

#### Baza e të dhënave e LKK-së

Baza e të dhënave e LKK-së paraqet burimet origjinale të të gjitha të dhënave dhe pothuajse të gjitha vegzat në gjuhën angleze, kroate, serbe dhe shqipe. Secila pjesë e informacionit është e lidhur me ID-në e viktimës dhe me një numër të ID-së së ngjarjes. Një person mund të lidhet me ngjarje të ndryshme dhe në secilën prej tyre mban një rol të ndryshëm (viktimë, dëshmitar etj). Një ngjarje e veçantë tubon disa njerëz dhe disa dokumente (duke iu referuar kohës, datave, fakteve) dhe e mundëson që të sigurohet një formë e narrativit që ushqehet dhe që ushqen dëshmitë individuale të viktimës lidhur me ngjarjet. Të gjithë individët janë ndarë midis kategorive: 'viktimë e luftës', 'viktimë potenciale' dhe 'jo viktimë e luftës'. Në kategorinë e 'viktimave të luftës', nuk ka viktima anonime të regjistruara. Sidoqoftë, janë disa viktima anonime në dy kategoritë e tjera, të cilat janë verifikuar dhe përditësuar në mënyrë konstante. Së këndejmi, LKK lë hapësirë për progres, ndërsa në mënyrë strikte i shënjon si viktima të luftës ato viktima për çka ky informacion është i pakontestueshëm. Kjo saktësi është thelbësore në mënyrë që LKK – dhe regjistri i tij i viktimave të luftës – të mund të mbështesë qëllimet e cekura më lartë. Cekja

<sup>17</sup> Kruger and Ball (Kruger dhe Ball), (2014)

e emrave në LKK e mundëson ndër-validimin e të dhënave, duke e mundësuar testimin e gjurmimeve për njerëzit e vërtetë.

#### Statusi i viktimave të luftës

Viktimat e luftës në LKK janë ndarë midis 3 tipave të statusit: 'civil,' 'ushtar,' dhe 'polic'. Civili është përkufizuar si cilado viktimë e një grupi të armatosur që merr pjesë në konflikt. LKK po ashtu e cek gjininë, datën dhe vendin e lindjes dhe përkatësinë etnike të secilës viktimë të luftës. Pavarësisht nga statusi i tyre, shumica dërmuese e viktimave janë shqiptarë, që pasohen nga serbët. Përfundimisht, LKK po ashtu jep informacione për vendbanimin e fundit të viktimës para vdekjes ose zhdukjes së tij. Për rastet e zhdukjes, LKK po ashtu jep vendin e fundit, ku është parë viktima.

#### Metoda

FDH Kosovë i ka mbledhur të dhënat mbi humbjet njerëzore via udhëtimeve kërkimore në terren, intervistave me anëtarët e familjes, deklaratave të dëshmitarëve, dokumentacionit të gjykatave, burimeve të ndryshme të mediave, raportimeve ndërkombëtare dhe vendore nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare etj. Informacioni i siguruar i është përgjigjur një metodologjie precize. Një nga indikacionet më të rëndësishme të saktësisë së LKK-së është vëllimi i burimeve i përdorur për të verifikuar informacionin. Një viktimë do të përfshihet në kategorinë e 'viktimës së luftës' vetëm nëse mund të konstatohet një lidhje me luftën pa asnjë dyshim, e bazuar në informacione të mjaftueshëm e të besueshëm lidhur me rrethanat e vdekjes ose të zhdukjes. Protokollin e verifikimit të informacionit është shkajshëmrisht i saktë. Vetëm kur një gjykim i gjykatës është në dispozicion, së paku dy burime të pavarura duhet të konfirmojmë një lidhje me luftën. Burimet do të konsiderohen si të 'pavarura' nëse asnjë lidhje nuk mund të gjendet midis tyre. Gjatë hulumtimit në terren, pavarësia e burimit do të sigurohet nga mostra dhe shkalla kohore e intervistave të kryera, duke qenë të zhvilluara në lokacione të ndryshme në momente të ndryshme të kohës e me qëllim që të mundësohet ndërverifikimi i të dhënave të siguruara. Burimet do të figurojnë si 'burime primare' nëse ato japin një provë të saktë të viktimave nga dëshmitarët e drejtpërdrejtë të ngjarjes, ose si 'burime sekondare', kur ato vlerësojnë ose komentojnë mbi informacionet e burimeve primare. Viktimat e cekura në bazën e të dhënave kanë

mesatarisht tetë dokumente që i cekin ata.

## 6.2. Gjetjet e deritashme

Një numër total prej 31,600 dokumentesh është shfrytëzuar për të dokumentuar vdekjet ose zhdukjet e 13,549 njerëzve – 10,829 shqiptarëve, 2,199 serbëve dhe 529 romëve, boshnjakëve, malazezëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë – në lidhje me luftën midis datës 1 janar të vitit 1998 dhe datës 31 dhjetor të vitit 2000. Në mesin e tyre, si viktimat të luftës janë pranuar: 10,334 civil në tërësi, prej të cilëve 8,693 janë shqiptarë, 1,196 janë serb dhe 445 romë dhe të tjerë si dhe 3,215 pjesëtarë të formacioneve të armatosura, duke përfshirë 2,122 pjesëtarë të UÇK-së dhe të FARK-ut, 1,090 pjesëtarë të forcave serbe, dhe 3 pjesëtarë të KFOR-it. Pos kësaj, janë edhe 1,603 viktimat potenciale, statusi i viktimës së luftës së të cilëve nuk është konfirmuar.<sup>18</sup>

## 6.3. Njohja ndërkombëtare e saktësisë së LKK

Në evaluimin e saj të LKK në vitin 2014, Grupi i Analizës së të Dhënave të të Drejtave të Njeriut (GADhDNj) ka ardhur te përfundimi se “në të gjitha dokumentet ose pothuajse në të gjitha, të gjitha humbjet njerëzore gjatë konfliktit në Kosovë gjatë periudhës 1998-2000 (...) ka shumë pak gjasë se aty ka pak më shumë se dhjetëra vdekje të padokumentuara”. Ky përfundim është nxjerrë pas shumë analizave dhe gjetjeve, duke përfshirë edhe krahasimin me dhjetë baza të tjera të të dhënave që dokumentojnë humbjet njerëzore në Kosovë. Një regjistër i tillë i saktësisë është rezultat i metodologjisë shumë të saktë të LKK-së, që i shërben qëllimit të saktësisë së gjetjeve.<sup>19</sup> Pas këtij pranimi, mund të thuhet se LKK e ka arritur qëllimin e saj që të bëhet një regjistër i respektuar i të gjitha humbjeve njerëzore për shkak të luftës në Kosovë.

<sup>18</sup> Rezultatet Preliminare – të konfirmohet në muajin qershor të vitit 2015.

<sup>19</sup> Kruger and Ball (Kruger dhe Ball), (2014).

## KAPITULLI 3: NDJEKJA PENALE E KRIMEVE TË LUFTËS

Që nga të 90-tat, ndjekja penale – të cilës shpesh i referohen si drejtësi retributive – në mënyrë mbizotëruese ka qenë mjeti i preferuar i DT-së për të trajtuar të kaluarën.<sup>20</sup> Kosova nuk është përjashtim dhe, në të vërtetë, ilustron shumë prej aspekteve të ndjekjes penale të krimeve të luftës, për arsye se ato mund të marrin shumë prej formave të tyre kontroverse. Rëndësia më madhe e ndjekjeve penale ndaj mjeteve të tjera të DT-së pas konflikteve rrjedh nga disa observacione dhe ushqen disa të pritme. Siç është detajizuar në kapitullin 1, përkrahësit e gjykimeve pohojnë se ata përbushin një numër të shumtë të qëllimeve, prej vendosjes së drejtësisë e deri te sigurimi i së vërtetës, ndërsa sigurohet edhe paqja (përmes parandalimit) dhe pajtimi (përmes individualizimit të fajit dhe ekspozimit të rolit të lidhshëm në përkeqësimin e urrejtjeve dhe opinionëve manipuluese).<sup>21</sup>

Ndjekjet penale për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë kanë zënë vend përmes mekanizmave të shumtë të ndryshëm, derisa një mekanizëm i ri është shpallur kohët e fundit. Gjykimet ndërkombëtare në GJNPJ (ICTY) janë marrë me 5 rastet e profilit më të lartë, ndërsa sistemi gjyqësor i Kosovës ka qenë duke i ndjekur penalisht krimet në nivel lokal nën një sistem hibrid të Administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i pasuar në vitin 2008 nga Misioni i Sundimit të Ligjit (EULEX). Disa nga krimet e luftës të kryera në Kosovë po ashtu në nivel lokal janë trajtuar në Serbi nga Dhoma e Specializuar e Krimeve të Luftës e Gjykatës së Qarkut e Beogradit dhe Zyra e Prokurorit për Krime të Luftës që nga viti 2003. Në të ardhmen e afërt, procedurat vendore penale do të zgjerohen me anë të themelimit të një gjykate të re, e cila do të veprojë brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, por me gjykime të mbajtura jashtë.

<sup>20</sup> Ky parapëlqim është evident në lidhje me zhvillimet e mëdha në LKN, numri në rritje mbi gjykatat ndërkombëtare dhe diskursi zyrtar publik i faktorëve ndërkombëtar. Kerr & Mobekk (2007); Degruson (2014)

<sup>21</sup> Kerr & Mobekk (2007)

Karakteri i shumëfishtë i institucioneve që trajtojnë krimet e luftës për Kosovën, e pakta, është konfuz. Ata të gjithë i kanë pro-të dhe kontra-të të lidhura me specialitetet e tyre dhe regjistri i tyre i gjithmbarshëm në arritjen e qëllimeve të vëna për to në Kosovë ka qenë i përzier, pjesërisht për shkak të atyre qëllimeve, të cilat janë të paarrtshme nga gjykatat vetëm. Të kuptuarit e karakteristikave dhe të rezultateve të institucioneve të ndryshme të drejtësisë në Kosovë i kërkon disa vërejtje paraprake në lidhje me faktet e ndryshme kur bëhet vlerësimi i kualitetit dhe i efikasitetit të drejtësisë pas konfliktit.

#### 1. Fakti i pohimit se gjykimet kanë të pritme jorealiste

- Është argumentuar nga disa vëzhgues se të pritmet jorealiste të vëna para gjykimeve për krime të luftës kanë 'shtruar themelin për zhgënjim'<sup>22</sup>, dhe se menaxhimi i të pritmeve të tilla ka qenë çelësi për perceptimin pozitiv publik.

#### 2. Fakti se "drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por duhet të shihet që të bëhet"<sup>23</sup>

- Derisa drejtësia i referohet normativit ideal si të tillë, në kontekstin e ndërtimit të paqes ajo që është e rëndësishme është se si komunitetet e prekura nga lufta i perceptojnë nismat e ndryshme të drejtësisë, duke e nënvizuar rëndësinë e terrenit.

#### 3. Shqyrtimi i pro-ve dhe i kontra-ve të procedurave penale ndërkombëtare përballë atyre kombëtare<sup>24</sup>

- Faktet pragmatike tregojnë se shteteve post-konfliktuale shpesh iu mungon kapaciteti dhe vullneti politik për të hetuar krimet e pretenduara të luftës kur kryerësit e pretenduar janë të lidhur me qeverinë dhe me sferën politike.
- Në këtë pikëpamje, gjykimet ndërkombëtare kanë më pak rreze të paragjyimit, të pandershmërisë dhe të fitores së drejtësisë se sa procedurat penale.
- Megjithatë, gjykimet vendore bartin potencial më të madh për ndërtimin e kapaciteteve dhe të pronësisë vendore – kjo e fundit duke qenë çelës për suksesin e gjykimeve dhe e tillë që i bënë gjykimet kombëtare me më shumë gjasa për impaktin mbi viktimat dhe shoqërinë se sa ato ndërkombëtare.
- Sistemet hibride janë përpjekur për të bërë më të mirën nga të dyja – masat mbrojtëse ligjore ndërkombëtare dhe pronësia vendore.

#### 4. Marrja në konsideratë e rëndësisë së të dyja drejtësive, asaj retributive dhe të asaj restorative<sup>25</sup>

- Fokusi i tashëm i DT-së në mënyrë mbizotëruese ka qenë vënë në drejtësinë e gjykimeve<sup>26</sup>, që përfshin llogaridhënien penale.
- Megjithatë, kuptimi kulturor relativ i drejtësisë dhe kufizimet e dënimeve penale janë të njohura.
- Drejtësia restorative merr parasysh dimensione të tjera, siç është ajo e rindërtimit të marrëdhënieve dhe e ndihmës materiale.

## PJESA 1: GJYKATA NDËRKOMBËTARE PENALE PËR ISH JUGOSLLAVINË (ICTY)



ICTY, The Hague (Degruson)

GJNPJ është krijuar me anë të Rezolutës 827 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila po ashtu përmban statutin e GJNPJ që përcakton juridiksionin e saj, strukturën organizative dhe procedurat penale në masë të madhe.

### 7. Mandati dhe juridiksioni i Gjykatës

GJNPJ ka juridiksion mbi 4 krime të kryera në territorin e ish Jugosllavisë nga viti 1991 e tutje. Ky juridiksion është hapur për krimet e kryera në Kosovë nga data 28 shkurt e vitit 1999, datë kur konflikti zyrtarisht ka arritur nivelin e një 'konflikti të brendshëm

<sup>22</sup> Orentlicher (2010)

<sup>23</sup> Deklaratë e A. Cassese, në Kerr & Mobekk (2007)

<sup>24</sup> Kerr & Mobekk (2007) ; Mani (2007)

<sup>25</sup> Hovil & Quinn (2005) ; Sriram (2007) ; Engstrom (2013) ; Akman (2008)

<sup>26</sup> Engstrom (2013)

## Neni 2: juridiksioni mbi shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949<sup>28</sup>

Katër Konventat e Gjenevës i kanë përkufizuar rregullat për mbrojtjen e civilëve në kohë të luftës, të cilët nuk marrin pjesë në luftimet, dhe për të sëmuret, për të plagosurit dhe për personat e fundosur të forcave të armatosura dhe të burgosurit të luftës, të cilët nuk janë në gjendje të luftojnë më.

"Tribunali Ndërkombëtar do të ketë autorizime për të ndjekur penalisht personat të cilët kryejnë ose urdhërojnë për t'u kryer shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht të vitit 1949, me fjalë të tjera aktet e mëposhtme kundër personave ose pronës së mbrojtur nën dispozitat e Konventës relevante të Gjenevës:

- Vrasja e qëllimshme;
- Tortura ose trajtimi çnjerëzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike;
- Shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha ose i lëndimeve të rënda për trupin dhe shëndetin;
- Shkatërrimi i gjerë dhe uzurpimi i pronës, i paarsyetuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe i kryer në mënyrë të paligjshme dhe të papërligjur;
- Detyrimi i të burgosurve të luftës ose i civilëve për të shërbyer në forcat e palës armiqësore;
- Deprivimi i qëllimshëm i të burgosurit të luftës nga e drejta e gjykimit të drejtë dhe të ndershëm;
- Deportimi i paligjshëm ose transferi ose ngujimi i paligjshëm i civilëve;
- Marrja e civilëve si pengje."

## Neni 3: juridiksioni mbi shkeljen e ligjeve dhe të zakoneve të luftës<sup>29</sup>

Ligjet ose zakonet e luftës janë një organ i ligjit ndërkombëtar të futur përmes traktateve të ndryshme, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, më të njohurat ndër to Konventa e Hagës e vitit 1899 dhe 1907 dhe Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollit Shtesë i vitit 1977, si dhe përmes zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare zakonore. Neni 3 përcakton një listë joshteruese të shkeljes së ligjeve ose të zakoneve të luftës, siç janë: përdorimi i armëve helmuese, shkatërrimi i qëllimshëm i qyteteve i paarsyetuar nga domosdoshmëria ushtarake, shkatërrimi i institucioneve të dedikuara për religjionin dhe plaçkitja e pasurisë publike ose private.

## Neni 4: juridiksioni mbi krimet e gjenocidit<sup>30</sup>

Neni 4 i cek aktet, të cilat përbëjnë gjenocidin, nëse kryhen "me qëllimin për të shkatërruar, në tërësi ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor ose religjioz si të tillë". Në ato akte përfshihen: vrasja e pjesëtarëve të grupit ose shkaktimi i dëmeve të rënda trupore ose mendore tek anëtarët e atij grupi. Pos gjenocidit, edhe konspiracioni për të kryer gjenocid, nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike për të kryer gjenocid, përpjekja për të kryer gjenocid dhe bashkëpjesëmarrja në gjenocid po ashtu janë të dënueshme sipas Nenit 4.

## Neni 5: juridiksioni mbi krimet kundër njerëzimit<sup>31</sup>

"Këtu përfshihen krimet e mëposhtme, kur kryhen në një konflikt të armatosur, qoftë ai me karakter ndërkombëtar ose të brendshëm, dhe të drejtuara kundër cilëso popullatë civile:

- vrasja; - asgjësimi; - skllavërimi; - deportimi; - burgosja;
- tortura; - dhunimi; - persekutimi mbi baza politike, racore ose religjioze;
- aktet e tjera çnjerëzore."

të armatosur'.<sup>27</sup> GJNPJ i gjykon ata të cilët bartin përgjegjësinë më të madhe për krimet e luftës brenda juridiksionit të saj, në pajtim me parimin e përgjegjësisë komanduese, doktrinës së llogaridhënies hierarkike në rastet e krimeve të kryera gjatë kohës së luftës.

## 8. Rastet

Që nga fillimi i juridiksionit të saj në muajin shkurt të vitit 1999, GJNPJ ka trajtuar 5 raste të ndara që kanë tubuar ndonjëherë edhe disa kryerës të pretenduar. 3 prej tyre i kanë trajtuar abuzimet e kryera nga zyrtarët serb dhe 2 nga udhëheqësit shqiptar të UÇK-së. Në tërësi, 8 njerëz janë gjetur fajtor për krimet e kryera në konfliktin e Kosovës.

### Rasti Sllobodan Milloseviq (IT-02-54)<sup>32</sup>

- President i Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) nga data 15 korrik e vitit 1997 deri në datën 6 tetor të vitit 2000.
- Krimet për të cilat akuzohet (inter alia (ndër të tjera):
  - Deportimi i dhunshëm i përafërsisht 800,000 shqiptarëve civil të Kosovës;
  - Kontributi për të krijuar një atmosferë të frikës dhe të shtypjes përmes përdorimit dhe kërcënimit të përdorimit të forcës;
  - Vrasja e qindra civilëve shqiptarë të Kosovës – burra, gra dhe fëmijë, që ka ndodhur në një mënyrë të gjerë dhe sistematike anë e kënd krahinës së Kosovës;
  - Sulmet seksuale të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kundër grave shqiptare;
  - Fushata sistematike e shkatërrimit të pasurisë në pronësi të civilëve shqiptarë të Kosovës përmes granatimit të gjerë dhe
  - Djegia dhe shkatërrimi i pronës, duke përfshirë shtëpitë, fermat, bizneset, monumentet kulturore dhe vendet fetare.
- Ka vdekur në datën 11 mars të vitit 2006, që ka çuar deri te përfundimi i procedurave.

<sup>27</sup> Neni 1 i Statutit të GJNPJ; HRW (2001)

<sup>28</sup> Neni 2 i Statutit të GJNPJ

<sup>29</sup> Neni 3 i Statutit të GJNPJ

<sup>30</sup> Neni 4 i Statutit të GJNPJ

<sup>31</sup> Neni 5 i Statutit të GJNPJ

<sup>32</sup> Rasti i dokumentit të S. Milloseviqit.



### Rasti Shainoviq dhe të tjerët (IT-05-87)<sup>33</sup>

**Prokurori kundër Nikolla Shainoviqit, Dragoljub Ojdaniqit, Nebojsa Pavkoviqit, Vladimir Llazareviqit, Sreten Llukiqit & Millan Millutinoviqit**

- Përkatësisht: Zëvendëskryeministrit të Republikës Federative të Jugosllavisë, Shef të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Jugosllave (AJ), Komandant i Armatës së Tretë të AJ-së, Shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës të AJ, Shef i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) i personelit për Kosovë dhe Metohi dhe kryetar i Serbisë.
- I akuzuar për, inter alia (midis të tjerash):
  - Deportim, veprime të tjera çnjerëzore (transfere të përdhunshëm), vrasje, persekutim në baza politike, racore ose religjioze (krime kundër njerëzimit) dhe
  - Vrasje (shkelje të ligjeve ose të zakoneve të luftës)
- Përgjegjësia e konstatuar në Operacionin Reka, krimi më i rëndë kundër civilëve i kryer gjatë luftës në Kosovë, ku së paku 350 civil shqiptarë janë vrarë.<sup>34</sup>
- Dënua me respektivisht 18, 15, 22, 14, 20 vite të burgosjes. Millutinoviqi lirohet.

### Rasti Vllastimir Gjorgjeviq (IT-05-87/1)<sup>35</sup>

- Ndihmësinistër i Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Shef i Departamentit të Sigurisë Publike (DSP) të MPB-së; përgjegjës për të gjitha njësitë dhe personelin e RSP në Serbi, duke përfshirë Kosovën midis datës 1 janar dhe 20 qershor të vitit 1999.
- I akuzuar për:
  - Deportim, veprime të tjera çnjerëzore (transfere të përdhunshëm), vrasje, persekutim në baza politike, racore ose religjioze (krime kundër njerëzimit) dhe
  - Vrasje (shkelje të ligjeve ose të zakoneve të luftës)
- Përgjegjësia është konstatuar në Operacionin Reka.
- I dënua me 18 vite burgosje.

### Rasti Limaj dhe të tjerët (IT-03-66)<sup>36</sup>

**Prokurori kundër Fatmir Limajt, Isak Musliut & Haradin Balës**

- Të gjithë, siç pretendohet, komandant të UÇK-së, me pozita në zonën Llapushnikut dhe në kampin e burgosjes së Llapushnikut.
- Limaj dhe Musliu janë liruar në mungesë të provave - Bala dënohet me 13 vite burgosje.

<sup>33</sup> Rasti i dokumentit të Shainoviqit dhe të tjerëve.

### Rasti Haradinaj dhe të tjerët (IT-04-84)<sup>37</sup>

**Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt & Lahi Brahimaj**

- Përkatësisht: Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në zonën operative të Dukagjinit; pjesëtar i njësisë speciale të njohur si "Shqiptonjat e zeza"; pjesëtar i Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së të stacionuar në selinë në Jabllanicë.
- Haradinaj dhe Balaj janë liruar në mungesë të provave - Brahimaj është dënua me gjashtë vite burgosje.

## 9. Trashëgimia e GJNPJ në Kosovë: të arriturat, kufizimet dhe kritikët

Trashëgimia e GJNPJ është zvogëluar në gjithë rajonin e ish Jugosllavisë. Derisa disa zhvillime shumë të rëndësishme të jurisprudencës kanë qenë të mirëseardhura në kuptimin e ligjit substancial (midis të tjerash, në rastet Tadiqi dhe Blashkiqi, dhe në lidhje me nocionin kontrollit efikas/të gjithmbarshëm dhe kontrollit të trashëgimisë kulturore), ndikimi praktik i gjykatës në terren është vënë në pyetje, posaçërisht në Kosovë, ku është shtruar dyshimi nëse e ka sjellë drejtësinë dhe pajtimin për viktimat ashtu siç është pritur.

- **Drejtësia e GJNPJ, e perceptuar përmes prizmit etnik, ka dështuar në sjelljen e pajtimit**

Derisa ndershmëria e GJNPJ në zgjedhjen e rasteve të saja është pranuar ndërkombehtarisht,<sup>38</sup> fajet individuale të cilat janë konstatuar nga gjykata nuk ia kanë dalë të shlyejnë modelet e fajit kolektiv në Kosovë dhe për të rimëkëmbë besimin midis komuniteteve, kryesisht për shkak të selektivitetit të tyre të nevojshëm.<sup>39</sup> Në një konflikt si ai i Kosovës – të karakterizuar nga një pabarazi në mes të kapacitetit ushtarak si dhe nivelit dhe sasisë së mizorive të kryera

<sup>34</sup> 'Operacioni Reka' (2015)

<sup>35</sup> Rasti i dokumentit Gjorgjeviq

<sup>36</sup> Rasti i dokumentit të Limajt dhe të tjerët.

<sup>37</sup> Rasti i dokumentit të Haradinajt dhe të tjerët.

<sup>38</sup> Clark (2010)

<sup>39</sup> Clark (2009); Orentlicher (2010)

nga të dyja palët – vëllimi i ndjekjes penale për krimet e luftës të kryera nga serbët dhe shqiptarët nuk mund të ketë qenë i barabartë dhe vlerësimi objektiv i GJNPJ nuk duhet të bazohet në shifrat, edhe pse ato janë krejt joproportionale. Sidoqoftë, me gjithë paanësinë e konstatuar të GJNPJ në përzgjedhjen e rasteve, fakti se serbët në mënyrë mbizotëruese janë dënuar ka çuar deri te perceptimi i paragjykitimit nga komuniteti serb dhe, së këndejmi, i ka përkeqësuar narrativat etnike më parë se sa që i ka fashitur ato. Verdiktet e gjykatave janë, së këndejmi, përgjithësisht të perceptuara përmes një prizmi etnik, për shkak të faktit nëse të akuzuarit konsiderohen si heronj të luftës ose kriminel të luftës.<sup>40</sup> Ky efekt negativ pjesërisht mund të shpjegohet me mungesën e programit të terrenit të GJNPJ, që, po të ishte më shumë efikase, do të rriste të kuptuarit popullor të rregullave procedurale dhe të modeleve që burojnë nga ndjekjet penale.<sup>41</sup> Në vend të kësaj, për shkak të nivelit të lartë mosbesimit, kontakteve shumë të pakta midis grupeve dhe versioneve garuese të së kaluarës në Kosovë, përvoja e GJNPJ ka nënvizuar kufizimet praktike të ndjekjeve penale në arritjen e pajtimit social.<sup>42</sup> Derisa mbetet që shumë krime të konstatuara kundër serbëve dhe minoriteteve të tjera të mbeten të pagjetura, papërsosshmëria e drejtësisë së GJNPJ po ashtu i ka lënë shumë shqiptarë pa njohjen ligjore të plagëve të tyre.

- **Ofrimi i papërsosur i drejtësisë**

Hulumtimet empirike në ish Jugosllavi kanë theksuar kufizimet e një qasjeje të pastër retributive ndaj drejtësisë.<sup>43</sup> Në të vërtetë, kur disa viktimat janë pyetur, ato janë përgjigjur se puna e GJNPJ vështirë se i ka prekur përvojat e tyre, me çka ka krijuar një ndjenjë të pakënaqësisë midis tyre. Këto zëra lidhen me faktin se gjykimet si të tilla, duke u fokusuar para së gjithash në kryerësit më parë se sa në viktimat si dhe duke i vënë viktimat nëpër procedura kundërshtuese si dhe para pyetjeve gjyqësore lidhur me humbjet e tyre, pra, gjykimet, nuk ofrojnë domosdoshmërisht një platformë adekuate për pranimin e plagëve të tyre. Për më shumë, përzgjedhja e nevojshme e gjykimeve, për shkak të kohës dhe të kufizimeve të resurseve, e ka

40 orentlicher (2010)

41 Devitt (2012)

42 Martin-Ortega (2013)

43 Clark (2009)

bërë drejtësinë e gjykimeve në mënyrë të pashmangshme simbolike dhe, së këndejmi, të papërsosur në mendjen e viktimave, ngaqë vetëm disa nga ta nuk janë dëgjuar.<sup>44</sup> Në të vërtetë, kanë qenë vetëm 5 raste të kompletuara gjatë gjithë juridiksionit të gjykatës. Si viktimat shqiptare, ashtu edhe ato serbe, kanë mbetur me ndjenjën se krimet e bëra ndaj tyre kanë mbetur të padënuara, që ilustron disa nga kufizimet e drejtësisë retributive të ofruar nga gjykimet, përkundër dëshirës së qartë prej shumë prej tyre për t'i dhënë fund mosndëshkimit.

- **Sfidimi i përfitimeve të gjykimeve ndërkombëtare kundrejt gjykimeve kombëtare dhe mungesa e qasjes ndaj terrenit në GJNPJ**

Një aspekt tjetër i drejtësisë së kryer nga GJNPJ, i cili është debatuar, është ai nëse procedurat ndërkombëtare kanë qenë më adekuate se sa ato kombëtare në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë. Gjykatat ndërkombëtare në përgjithësi zgjidhen më parë se sa ndjekjet penale kombëtare për shkak të mundësisë së këtyre të fundit për drejtësi të paragjykuar, të pandershme dhe fitimtare.<sup>45</sup> Megjithatë, rasti i GJPSI (shih tabelën më poshtë) ka treguar se ato rreziqe mund të zbuten nga masat mbrojtëse procedurale. Për më shumë, është konstatuar se vet gjykatat ndërkombëtare nuk janë të garantuara që të perceptohen si të paanshme, për shkak të mungesës së tyre të përsëritur të pronësisë vendore. Shembulli i GJNPJ tregon se gjykatat ndërkombëtare janë shpesh së tepërmi larg nga popullata e afektuar që në nivel lokal të perceptohet si kuptimplote. Pronësia vendore ofron shanse më të mëdha në ndjekjet penale për ndikim mbi viktimat dhe për t'u pranuar nga shoqëria. Në këtë pikëpamje, dështimi i GJNPJ për të transpozuar punën e saj në terren në një mënyrë të gjithanshme është përgjegjëse për shumicën e dështimeve të saj. Të kuptuarit e duhur të terrenit, që siguron të kuptuarit popullor të kriterit të përzgjedhjes për rastet dhe verdiktet, është një detyrë e cila nuk ka të bëjë më pak me procedurat vendore.<sup>46</sup>

44 Akman (2008) ; Tepperman (2002)

45 Më shumë hollësi shih në Kerr & Mobekk (2007)

46 Mani (2007)



- **Paanësia nuk është domosdoshmërisht prerogativ i mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare:** gjykatat kombëtare ose hibride – siç e demonstroi rasti i GJPSI<sup>48</sup> – mund të përfshijë masa mbrojtëse institucionale për paanësinë dhe ndershmërinë procedurale. Këtu garancitë janë garantuar për të siguruar se GJPSI nuk do të perceptohet si një gjykatë 'anti-sunite'.<sup>49</sup>
- **Shmangia e krizës së legjitimitetit:** Në Irak, vëzhguesit e afërt me gjendjen aty kanë arritur të përfundimi se një gjykatë ndërkombëtare e imponuar së jashtmi do të rezultojë në një 'krizë të legjitimitetit', e cila i rrezikon përpjekjet për të ndjekur penalisht pjesëtarët e palës Ba'ath përgjegjës për shtypjen e popullatës së Irakut. Duke parapëlqyer procedurat lokale (dhe hibride), autoriteti ndëshkues i GJPSI ka buruar drejtpërdrejtë nga autoriteti sovran i popullit të Irakut dhe nuk është imponuar nga jashtë.<sup>50</sup>

## 10. Përcjellja në vazhdimësi e GJPNJ: gjykimet vendore në Kosovë dhe Serbi dhe komisioni rajonal i së vërtetës

GJPNJ, pasi i ka përfunduar 5 raste për krimet në Kosovë, në dritën e njëfarë kritike të shprehur më sipër, ka filluar të transferojë ato që kanë mbetur në gjykatat kombëtare, si pjesë e një përpjekjeje për të përforcuar kapacitetet vendore dhe për të rimëkëmbur pronësinë vendore për gjykimet e krimeve të luftës. Për shkak të

kufizimeve inherente të gjykatave ndërkombëtare siç është GJPNJ si dhe dobësive të saj strukturale, është me rëndësi kyçe që gjykatat vendore të ndjekin penalisht krimet e luftës me qëllim që të mbyllin zbrazëtinë e mosndëshkimit. Në Serbi është themeluar një Dhomë e Specializuar e Krimeve të Luftës e Gjykatës së Qarkut të Beogradit dhe një Zyrë e Prokurorit për Krime të Luftës në vitin 2003. Në Kosovë, rastet e krimeve të luftës i janë dorëzuar prokurorëve ndërkombëtar dhe janë gjykuar nga trupat gjykues ndërkombëtar ose të përzier të krijuara nga administrata e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i pasuar nga Misioni i Sundimit të Ligjit i BE-së (EULEX). Dy procedurat vendore do të përshkruhen në dy pjesët në vazhdim.

Për më shumë, kapitulli në vijim do të përforcojë rëndësinë e bashkëpunimit rajonal kur është fjala për krimet e kryera në vitet '90-të në ish Jugosllavi. Rastet kriminale para GJPNJ fatkeqësisht kanë qenë rast për vendet e ish Jugosllavisë për të luftuar për të vërtetat e tyre vetjake, për të provuar se vizioni i tyre për të kaluarën është i vetmi i drejtë. Kjo dëshmohet, për shembull, nga dënimi publik i disa gjykimeve (nga Serbia qartazi në lidhje me lirinë e gjeneralëve kroat Markaq dhe Gotovina në vitin 2012) dhe nga shumtë e parave të dedikuara nga shtetet kombëtare për të mbrojtur kriminelët e pretenduar të luftës. Megjithatë, në këtë kontekst, është e nevojshme një e vërtetë rajonale dhe ky është qëllimi i nismës rajonale për një komision për të vërtetën (KOMRA).

47 [photo:http://en.protothema.gr/judge-who-presided-over-husseins-trial-executed-say-reports/](http://en.protothema.gr/judge-who-presided-over-husseins-trial-executed-say-reports/)

48 GJPSI është, në të vërtetë, më shumë një gjykatë hibride

49 Vinjamuri (2003)

50 Newton (2006)

## PJESA 2: GJYKIMET E KRIMEVE TË LUFTËS TË MBAJTURA NË KOSOVË

51



Për shkak të kufizimeve inhereente dhe të krijuara të GJPNJ-së, në Kosovë është instaluar një sistem hibrid si një komplement i domosdoshëm ndaj drejtësisë ndërkombëtare. Administrata e KB-ve në Kosovë menjëherë ua ka mundësuar gjyqtarëve ndërkombëtarë të ulen me gjyqtarët vendor në gjykata dhe të gjykojnë rastet e krimeve të luftës të vëna përpara nga prokurorët ndërkombëtarë. Kjo ka ndodhur si pjesë e Misionit të UNMIK-ut në Kosovë dhe nga viti 2008 si pjesë e Misionit të Sundimit të Ligjit të BE-së (EULEX), të ndarë në dy 'divizione'. 'Divizioni Ekzekutiv' i heton, i ndjek penalisht dhe i gjykon rastet sensitive duke shfrytëzuar kompetencat e tij ekzekutive. 'Divizioni Përforcues' monitoron, mentoron dhe këshillon homologët vendor në polici, drejtësi dhe në fushën e doganave. Për qëllimet e këtij kapitulli, do të trajtojmë vetëm divizionin e parë, ngaqë është ai divizioni i cili merret me ndjekjet penale. Ky i fundit sidoqoftë, do të jetë pjesë e kapitullit të fundit mbi reformat institucionale.

### 11. Gjykimet e EULEX-it: shkaku, mandati dhe funksionimi

Në dritën e asaj që është thënë më herët lidhur me pro-të dhe kontra-të e gjykimeve ndërkombëtare përballë atyre lokale, si dhe duke pasur parasysh zhgënjimin e përgjithshëm me drejtësinë ndërkombëtare në Kosovë, është me një rëndësi të madhe për të gjykuar krimet e luftës në vendet e tyre (pra, në Kosovë dhe në

51 photo: broshurë e EULEX-it.

Serbi), si në kuptimin e ndërtimit të kapaciteteve, ashtu edhe në atë të kualitetit të drejtësisë që iu ofrohet viktimave. Në pajtim me këtë, si kompromis, është sajuar një sistem hibrid. Vërtetë, EULEX-i është sajuar me një komponentë ndërkombëtare që sjellë masat e domosdoshme mbrojtëse ndërkombëtare në sistemin gjyqësor të Kosovës lidhur me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kurse komponenti vendor është themeluar për të garantuar legjitimitetin dhe pronësinë (karakterin) lokale të gjykimeve ndërsa tregon vetëdijen për kontekstin dhe procedurat lokale. Pos kësaj, në kontekstin e ndërtimit të paqes në Kosovë, zhvillimi deri te kuptimi i një gjyqësie të pavarur e aftë për të marrë përsipër përgjegjësitë e EULEX-it ka qenë qëllim me prioritet para vetes.

#### Mandati i Divizionit Ekzekutiv (DE) të EULEX-it<sup>52</sup>

- Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it trajtojnë në vazhdimësi rastet në lidhje me: krimet e luftës; terrorizmin; krimin e organizuar dhe korrupsionin e nivelit të lartë; krimet e tjera të rënda.
- Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-t janë të ngulitur në institucionet e Kosovës dhe shërbejnë në pajtim me ligjet e Kosovës. "Misioni i EULEX-it perceptohet si një përpjekje e përbashkët me autoritetet lokale, në linjë me parimet e pronësisë vendore."
- DE është i fokusuar në "ofrimin e sundimit të ligjit deri atëherë kur përparimi i autoriteteve vendore e lejon tranzicionin e plotë të funksioneve ekzekutive tek ata." Misioni "gradualisht do të zvogëlohet gjatë kohës së zhvillimit të sundimit ligjor të institucioneve të Kosovës dhe do të marrë gjithnjë e më shumë përgjegjësi në ato fusha". Në kushtet "normale të mungesës së politikave të reja", nuk do të iniciohet asnjë rast i ri dhe vet EULEX-i do të kompletojë ato raste të filluara para datës 15 prill të vitit 2014. Vetëm në veri të Kosovës, DE do të ndjek penalisht dhe do të gjykojë rastet derisa dialogu me Beogradin të sjellë një zgjidhje për gjyqësinë.

Siç është treguar më lart, ky mandat qartazi i vendos 2 shkaqe për EULEX-in, pas krijimit në Kosovën post-independente: të sjellë drejtësinë për krimet e luftës dhe të zhvillojë kapacitetet vendore përmes përforcimit të autonomisë së faktorëve lokal. Mandati i EULEX-it është zgjatur në datën 21 prill të vitit 2014, dhe duhet të përfundojë në datën 14 qershor të vitit 2016. Një Shqyrtim Strategjik

52 Siç është përcaktuar nga faqja internetit e EULEX-it ; broshurë e EULEX-it.

do të bëhet në gjysmën e dytë të vitit 2015 për të vlerësuar progresin e arritur dhe për të diskutuar pjesën e mbetur të mandatit të tij.<sup>53</sup>

## **12. Kontributi i EULEX-it për t'i dhënë fund mosndëshkimit: rastet**

Sipas shifrave të FDH-së, midis muajit korrik të vitit 1999 dhe muajit gusht 2015, pra, monitorimi i një periudhe prej më shumë se 15 viteve - 99 kryerës të pretenduar janë ballafaquar me gjykime para gjykatave të Kosovës. Bazuar në ato rezultate, pohimi i EULEX-it është se “përmes hetimit të politikanëve, ministrave, ish komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), biznesmenëve dhe shërbimeve sekrete jozyrtare, misioni në mënyrë serioze e ka sfiduar perceptimin e mosndëshkimit”.<sup>54</sup> Njëmend, falë Misionit, zbrazëtia e mosndëshkimit deri në një masë është zvogëluar, përmes atyre rasteve të kompletuara që kanë sjellë kënaqësinë për viktimat e përfshira. Sikur UNMIK-u dhe EULEX-i të mos merreshin me ndjekjen penale të krimeve të luftës në Kosovë, ka gjasë se më pak raste do të kryeshin dhe pothuajse asnjë rast kundër shqiptarëve etnik nuk do të iniciohej. Përveç kësaj, kapitulli i fundit po ashtu do të konstatojë se EULEX-i i ka kontribuar reformës institucionale deri në një nivel të thellësisë. Sidoqoftë, pavarësisht një progresi në ndërtimin e një sistemi ligjor të bazuar në sundimin e ligjit dhe në zvogëlimin e hendekut të mosndëshkimit, të dhënat për gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë flasin për mungesa të rëndësishme.

## **13. Kufizimet e ndjekjeve penale hibride të krimeve të luftës në Kosovë nën Misionin e EULEX-it**

Ndikimi i EULEX-it ka lënguar nga disa brenga të përsëritura lidhur me efikasitetin e tij në ndjekjen e krimeve të luftës dhe llogaridhënien. Derisa në një masë drejtësia është kryer në Kosovë përmes gjykimeve vendore të krimeve të luftës si dhe, përkundër profesionalizmit të

<sup>53</sup> broshurë e EULEX-it

<sup>54</sup> broshurë e EULEX-it

përgjithshëm të personelit në trajtimin e gjykimeve të krimeve të luftës, ajo ka qenë, në përgjithësi, një proces me mangësi të mëdha.

### **13.1. Ritmi i ndjekjeve penale, shkalla dhe natyra e akuzave: një ofrim i papërsosur i drejtësisë**

Midis muajit korrik të vitit 1999 dhe muajit gusht të vitit 2015, janë akuzuar 99 kryerës të pretenduar, kurse nga Libri i Kujtimit i Kosovës janë identifikuar një numër i tërësishëm prej 10,317 viktimize civile të luftës. Sigurisht se është e pamundur për të përcaktuar me saktësi numrin e viktimizeve që lidhen me ato 99 akuza, të cilat, së këndejmi, në njëfarë forme janë trajtuar nga drejtësia retributive, por mospërputhja midis numrit të kryerësve potencial të akuzuar dhe numrit të viktimizeve është e qartë. Pos kësaj, këto akuza kanë çuar vetëm deri te 27 dënime (me 13 lirime, 21 arratisje dhe me pjesën tjetër të pezulluar ose në vazhdim e sipër). Derisa procesi i gjykimeve është gjithmonë i dobishëm për viktimat, njeriu mund të hamendësojë se çfarë kënaqësie mund të marrin ata nga një nivel i tillë i ulët i dënimeve për kryerësit e tyre. Ekziston një perceptcion i përbashkët brenda shoqërisë në Kosovë se shumica e kryerësve kanë mbetur të padënuar.

Kohëzgjatja e procedurave është po ashtu problematike, duke e bërë gjithnjë e më të largët drejtësinë për viktimat. Për shembull, dhjetë gjykime të krimeve të luftës të mbajtura gjatë vitit 2014, në të cilat 43 individë kanë qenë të akuzuar, por është kryer vetëm një dënim. Ngaqë krimet e luftës janë duke u vjetruar, ato vetëm sa bëhen më të rënda për gjykim, për viktimat, për dëshmitarët dhe provat mund të jenë më pak në dispozicion ose më pak të qasshme me kalimin e kohës. Pavarësisht nga kompleksiteti dhe kujdesi i cili kërkohet në trajtimin e rasteve të tilla, pjesërisht edhe për shkak të ritmit të tyre të ngadalshëm, karakteri i zvarritur i procedurave është thellësisht frustrues për viktimat, gjë që e ushqen pohimin se drejtësia e kryer vetëm me gjykime është e pamjaftueshme. Përveç kësaj, pikërisht si edhe në GJPNJ, verdiktet janë perceptuar përmes prizmit etnik.

Për shumë nga ankesat dhe humbjet e viktimizeve nuk është dhënë llogari dhe shumë kryerës mbeten të pandëshkuar. Derisa

selektiviteti dhe kohëzgjatja disi janë limite natyrale të gjykimeve, ky joefikasitet është përkeqësuar nga disa faktorë, duke filluar nga numri i pamjaftueshëm i personelit ndërkombëtar të alokuar dhe trajnimi i tyre joadekuat e deri te mungesa e mjeteve dhe koordinimi i dobët, me çka bashkësia ndërkombëtare nuk ia ka dalë të sendërtojë ambicien e saj për të ofruar drejtësinë në Kosovë. Disa përparime mund të kenë filluar në vitin 2015, me një numër më të madh të prokurorëve kushtuar për GJKL. Pos kësaj, shpresohet se puna e gjykatës së re speciale (shih më pas) do të ofroj disa forma të drejtësisë për viktimat, të cilave ende iu mungon trajtimi i drejtë.

### 13.2. Mangësitë e procedurave dhe keqpërdorimi i viktimave<sup>55</sup>

Janë raportuar të gjitha llojet e mospërputhjeve dhe të mungesës së profesionalizmit ligjor në rastet e krimeve të luftës në Kosovë. Për shembull, në një rast, Dhoma e Apelit ka lëshuar një verdikt plotësisht ndryshe në dy faza të ndryshme të procedurës bazuar në të njëjtat prova, duke shkaktuar disa çështje të sigurisë ligjore dhe duke i dekurajuar viktimat. Jo vetëm kaq, vlerësimi i rregullt i gjykimeve vendore të krimeve të luftës ka shënuar një trend të gjyqtarëve, të cilët viktimat i vendosin ‘në prapavijë’ të gjykimeve, duke iu lejuar atyre, në mënyrë pasive, që të keqtrajtohen nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre. Ky trend, i cili e ka rritur frustrimin e shkaktuar nga selektiviteti dhe kohëzgjatja e procedurave, ka rezultuar në pengimin në masë të madhe të qëllimit të gjykimeve si një mjet i trajtimit të drejtë të viktimave. Kufizimet inherente dhe të konstruara të drejtësisë retributive nuk e kanë siguruar platformën adekuate për viktimat lidhur me njohjen e plagëve të tyre.

### 13.3. Çështjet në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve<sup>56</sup>

Pengesa më e rëndësishme për ofrimin efikas të drejtësisë në gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë mbetet çështja e mbrojtjes së dëshmitarëve. Kjo është e evidente kur dëshmitarët tregojnë “papritur kujtesë të freskët” lidhur me çështje shumë të largëta në kohë ose,

55 ‘Gjykimet e profilit të lartë: Drejtësia e vonuar’ (2014).

56 ‘Dëshmitarët - ende Thembër e Akilit në Gjykimet e Profilit të Lartë’ (2013)

e kundërta, kur harrojnë hollësi të cilat disa javë më parë i kanë përshkruar në hollësi. Ky model i ndryshimit të deklaratave për shkak të frikësimeve ose shantazhimit është i pranishëm në pothuajse të gjitha dëgjimet, duke përfshirë këtu edhe ato për dëshmitarët e mbrojtur.<sup>57</sup> Masat mbrojtëse të Ligjit mbi Mbrojtjen e Dëshmitarit, siç qëndron ai sot, nuk janë tamam të mjaftueshme si dhe as mjaft të zbatuara, që mundëson që dëshmitarët të identifikohen nga palët me gjithë mbrojtjen e tyre. Përveç kësaj, në një shoqëri siç është ajo e Kosovës, ku përkatësia në klane dhe lidhjet familjare janë të një rëndësie të tillë dhe ku favorët dhe solidariteti përcaktojnë shumë ndërveprime sociale, njeriu gjithmonë mundet brenda lidhjeve të saj për të gjetur një mënyrë për të shpërndarë informatën jashtë sallës së gjykatës, madje edhe kur ajo është konfidenciale dhe njeriu përgjithësisht do të favorizojë solidaritetin përballë saktësisë ligjore, madje edhe kur është nën betim. Largimi i dëshmitarëve nga Kosova duket si një zgjidhje, por vetëm e përkohshme, për arsye se kjo çështje hap rrugën e saj para fillimit aktual të gjykimeve dhe masave mbrojtëse që dalin prej tyre. Kjo çështje mbetet thembra e Akilit e procedurave penale në Kosovë, duke ilustruar kështu disa nga kufizimet e gjykimeve të mbajtura vendore.

### 13.4. Kapacitetet vendore ende shumë të pakta<sup>58</sup>

Sistemi hibrid i vendosur në Kosovë (me elemente të përziera ndërkombëtare dhe vendore) është menduar t’iu jep më shumë legjitimitet procedurave – duke mbetur në duart e vendorëve për praninë më të madhë vendor – dhe për të ndërtuar kapacitetin për sistemin gjyqësor në Kosovë në mënyrë që një ditë ai të mundet plotësisht të jetë i pavarur. Ky objektiv nuk është arritur. Personeli i EULEX-it është konceptuar që të mbështesë veprimin vendor, por, në të vërtetë, i ka marrë të gjitha vendimet e rëndësishme. Është evident në panelet e përziera, ku një hendek i madh ekziston midis gjyqtarëve të huaj dhe vendor. Ata duket se nuk komunikojnë dhe gjyqtari vendor shpesh lihet që thjesht të miratojë vendimet e marra nga gjyqtarët e EULEX-it. Kjo sigurisht se ka ndodhur në emër të dëshirës për të qenë efikas, por ka krijuar një hendek në legjitimitetin,

57 Pra, rasti i Fatmir Limajt përballë gjykatave vendore, në të cilat, në procedurat initiale të vitit 2012, dëshmitari kryesor është gjendur i vdekur në një park (në Gjermani)

58 ‘Gjykimet e profilit të lartë: Drejtësia e vonuar’ (2014).

që ilustruhet nga deklaratat e kohëve të fundit të deputetëve të Kosovës, të cilat akuzojnë gjyqtarët ndërkombëtar për arbitraritet në marrjen e rasteve nga prokurorët vendor. Në të vërtetë, nuk ka pasur asnjë prokuror të vetëm – të supozuar për të prezantuar shtetin e Kosovës – në 15 vitet e fundit, dhe vetëm dy aktakuza janë dhënë nga gjyqtarët vendor. Ligji i datës 21 prill të vitit 2014, i cili i zvogëlon kompetencat e EULEX-it dhe i cili transferon rastet më të rënda tek gjyqtarët dhe prokurorët vendor, ka çuar, në fillim të vitit 2015, te krijimi i Zyrës së Prokurorit Special me një departament për krimet e luftës në Kosovë. Ndërsa ky është një zhvillim pozitiv, mbetet që në të ardhmen prokurorët vendor të duken në sallën e gjykimeve. Ngaqë mandati i EULEX-it përfundon në fund të vitit të ardhshëm, sistemi gjyqësor i Kosovës nuk është askund gati për të marrë përsipër punën. Përmbledhtazi, derisa sistemi hibrid është menduar si një kompromis i cili tubon gjyqtarët më të mirë ndërkombëtar dhe vendor, në të vërtetë, e ka bërë të kundërtën: ndërsa ka dështuar për të rimëkëmbë pronësinë dhe për të ndërtuar kapacitetet si një gjykatë vendore, gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë po ashtu kanë dështuar për të siguruar masat mbrojtëse ligjore ndërkombëtare në kuptimin e zhvillimit procedural të procedimeve.

### 13.5. Humnera e kredibilitetit

Brengosjes së përsëritur të EULEX- lidhur me efikasitetin e tij në ndjekjen penale të krimeve të luftës duhet shtuar edhe sulmet në integritetin dhe llogaridhënien e tij për shkak të disa skandaleve që pretendojnë se gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it kanë marrë mito nga avokatët vendor në lidhje me rastet e krimeve të luftës. Skandali i fundit deri më sot, në muajin nëntor të vitit 2014, ia ka dalë që të shpërbëjë legjitimitetin e EULEX-it në Kosovë. Përveç kësaj, po ashtu, EULEX-i i ka zhgënjyer rëndë të pritmet popullore se do ta hetonte korrupsionin dhe se do ta nxiste qeverisjen e mirë ekonomike. Ky hendek i kredibilitetit, madje edhe atëherë kur nuk lidhet drejtpërdrejtë me gjykimet e krimeve të luftës, ka ndikuar negativisht në perceptimin e EULEX-it në Kosovë dhe, së këndejmi, edhe në besimin popullor se mund të vendos drejtësinë në mënyrë efikase. Në pajtim me këtë, Barometri i Sigurisë i Kosovës, i cili e mat perceptimin publik dhe besimin në institucionet e drejtësisë, ka

gjetur se në vitin 2014, ndjekjet penale (prokuroritë), duke përfshirë ato për krimet e luftës, kanë qenë institucionet e parafundit të besuara në Kosovë, me 41.9% të respondentëve të cilët janë deklaruar se nuk i besojnë EULEX-it.<sup>59</sup>

Për shumë vëzhgues, brengosja lidhur me efikasitetin dhe llogaridhënien e EULEX-it e kanë vënë në pyetje faktin nëse një institucion me një dosje të tillë mund të jetë efikas në luftën kundër mosndëshkimit. Për ta, themelimi i një gjykate të re të krimeve të luftës e dëshmon dështimin e EULEX-it në përmbushjen e mandatit të tij. Pos kësaj, derisa udhëheqja e duhur e gjykimeve vendore për krimet e luftës është ballafaquar me dy sfida kryesore, përkatësisht me çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe me mungesën e ndërtimit të kapaciteteve, gjykata speciale, e cila së shpejti do të themelohet, do të ketë nevojë për masa mbrojtëse të fuqishme.

<sup>59</sup> Barometri i Sigurisë i Kosovës (2014).

## 14. Gjykata Speciale që do të formohet së shpejti

### Mandati i Gjykatës Speciale

- Në periudhën e ardhshme procedurat vendore penale do të zgjerohen në themelimin e një gjykate të re, e referuar shpesh në publik si “Gjykata Speciale” ose “Dhoma Speciale”, e cila do të merret me krimet e kryera nga ish zyrtarët e lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe menjëherë pas konfliktit në Kosovë.
- Funkzioni primar i saj do të jetë hetimi i pretendimeve të gjetura në raportin e Dick Martit të vitit 2010 lidhur me shkeljet e ndryshme (trafikimi i organeve, keqtrajtimi i të burgosurve, rrëmbimet dhe vrasja sistematike e bashkëpunëtorëve të Millosheviqit). Ky raport fokusohet në “Grupin e Drenicës”, udhëhequr nga Hashim Thaci, më pastaj kryeministër dhe tash ministër i punëve të jashtme. Në vitin 2014, gjetjet e Task Forcës Speciale Hetimore të BE-së kanë qenë “në masë të madhe konsistente” me raportin e Martit dhe kanë konstatuar “dëshmi bindëse” kundër disa ish zyrtarëve të lartë të UÇK-së.
- Gjykata do të jetë e themeluar në shkallë kombëtare, por do të vendoset jashtë (sistemi hibrid). Siç pohohet, janë marrë garanci të forta në drejtim të mbrojtjes së dëshmitarëve. Deri në muajin dhjetor të vitit 2015 është lëshuar shumë pak informacion zyrtar në lidhje me strukturën, me procedurat dhe me punën e Gjykatës së ardhshme, mandatit dhe funksionimit të së cilës deri më tash i mungon transparenca.

Madje edhe para themelimit të saj si dhe për shkak të aktakuzave të pritura kundër ish zyrtarëve të rangut të lartë të UÇK-së, Gjykata Speciale ka ngritur një nivel të lartë të interesimit të publikut të Kosovës dhe ka nxitur ndarje në spektrin politik. Mbulimi në masë të madhe nga ana e mediave i një çështjeje të tillë të ndjeshme, sipas gjasës do të rezultojë në raportimin sensacionalistik të mediave, shpërndarjen e informacionit të pasaktë dhe në krijimin e tensioneve brenda komuniteteve dhe midis tyre duke e përkeqësuar popullaritetin e gjykatës brenda publikut të përgjithshëm. Një imazh i mirë publik i gjykatës është thelbësor për perceptimin e saj nga viktimat dhe duhet të bëhen përpjekje në terren në ngritjen e vetëdijes për punën, për mandatin dhe për procedurat e gjykatës.

### 14.1. Përkundër shumë kritikave ...

Për shumë vëzhgues, kjo gjykatë e re shikohet, megjithëkëtë, si një

shkelje tjetër e sovranitetit të Kosovës në një kontekst ku vetëm 13.6% e respondentëve pajtohen se sistemi gjyqësor i Kosovës i merr vendimet në mënyrë të pavarur në vitin 2015, nga 25% pothuajse një vit përpara.<sup>60</sup> Përveç kësaj, arsyeja kryesore për refuzimin e gjykatës nga shumë shqiptarë është sepse mandati i gjykatës e diskrediton kauzën e drejtë të UÇK-së të luftës çlirimtare të Kosovës. Në të vërtetë, natyra e njëanshme e gjykatës njëmend është problematike, për arsye se dërgon një mesazh të rrezikshëm dhe i shtohet edhe një gjykatë tjetër me një qasje josistematike ose të copëzuar, e cila ka qenë themeluar në Kosovë, ku asnjë nismë nuk duket se ka ndonjë kuptim fare. Më në fund, është e lehtë për ta vënë në pyetje efikasitetin dhe legjitimitetin edhe të një strukture tjetër të imponuar gjyqësore në dritën e dështimeve të asaj paraprake, që e kemi konstatuar më lartë. Qytetarët e Kosovës janë të lodhur me drejtësinë ndërkombëtare. Në sytë e shqiptarëve dhe të serbëve, sistemet e grumbulluara të drejtësisë të imponuara mbi ta nga Bashkësia Ndërkombëtare kanë dështuar në ofrimin e drejtësisë. Për shqiptarët, selektiviteti i rasteve ndërkombëtare të krimeve të luftës do të thotë se ata kanë dështuar për të hetuar dhe për të gjykuar ata që janë përgjegjës për shumë varreza masive të shqiptarëve të Kosovës të gjetura në vend dhe në Serbi. Për serbët, madje edhe më drejtpërdrejtë, drejtësia ndërkombëtare ka dështuar të përgjigjet për pastrimin e popullatës serbe në Kosovë në fund të luftës. Pos kësaj, dështimi në mposhtjen e korrupsionit ndërkombëtar dhe kriminalitetin ekonomik e ka sjellë besimin popullor në drejtësinë ndërkombëtare afër zeros.

### 14.2. Gjykata do të sjellë më shumë drejtësi për viktimat ...

Duke mos i përjashtuar ato kritika, pretendimet për krimet e cekura janë serioze dhe derisa ato të mos jenë hulumtuar në mënyrën e duhur, nuk do të ketë drejtësi në Kosovë. Hedhja dritë në ato pretendime nuk është me rëndësi vetëm për kredibilitetin e sistemit ligjor të Kosovës, por, po ashtu, edhe për imazhin e Kosovës jashtë. Që është edhe më e rëndësishme, kjo ka rëndësi për viktimat. Njeriu mund të argumentojë se hetimi i një krimi dhe sjellja e tij para drejtësisë për disa viktima është arsye e mjaftueshme për gjykatën. Jo vetëm kaq, me vite, shumica e njerëzve në Kosovë kanë besuar se krimet e luftës

<sup>60</sup> Raporti i Pulsit Publik IX (2015).



janë kryer vetëm nga të tjerët: nga serbët dhe nga bashkëpunëtorët e tyre. Asnjëherë nuk është biseduar për krimet e UÇK-së në një mënyrë të tillë të hapur para Raportit të Martit. Është koha që këto krime po ashtu të hetohen.

### **14.3. Është siguruar menaxhimi i kujdesshëm dhe masat mbrojtëse!**

Në dritën e konsideratave në fjalë, gjatë gjykimeve të krimeve të luftës në masë të madhe, dhe karakteristikave specifike të gjykimeve ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë deri më tash, ndikimi i gjykatës së re në masë do madhe do të varet nga fakti nëse do të merren garanci të kujdesshme. Dosja dhe reputacioni i keq i GJPNJ dhe i EULEX-it në mënyrë të pashmangshme do të njollosë gjykatën e re, pos nëse bëhet puna e duhur në terren. Mbrojtja e fuqishme e dëshmitarëve po ashtu duhet të hartohet. Sfida është për të dëshmuar se janë mësuar mësimet.

## **PJESA 3: GJYKIMET PARA GJYKATAVE SERBE**

Si pjesë e përpjekjeve për të gjykuar kriminelët e luftës në vendet e tyre, qoftë në kuptimin e ndërtimit të kapaciteteve, qoftë në kuptimin e cilësisë së drejtësisë së ofruar për viktimat, Ligji mbi organizimin dhe kompetencat e Autoriteteve Qeveritare në ndjekjen penale të krimeve të Luftës është miratuar në muajin korrik të vitit 2003 me ndihmën dhe me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare. Ligji e ka transferuar juridiksionin për krimet e luftës tek institucionet e specializuara brenda Serbisë, duke iu dhënë atyre juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit dhe shkeljet e ligjit ndërkombëtar siç është përcaktuar në Kodin Penal të Serbisë si dhe mbi shkeljet e rënda të ligjit të së drejtës humanitare, që kanë ndodhur në territoret e ish Republikës së Jugosllavisë që nga data 1 janar e vitit 1991.

### **15. Juridiksioni i krimeve të luftës dhe vendimet e marra lidhur me Kosovën**

Tri agjencitë shtetërore kryesore të përfshira në ndjekjen penale të krimeve të luftës janë: Zyra e Prokurorit për Krime të Luftës (ZPKL), Departamenti i Krimeve të Luftës i Gjykatës së Lartë në Beograd (DKLGJL), dhe Departamenti i Krimeve të Luftës i Gjykatës së Apelit në Beograd (DKLGJA). Puna e tyre në ndjekjen penale të krimeve të luftës është sendërtuar me ndihmën e Shërbimit për Hetimin e Krimeve të Luftës (SHHKL), Njësisë Mbrojtëse (Njësia) dhe Shërbimit për Asistencë dhe Përkrahje për Viktimat dhe Dëshmitarët i Departamentit për Krime të Luftës i Gjykatës së Lartë të Beogradit.

Para themelimit të DKLGLJL në vitin 2003, një grusht i rasteve janë përfunduar nga juridiksioni i rregullt në Serbi. Në lidhje me krimet e luftës të kryera në Kosovë, 5 raste janë përfunduar (Podujeva I (Cvjetan), Millosh Llukiq, Ferizaj (Petkoviq & Simiq), Emini (Millosh Simoniq & Dragisha Markoviq), dhe Kushnin). Në tërësi, 10 individë (të gjithë serb etnik) kanë qenë të akuzuar, prej të cilëve 7 kanë qenë

të dënuar, kurse 3 të liruar.

Deri në krijimin e tij në muajin gusht të vitit 2015, DKLJGJL në Serbi i ka iniciuar 6 raste kundër serbëve – në të cilat kanë qenë të akuzuar 29 persona – dhe 4 raste kundër shqiptarëve – në të cilat 20 persona kanë qenë të akuzuar. Derisa 4 raste ende janë në vazhdim e sipër (Qyshk, Lubenik, Pavlan & Zahaq, Tërnje dhe Sinan Morina), 5 nga ato raste kanë qenë plotësisht të përfunduara.

#### Rastet e përfunduara nga DKLJGJL:

- **Rasti Suha Reka** – 7 të akuzuar, 4 të dënuar (në tërësi 68 vite), 3 të liruar
- **Rasti Podujeva II** – 4 të akuzuar, 4 të dënuar (në tërësi 75 vite)
- **Rasti Bytyqi** – 2 të akuzuar, 2 të liruar
- **Rasti Anton Lekaj** – 1 i akuzuar, 1 i dënuar (13 vite)
- **Rasti Grupi i Gjilanit** – 18 të akuzuar, 18 të liruar

Në tërësi, kanë qenë 59 aktakuza, 16 dënime dhe 24 lirime deri në vitin 2003.

## 16. Vlerësimi i efikasitetit të punës së ZPKL dhe e DKLJGJL

DKLJGJL dhe Dhoma e ZPKL në mënyrë të rëndësishme kanë zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar kryerësit e krimeve të luftës në pajtim me standardet ndërkombëtare të gjykimit të ndershëm që nga krijimi i tyre dhe kanë fituar një potencial real për të ofruar drejtësinë për shumë viktime. Sidoqoftë, disa elemente e kanë kufizuar këtë kapacitet, gjë që ka rezultuar në një efikasitet të kufizuar.<sup>61</sup>

### 16.1. Efikasiteti i DKLJGJL dhe ZPKL: numri i rasteve dhe kohëzgjatja e procedurave

Kur ke parasysh numrin e prokurorëve të punësuar në ZPKL, numrin e krimeve të kryera nga forcat serbe dhe numrin e të dyshuarve që

<sup>61</sup> 'Serbi – Dorëzimi i Shqyrtimit Periodik Universal i Këshillit për të Drejtat e Njeriut i KB-ve' (2008).

banojnë në Serbi, numri i aktakuzave (59) në Serbi nuk e reflekton natyrën ose gjerësinë e krimeve të kryera si dhe shkallën e viktimave civile në të dyja anët në konfliktin e armatosur në Kosovë. Pos kësaj, disa gjykime kanë qenë në fazën e tyre paragrafësore për më shumë se 10 vite, kurse disa të tjera ende janë duke qëndruar pezull dhe të papërfunduara deri më sot. Kjo kohëzgjatje abuzive ilustron mirë nga Rasti i Tërnjes, i cili është iniciuar falë nismës së FDH-së për të bërë trysni lidhur me akuzat kundër kryerësve të pretenduar të krimeve. Derisa informacioni lidhur me kryerësit është bërë publik qysh në fillim të vitit 2002, procedurat kanë zgjatur deri në fund të vitit 2013!<sup>62</sup> Jo vetëm kaq, dosja e varfër në kuptimin e numrit të aktakuzave nga gjykatat në Serbi duhet të kuptohet nga krahasimi me atë Dhomes së Krimeve të Luftës të Gjykatës Shtetërore të B dhe H dhe të Kroacisë, ku me dhjetëra raste kanë përfunduar, gjë që e vë në pyetje angazhimin e Serbisë ndaj drejtësisë.<sup>63</sup>

### 16.2. Numri i vogël i të akuzuarve kryerës të krimeve të nivelit të lartë

Jo vetëm se ka qenë fare i vogël numri i gjykimeve, por, po ashtu, kanë mbizotëruar aktakuzat kundër individëve të shkallës së ulët si dhe aktakuzat, të cilat përfshijnë ngjarje me një numër të vogël të viktimave dhe të kryerësve. Ndërsa GJPNJ e ka konstatuar përgjegjësinë e zyrtarëve të lartë ushtarak dhe policor të ish Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë për krimet e kryera në Kosovë, ka qenë radha që të vazhdohet tutje me zyrtarët e shkallës së mesme dhe me pjesën e mbetur të zyrtarëve të lartë.<sup>64</sup> Fakti se ka dështuar në masë të madhe për të vepruar në këtë mënyrë, është kritika më e shpeshtë që i bëhet punës së DKLJGJL-së. Në të vërtetë, 3 vite pas themelimit të tij, DKLJGJL ka ngritur aktakuzë vetëm kundër gjashtë individëve që mbajnë njëfarë lloji të pozitës së lartë në ushtri, polici dhe në hierarkinë politike.<sup>65</sup> Ky hezitim për të ngritur aktakuzat kundër zyrtarëve të rangut të lartë pjesërisht

<sup>62</sup> 'Dhjetë vite të Ndjekjes së Krimeve të Luftës në Serbi: Konturat e drejtësisë' (2013) ('Ten Years of War Crimes Prosecutions in Serbia: Contours of Justice').

<sup>63</sup> Dhjetë vite të Ndjekjes së Krimeve të Luftës në Serbi: Konturat e drejtësisë ('Ten Years of War Crimes Prosecutions in Serbia: Contours of Justice') (2013).

<sup>64</sup> Bogdan Ivanisheviq (2007).

<sup>65</sup> Bogdan Ivanisheviq (2007).

mund të shpjegohet me onnipotencën e perceptuar të armatës dhe të policisë, e cila nuk i është shtruar në mënyrën e duhur procedurës së verifikimit [pas luftës (shih kapitullin e fundit). Pos kësaj, ZPKL për një kohë të gjatë ka argumentuar se vullnetarisht është përcaktuar për peshqit e vegjël me qëllim që të ndërtojë legjitimitetin publik para se të sjellë individët me ndikim para drejtësisë. Nëse ka qenë ose kjo strategji adekuate në fillim të punës së saj mbetet fakti se kjo çështje vazhdon për më shumë se dhjetë vite.<sup>66</sup> Rezultati është në hendekun e madh të drejtësisë midis një numri të vogël të individëve të rangut të lartë të ndjekur penalisht në Hagë dhe ushtarëve të rangut shumë të ulët, paramilitarëve dhe zyrtarëve policorë të ndjekur penalisht në DKLJL, që ka rezultuar në mosndëshkim për shumicën e zyrtarëve të lartë ushtarak dhe policor.<sup>67</sup>

### 16.3. Hetimet defektive, gjykimet kontroverze dhe politika e dënimeve

Vëzhguesit kanë konstatuar se ZPKL ndonjëherë i ka sajuar aktakuzat mbi bazën e hetimeve jo të plota në rastet e krimeve të luftës të kryera në Kosovë. Ngjashëm, aktakuzat janë të prira për t'u modifikuar në minutën e fundit që të jenë më të buta ndaj të akuzuarve.<sup>68</sup> Pos kësaj, vlerësimi i vendimeve të dhëna nga gjykata ndonjëherë është vlerësuar si profesional dhe objektiv dhe ndonjëherë politikisht – më parë se sa ligjrisht – i motivuar, ashtu siç është argumentuar në Rastin Kashnjeti, ose në rastin Bytyqi, ku puna joprofesionale e prokurorit ka çuar deri te gjetjet e Dhomës se faktet kanë qenë të pasakta dhe kontradiktore.<sup>69</sup> Pos kësaj, ndonjëherë është pohuar se së tepërmi peshë i është dhënë rrethanave lehtësuese në politikën e dënimeve nga ana e gjykatës, gjë që ka rezultuar në dënime më të buta.<sup>70</sup>

Këto mangësi në efikasitet janë rezultat i një numri të madh të

66 Bogdan Ivanisheviq (2007).

67 "Serbi: përfundimi i Mosndëshkimit për Krimet kundër Ligjit Ndërkombëtar" ("Serbia: Ending Impunity for Crimes against International Law") (2014).

68 "Gjykimet për Krimet e Luftës dhe Krimet Etnikisht të Motivuar në Serbi në vitin 2010" "Trials for War Crimes and Ethnically Motivated Crimes in Serbia in 2010" (2011).

69 "Serbi: përfundimi i Mosndëshkimit për Krimet kundër Ligjit Ndërkombëtar" (2014).

70 "Gjykimet për Krimet e Luftës dhe Krimet Etnikisht të Motivuar në Serbi në vitin 2010" (2011).

problemeve, duke filluar nga mungesa e kontakteve ndërqeveritare për shkak të refuzimit të Serbisë për të njohur Kosovën dhe pengimi i procesit të mbledhjes së dëshmive e deri te ngurrimi i shqiptarëve të Kosovës për të bashkëpunuar me ZPKL. Po ashtu është edhe rezultat i mungesës së madhe të resurseve. Pavarësisht nga validiteti i këtyre arsyeve, fakti se krimet kundër shqiptarëve të Kosovës në masë të madhe kanë shkuar të padënuara, e shpjegon nivelin e ulët të besimit në ZPKL nga shqiptarët në Kosovë.<sup>71</sup>

## 17. Faktorët, të cilët e pengojnë DKLJL, dhe potenciali i ndikimit të ZPKL

### 17.1. Mungesa e vullnetit politik

Nacionalizmi etnik mbetet i fuqishëm në Serbi, ashtu siç është demonstruar nga përkrahja e madhe publike për partitë politike nacionaliste dhe kjo e dobëson vendosmërinë dhe efikasitetin e DKLJL, të ZPKL dhe të SHHKL. Elitat serbe ende deri në masë të caktuar janë të angazhuara në mohimin e përgjegjësisë për krimet e kryera nga pjesëtarët e forcave serbe gjatë luftërave jugosllave. Për këtë arsye, DKLJL dhe ZPKL kanë qenë të përfshira nga mungesa e vullnetit politik për të përkrahur punën e tyre qoftë politikisht qoftë financiarisht dhe ndikimi i politikave nacionale në Serbi, nga pranimi vetjak i ZPKL, shpesh ka rezultuar në trysinë politike mbi procedurat – nga përkrahja e hapur për injorancën e deri te sulmi i drejtpërdrejtë i qeverisë në pushtet.<sup>72</sup> Mungesa e përgjithshme e përkrahjes nga figurat e njohura serbe për ndjekjen penale të krimeve të luftës ka ndodhur në një kontekst më të gjerë të një armiqësie të mprehtë kundrejt punës së GJNPJ në Serbi, gjerësisht e trajtuar si një institucion anti-serb. Kjo ndjenjë është shfrytëzuar lehtësisht dhe në masë të madhe për t'iu përshtatur agjendave të ndryshme politike gjatë kohës.

Përveç kësaj, ambivalenca politike lidhur me gjykimin e krimeve të

71 Bogdan Ivanisheviq (2007)

72 "Serbi: përfundimi i Mosndëshkimit për Krimet kundër Ligjit Ndërkombëtar", (2014). "Serbia: Ending Impunity for Crimes against International Law" (2014).

luftës në Serbi është një shembull i një mungese të gjerë të një procesi të suksesshëm të një drejtësie tranzicionale në Serbi. Në të vërtetë, përkundër shumë problemeve dhe të metave të identifikuar lidhur me ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për krimet e luftës, është fusha në të cilën është regjistruar progresi më i dukshëm.<sup>73</sup> Njëmend, pavarësisht prej kësaj fushe, drejtësia tranzicionale në Serbi është shënjuar me mungesë të çfarëdo përpjekjeje për gjetjen e së vërtetës, me dobësinë e programeve të reparacioneve dhe me mungesën e madhe të verifikimit zyrtarëve, të cilët mund të jenë të përfshirë në krimet e së kaluarës. Këto mangësi në DT si tërësi e ilustron kredinë dhe fuqinë politike të atyre individëve, të cilët ende refuzojnë për t'u marrë me të kaluarën e Serbisë dhe të cilët mbështeten në perceptimin gjerësisht të përhapur të historisë në të cilin Serbia është viktimë e kompleteve të faktorëve të jashtëm. Mungesa e proceseve të tjera të drejtësisë tranzicionale në nivel vendor e vendos një përgjegjësi shtesë mbi prokurorët dhe gjyqtarët e përfshirë në ndjekjen penale të krimeve të luftës.<sup>74</sup>

## 17.2. Mungesa e burimeve financiare, njerëzore dhe teknike

Pjesërisht për shkak të mungesës së përkrahjes politike, fondet në dispozicion për ZPKL dhe DKLJGJL janë së tepërmi të pakta për detyrat për të cilat kanë nevojë për t'i kryer. Kjo mungesë e burimeve krijon vështirësi të përditshme, e pengon kapacitetin e tyre për të rekrutuar avokatë mbrojtës dhe nuk i mbulon shpenzimet e udhëtimit të prokurorëve (vizitat në terren, udhëtimet në Hagë ose në Kosovë). Përveç kësaj, të dyja institucioneve në mënyrë serioze iu mungon personeli, në mënyrë specifike me mungesë të analistëve dhe të asistentëve ligjor.<sup>75</sup>

Për më shumë, problemet teknike e pengojnë aftësinë e ZPKL dhe DKLJGJL për të ndjekur rastet e nivelit të lartë të krimeve të luftës. Në të vërtetë, shkalla dhe planifikimi i krimeve të tilla bëhen brenda

73 "Dhjetë vite të Ndjekjes së Krimeve të Luftës në Serbi: Konturat e Drejtësisë", ("Ten Years of War Crimes Prosecutions in Serbia: Contours of Justice" (2013).

74 Bogdan Ivanisheviq (2007).

75 "Dhjetë vite të Ndjekjes së Krimeve të Luftës në Serbi": Konturat e Drejtësisë' (2013) ("Ten Years of War Crimes Prosecutions in Serbia: Contours of Justice" (2013); ; Bogdan Ivanisheviq (2007).

sistemit. Sfida kryesore në ndjekjen e tyre penale është në nënvizimin e natyrës së pjesëmarrjes dhe të njohurive si dhe të qëllimit të atyre që janë përgjegjës. Për ta bërë këtë, pos teknikave tradicionale të hetimit, (*inter alia*, rekonstruktimi i vendit të krimit dhe analizat mjekoligjore), kërkohen edhe analiza specifike të praktikave të veçanta dhe struktura të organizatave ushtarake dhe paramilitare si dhe analiza të marrëdhënieve politike dhe institucionale në vend si dhe një studim i kujdesshëm i kontekstit lokal dhe i dinamikave të konfliktit. Shkathtësitë teknike të nevojshme për të realizuar këtë kërkim shkojnë përtej teknikave të zakonshme të hetimit kriminal dhe kërkojnë kontribute nga historianët dhe analistët politik e ushtarak.<sup>76</sup> Mungesa e burimeve, përkundër donacioneve të ndryshme, është në masë madhe përgjegjëse për mungesën e kapacitetit për të proceduar me ngarkesën e punës dhe me kohëzgjatjen e gjykimeve.<sup>77</sup>

## 17.3. Bashkëpunimi me Njësinë e Policisë

Ka ekzistuar një mungesë kronike e angazhimit dhe e nismës nga Shërbimi i Hetimit të Krimeve të Luftës (SHHKL), njësia e policisë me mandat hetimin e krimeve të luftës dhe bashkëpunimi me ZPKL. Mandati i tyre përfshin komponentin e bashkëpunimit (arrestimi dhe asistimi në ZPKL në mbledhjen e provave që duhet të përdoren në gjykime), por, po ashtu, edhe komponentin e nismës së vërtet (zbulimi i kryerësve dhe paraqitja e informacionit para ZPKL). Në të vërtetë, deri më sot, jo vetëm që SHHKL nuk ka bashkëpunuar gjithnjë në kohën dhe në mënyrën adekuate (dështimi për të proceduar shpejt me urdhëresat, dyshimi i animit në ngurrimin e tyre për të arrestuar individët serb etj.), por SHHKL pothuajse asnjëherë në mënyrë spontane nuk i është qasur ZPKL me informacione lidhur me kryerësit potencial (me përjashtim të Rastit Suhareka). Disa vëzhgues kanë pohuar se marrëdhënia midis këtyre 2 agjencive të krijuara për të punuar së bashku ka qenë, në të vërtetë, pika më e dobët në këtë sistem.<sup>78</sup>

76 Bogdan Ivanisheviq (2007).

77 "Serbi: Përfundimi i Mosndëshkimit për Krimet kundër Ligjit Ndërkombëtar (2014), (Serbia: Ending Impunity for Crimes against International Law" (2014).

78 "Dhjetë vite të Ndjekjes së Krimeve të Luftës në Serbi": Konturat e Drejtësisë' (2013), "Ten Years of War Crimes Prosecutions in Serbia: Contours of Justice" (2013); ; Bogdan Ivanisheviq (2007).

#### 17.4. Bashkëpunimi me UNMIK-un dhe EULEX-in

Për arsye se krimet nën juridiksionin e DKLJGJL nuk janë kryer në territorin e tashëm të Serbisë, agjencitë në Serbi nuk kanë kompetenca mbi Kosovën dhe, së këndejmi, as edhe mënyra të kontaktimit dhe të vendosjes drejtpërdrejt të dëshmitarëve. Madje, edhe nëse kanë pasur, ka shumë gjasë se dëshmitarët potencial do të refuzonin për të bashkëpunuar pa ndërmjetësimin e palës së tretë duke pasur parasysh se shumica e shqiptarëve të Kosovës thellësisht nuk i besojnë institucioneve të Serbisë. Agjencitë e krimeve të luftës në Serbi mund ta kryejnë punën e tyre vetëm përmes bashkëpunimit me agjencitë përkatëse në Kosovë. Megjithatë, ngaqë Serbia nuk e njeh zyrtarisht pavarësinë e ish krahinës së saj, ZPKL nuk ka pasur kontakte me gjyqësorin e Kosovës dhe, së këndejmi, i ka mbledhur provat e veta me ndihmën e UNMIK-ut dhe, pastaj, të EULEX-it. Një bashkëpunim i tillë për një kohë të gjatë ka qenë i përfshirë nga një përparim shumë i ngadalshëm në kohën e UNMIK-ut, gjë që pjesërisht e shpjegon numrin e vogël të rasteve që lidhen me Kosovën e të iniciuara nga gjykata. Bashkëpunimi i kohëve të fundit me EULEX-in, brenda kornizës së Protokollit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë dhe EULEX-it ka qenë shumë më i frytshëm.<sup>79</sup>

#### 17.5. Çështjet që lidhen me përkrahjen e dëshmitarëve dhe me mbrojtjen e dëshmitarëve

Njësia për Përkrahjen dhe Asistencën e Dëshmitarëve (NjPD) e DKLJGJL – po ashtu me burime dhe me personel të paktë – në mënyrë joadekuate e ka përbushur detyrën e saj në ndihmën e ofruar dëshmitarëve gjatë procedurave për arsye se vetëm pjesërisht ia ka dalë të krijojë kushte të lira dhe të njëmendta për dëshmi të dëshmitarëve. Këto mangësi kanë çuar deri tek pohimet serioze të frikësimit, zmbarsjes së dëshmitarëve nga të dëshmuarit.

Pos këtyre kufizimeve inherente, një nga sfidat më të mëdha për ZPKL dhe ZKLJGJL ka qenë fakti se nuk kanë pasur në dispozicion

79 "Dhjetë vite të Ndjekjes së Krimeve të Luftës në Serbi": Konturat e Drejtësisë' (2013); Bogdan Ivanišević (2007), 'Ten Years of War Crimes Prosecutions in Serbia: Contours of Justice'(2013); Bogdan Ivanišević (2007).

dëshmitarë. Në të vërtetë, dëshmitarët, derisa ata në përgjithësi janë pajtuar për t'u takuar me prokurorët dhe gjyqtarët hetues serb në Prishtinë, për një kohë të gjatë skajshëm kanë ngurruar për të dëshmuar në Beograd, duke i ngadalësuar procedurat dhe ndonjëherë duke penguar zhvillimin e gjykimeve. Nga fundi i vitit 2007, është arritur njëfarë progresi ngaqë dëshmitarët shqiptarë janë pajtuar që të paraqiten para gjykatës në Beograd në gjykimin e Rastit Suhareka.<sup>80</sup>

Për ta thënë përmbledhtazi, konteksti i pafavorshëm politik, i cili krijon mungesa në burimet, dhe bashkëpunimi i dobët i DKLJGJL dhe ZPKL me SHHKL, NjPD dhe gjyqësorin e Kosovës, në masë të madhe e kanë kufizuar sistemin gjyqësor të Serbisë për të sjellë kriminelët e dyshuar të luftës para drejtësisë.<sup>81</sup> Ai rezulton në një vëllim të vogël të rasteve që fokusohen në mënyrë mbizotëruese në peshqit e vegjël.

#### 18. Shfrytëzimi i trashëgimisë së GJPNJ<sup>82</sup>

GJPNJ i ka kontribuar ndjekjes së krimeve të luftës në Serbi në disa mënyra. Në veçanti, kontributi i GJPNJ për gjykimet e krimeve të luftës po ashtu ka marrë edhe formën e trajnimit të gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të zyrtarëve të përfshirë në përkrahjen e dëshmitarëve lidhur me thelbin e ligjit penal ndërkombëtar, duke përfshirë mënyrat e përgjegjësisë siç është përgjegjësia komanduese dhe inovacionet procedurale, siç është çështja se si funksionon në praktikë një dëshmi via (përmes) video-link-ut. Për më shumë, të gjithë gjyqtarët e DKLJGJL e kanë vizituar GJPNJ dhe shumë prej tyre kanë marrë pjesë në konferenca mbi bashkëpunimin rajonal lidhur me ndjekjen penale të krimeve të luftës të organizuara në vitin 2007.

Në lidhje me shfrytëzimin e provave të GJPNJ dhe të së drejtës materiale nga juridiksioni kombëtar, të gjithë komentuesit pajtohen se bashkëpunimi duhet të jetë shumë më proaktiv. Derisa provat nga

80 Bogdan Ivanisheviq (2007), "Serbi: Përfundimi i Mosndëshkimit për Krimet kundër Ligjit Ndërkombëtar (2014), Bogdan Ivanishëvić (2007) ; "Serbia: Ending Impunity for Crimes against International Law" (2014)

81 'Serbi - Dorëzimi i Shqyrtimit Periodik Universal i Këshillit për të Drejtat e Njeriut i KB-ve' (2008), 'Serbia - Submission to the Universal Periodic Review Of the UN Human Rights Council' (2008).

82 Bogdan Ivanisheviq (2007).

GJPNJ i kanë kontribuar progresit të hetimeve dhe të gjykimeve – në mënyrë specifike në Rastin Suhareka, që në masë të madhe është mbështetur në provat e GJPNJ – bashkëpunimi me GJPNJ herë pas herë ka qenë i komplikuar dhe ka ndodhur që provat e saj, në të vërtetë, kanë mbetur në prapavijë dhe janë keqpërdorur. Ka nevojë të arrihet më shumë simbiozë në këtë nivel, ngaqë një pjesë e provave të dërguara në GJPNJ mbetet e pashfrytëzuar nga gjykatat vendore, me çka përjetësohet mosndëshkimi.

Përkundër mungesave të tyre, DKLJL dhe ZPKL kanë potencial për të siguruar drejtësinë për shumë viktime të mizorive të kryera gjatë luftës në ish Jugosllavi. Në të vërtetë, kapacitetet e tyre në mënyrë të rëndësishme janë zhvilluar në vitet e fundit. Brengosjet mbesin para së gjithash lidhur me mungesën e progresit në rastet e nivelit të mesëm si dhe lidhur me shfrytëzimin e kufizuar të provave të GJPNJ për të iniciuar aktakuza të rëndësishme për ofrimin e drejtësisë.

**Është dashur të ketë më shumë bashkëpunim me GJPNJ: Operacioni Reka dhe varreza e Batajnicës<sup>83</sup>**



- Operacioni Reka ka çuar deri te krimi më mizor kundër civilëve i kryer gjatë luftës në Kosovë dhe një nga më mizorët nga të gjitha krimet e kryera në vitet 1990-të në ish Jugosllavi. Në datën 27 dhe 28 prill të vitit 1999, Armata Jugosllave (AJ) dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (MPB) kanë zhvilluar një operacion të përbashkët të shkallës së gjerë në fshatrat e Kosovës që shtrihen në perëndim të qytetit të Gjakovës, ku së paku 350 shqiptar etnik civil janë vrarë dhe me mijëra e mijëra janë dëbuar për në Shqipëri. Mbetjet mortore të 309 viktimave janë gjetur në varrezën sekrete masive të Batajnicës në periferi të Beogradit në vitin 2001.

- GJPNJ, në rastet Gjorgjeviqi dhe Shainoviqi dhe të tjerët i ka konstatuar rrethanat e kësaj masakre, duke përfshirë edhe rolin e saktë të AJ-së dhe të MPB-së, modelin e krimeve dhe fshehjen e më pastajme të trupave. Në datën 27 prill të vitit 1999, ushtarët e AJ dhe policët kanë hyrë në fshatrat e banuara me shqiptarë të asaj zone (Dobrosh, Ramoc, Rracaj, Korenicë, Molliq, Brovina, Guskë, Nivokaz dhe të tjera), i kanë urdhëruar banorët vendas të nisen për në Shqipëri dhe, duke vepruar kështu, edhe i kanë vrarë me dhjetëra civilë (68 janë vrarë në Korenicë). Disa mijëra fshatarë i kanë formuar dy konvoje dhe kanë vazhduar drejt qytetit të Gjakovës. Në fshatin Mejë, konvoji ka kaluar nëpër dy punkte të kontrollit, ku policia i ka ndarë 274 meshkuj nga konvoji, duke iu urdhëruar të tjerëve të për të vazhduar në drejtim të Shqipërisë. Mbetjet mortore të atyre 252 burrave janë gjetur në vitin 2001 në një varrezë masive në Batajnicë, 10 në Mejë dhe në fshatrat përreth, kurse 12 ende nuk janë gjetur. Si dhe ku saktësisht ata janë vrarë ende nuk është gjetur, ngaqë kjo është një nga masakrat e vetme të luftës me asnjë të mbijetuar dhe, së këndejmi, pa asnjë dëshmitarë okular.

- Pothuajse i gjithë lidhshipi i policisë dhe i ushtrisë i Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) është gjetur fajtor dhe është dënuar nga GJPNJ për krimet e kryera në Operacionin Reka. Sidoqoftë, deri më sot, as edhe një individ i vetëm nuk është gjykuar para gjykatave serbe për krimet e kryera në Operacionin Reka ose për fshehjen e trupave në varrezën masive në Batajnicë, përkundër faktit se gjatë gjykimeve të GJPNJ, njësitë policore dhe ushtarake, të cilat kanë marrë pjesë, janë identifikuar.

- Derisa ZPKL ka njoftuar se rasti do të hetohet në vitin 2004, më shumë se 10 vite më vonë nuk janë nisur as farë hetimesh, përkundër provave të fuqishme mbi modelin e krimeve dhe të përfshirjes së zyrtarëve serb. Në të vërtetë, është në dispozicion informacioni, se njësitë policore dhe ushtarake serbe kanë marrë pjesë në Operacionin Reka. Një numër i caktuar i këtyre personave të cilët kanë kryer krimet në Operacionin Reka janë duke mbajtur pozita të rëndësishme në institucionet serbe sot. Kjo vlen posaçërisht për rastin e Momir Stojanoviqit, pjesëtar i tashëm i Kuvendit të Republikës së Serbisë dhe Kryesues i Komisionit Parlamentar për Kontroll të Shërbimeve të Sigurisë përkundër pjesëmarrjes së qartë në Operacionin Reka.

- Për shkak të gjerësisë dhe shkallës së mizorive, ky rast duhet të jetë prioritet për hetime dhe ndjekje penale, posaçërisht ngaqë provat lidhur me këtë tashmë kanë qenë prezantuar dhe pranuar në gjykatë. Megjithatë, deri më tash, komunikimet nga ZPKL kanë konstatuar se asnjë konkluzion i besueshëm nuk është arritur në lidhje me identitetin e kryerësve.

83 'Operacioni Reka' (2015) ; Serbi: Serbi: Përfundimi i Mosndëshkimit për Krimet kundër Ligjit Ndërkombëtar (2014), "Serbia: Ending Impunity for Crimes against International Law" (2014).

84 photo: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/8671783.stm>

Përkundër mungesave të tyre, DKLGJL dhe ZPKL kanë potencial për të siguruar drejtësinë për shumë viktime të mizorive të kryera gjatë luftës në ish Jugosllavi. Në të vërtetë, kapacitetet e tyre në mënyrë të rëndësishme janë zhvilluar në vitet e fundit. Brengosjet mbesin para së gjithash lidhur me mungesën e progresit në rastet e nivelit të mesëm si dhe lidhur me shfrytëzimin e kufizuar të provave të GJPNJ për të iniciuar aktakuza të rëndësishme për ofrimin e drejtësisë.

## **PËRFUNDIM:**

### **GJYKIMET E DOMOSDOSHME, POR TË PAMJAFTUESHME**

Ashtu siç e ka treguar ky kapitull deri tash, rasti i Kosovës është një rast i madh i studimit të çështjeve dhe të kontroversave lidhur me ndjekjet penale në kontekstet post-konfliktuale. Ai ilustron dilemat e gjykimeve ndërkombëtare përballë atyre vendore dhe çështjen kryesore të perceptimit të drejtësisë nga viktimat. Këto të fundit shpesh ndikohen negativisht nga kufizimet inherente dhe të konstruara të gjykimeve si dhe nga qëllimet jashtëzakonisht ambicioze të vëna para ndjekjeve penale ndërkombëtare, që vlerësohet se duhet të arrijnë drejtësinë për viktimat, llogaridhënien, forcimin e demokracisë, zbrapsjen dhe pajtimin së bashku. Këto kontroversa mund të grupohen në 4 aspekte të ndërlidhura dhe çojnë tek përfundimi se gjykimet vetëm nuk mund të udhëheqin detyrën e tërësishme të DT dhe sepse kanë nevojë për t'u kombinuar me mekanizma të tjerë.

***Mospërputhja midis të pritmeve joproporcionale të vendosura për gjykimet dhe kufizimet e tyre inherente dhe të konstruara.***

Derisa Dt është një ndërmarrje shumë e rëndësishme, asnjëri prej mekanizmave të krijuar për ta sendërtuar atë nuk është i përsosur dhe ata të gjithë i kanë kufizimet e tyre inherente. Gjykimet, për shkak të selektivitetit të domosdoshëm, mund të jenë vetëm një mënyrë e pjesshme për të trajtuar shkeljen sistematike të të drejtave të njeriut pas konfliktit. Jo vetëm kaq, fakti nëse këto ndjekje penale zhvillohen në nivel vendor ose jashtë ka një ndikim në efikasitetin e tyre dhe në perceptimin se drejtësia ka shkuar në vend për viktimat. Pos kësaj, ekzistojnë thjesht limite lidhur me atë se çka mund të arrijnë gjykimet, duke qenë se drejtësia retributive nuk është zgjidhja për viktimat (shih më poshtë). Duke pasur parasysh këto kufizime inherente, pengesa kryesore për efikasitetin e plotë të drejtësisë penale janë gabimet në menaxhimin e gjykimeve penale vendore dhe ndërkombëtare (çështjet me terrenin, mbrojtja e dëshmitarëve etj.).<sup>85</sup>

<sup>85</sup> Orentlicher (2010)

## ***Kufizimet e Drejtësisë Retributive, me gjithë kërkesën e qartë për llogaridhënie***

Derisa më shumë se 800 trupa janë gjetur në varrezën e Batajnicës dhe 52 në varrezën e Rudnicës, vetëm një grusht individësh janë ballafaquar me gjykimet si në gjykatat ndërkombëtare ashtu edhe në ato vendore, duke lënë kështu përshtypjen se shumë nga ato krime mbeten të pagjetura në mesin e viktimave dhe të familjeve shqiptare. Kjo është, madje, e vërtetë edhe për viktimat serbe. Selektiviteti i gjykimeve siguron një drejtësi të pashmangshme simbolike.<sup>86</sup> Kryerësit kryesor dhe disa nga viktimat e tyre do të dëgjohen, por shumica e viktimave jo. Për më shumë, gjatë gjykimeve, viktimat janë vetëm një nga elementet e procedurave: dëshmia e tyre do të hetohet nga vet gjykata me qëllim që të konstatojë ose të hedh fajin, por ata nuk janë në gjendje për të treguar historinë e tyre të vërtetë dhe vlerësimet e tyre gjithmonë do të sfidohen.<sup>87</sup> Drejtësia penale është ndëshkuese, por, megjithëkëtë, kjo mund të mos sjell satisfaksionin e plotë për viktimat individuale nëse ato e perceptojnë rolin e tyre si sekondar krahasuar me atë të kryerësve.<sup>88</sup>

Ky frustrim me drejtësinë e ofruar nga gjykimet duhet të harmonizohet nga vlera e padiskutueshme e përfundimit të mosndëshkimit, evident në kënaqësinë e qartë që e sjellë për viktimat, të cilat, në përgjithësi, parapëlqejnë më parë një drejtësi të papërsosur se sa mungesë të drejtësisë fare.<sup>89</sup> Në të vërtetë, frustracionet e shprehura kundruall faktit se disa kriminel mbesin të paprekur nga GJNPJ, e ilustron faktin se dorëzimi tyre para drejtësisë është ajo çka ata dëshirojnë.<sup>90</sup> Derisa gjykatat fokusohen në mënyrë të tepruar në kryerësit, ato ua sigurojnë viktimave llogaridhënien të cilën ata e kërkojnë.<sup>91</sup> Sidoqoftë, ashtu siç është treguar nga shembulli i ndjekjeve penale në Kosovë nga GJNPJ, nga gjykimet e EULEX-it dhe nga gjykatat serbe, ndërsa kërkesa për retribucion duhet të plotësohet, forma më të shumta të drejtësisë retributive po ashtu janë të domosdoshme.

<sup>86</sup> Për shkak se miliona njerëz janë të prekur, posaçërisht për faktin se një aktakuzë e vetme i kërkon disa vite, shumë dokumente dhe dëshmi, gjyqtarë dhe avokatë etj. shih Akman (2008), p132

<sup>87</sup> Akman (2008), p134

<sup>88</sup> Akman (2008), p133 ; Clark (2009), p464

<sup>89</sup> Orentlicher (2010), p33

<sup>90</sup> Clark (2009), p471

<sup>91</sup> Ibid, p486

Komisioni i së Vërtetës (KV), duke i vënë viktimat në qendër, mund të kontribuojë më shumë në procesin e shërimit të tyre.<sup>92</sup> Jo vetëm kaq, KV-të iu shmangen procedurave ligjore voluminoze përmes sigurimit të një platforme zyrtare po edhe fleksibile që secila viktimë të dëgjohet, duke iu dhënë 'zë atyre që janë të pazë'.<sup>93</sup>

## ***Kontributi i kufizuar i gjykimeve në pajtimin***

Në nivel të pajtimit, ndjekja penale në Kosovë i ka lënë të dyja komunitetet me një ndjenjë se shumë nga mizoritë e kryera gjatë konfliktit kanë shkuar të pandëshkuara dhe ka rezultuar në një ndjenjë në të dyja palët se, në ndjekjen penale të krimeve të luftës, "palës tjetër" i është akorduar një trajtim preferencial. Komuniteti serb e vë gishtin tregues në numrin e ulët të të dënuarve shqiptarë për krime të luftës të kryera kundër serbëve dhe në dështimin për të dënuar politikanët e profilit të lartë. Në mënyrë të ngjashme, një ankesë e përbashkët e zakonshme nga komuniteti shqiptar është se vëmendje e tepruar i është kushtuar ndjekjes penale të shqiptarëve, ndërsa aq shumë viktimave shqiptare nuk iu është ofruar drejtësi (në veçanti në kontekstin e tashëm të krijimit të gjykatës speciale dhe të zhvarrimeve nga varrezat masive në Rudnicë). Është argumentuar se gjykimi i atyre që bartin përgjegjësinë më të madhe do të mundësonte rënien e fenomenit të fajësimit kolektiv, i cili është një tipar i përsëritur i luftërave bashkëkohore civile, via ekspozimit të rolit të lidërshiptit në përkeqësimin e urrejtjeve dhe në manipulimin e opinionëve. Sidoqoftë, selektiviteti i gjykimeve dhe perceptimi i tyre përmes një prizmi etnik nuk e ka çrrënjësuar fajin kolektiv dhe, në të vërtetë, i ka përkeqësuar narrativat etnik më parë se sa i ka shpërndarë ato. Kundër kësaj të mete, e vërteta e siguruar me anë të KV-ve, e cila shkon përtej 'të vërtetës gjyqësore të pastër', të siguruar me anë të gjykimeve, mund të jetë një ndihmë e madhe për të ndërtuar një memorie kolektive dhe një përparim kundruall pajtimit.

<sup>92</sup> Shih çështjet me këtë term mjekësor në Kerr & Mobekk (2007), p136

<sup>93</sup> Akman (2008), p134 ; Kerr & Mobekk (2007), p138



## Shumëllojshmëria e nevojave, komplementariteti i mjeteve

Për shkak të prirjes ndërkombëtare për gjykime, nevojat e viktimave shpesh janë reduktuar në një dëshirë të vetme për dënimin retributiv. Derisa dëshira e tillë është shumë reale, ajo është vetëm një aspekt i asaj që ka nevojë për t'u rimëkëmbur pas konfliktit. Vlerësimi i situatës në Kosovë tregon se trashëgimia e gjykimeve penale nuk është as e zezë e as e bardhë. Ndjekjet penale në këtë kontekst kanë qenë më se të nevojshme, për arsye se ato janë shumë të rëndësishme për viktimat dhe e sjellin drejtësinë, të vërtetën dhe pajtimin, fatkeqësisht jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, siç pritet për ta bërë.<sup>94</sup> Megjithëkëtë, është me rëndësi kyçe për të përkujtuar se – për shkak të kufizimeve dhe të metave të veta – gjykimet duhet të jenë pjesë e një qasjeje holistike dhe të integruar për Drejtësinë Tranzicionale.<sup>95</sup> KV-të, duke u fokusuar më shumë në kërkimin e së vërtetës dhe në pajtimin, janë po ashtu një pjesë barabarësisht e rëndësishme e drejtësisë tranzicionale që e plotësojnë si një mozaik njëra-tjetrën.<sup>96</sup>

### Roli i paqartë i ndjekjes penale ndërkombëtare në Ugandën Veriore<sup>97</sup>



98

Në dritën e shqyrtimeve të parashtruara në hyrje si dhe të hetimeve të rolit të gjykimeve në Kosovë, mund të tërhiqet një paralele përmes shikimit të ndikimit të ndjekjeve penale të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN) në Uganda që nga viti 2004 dhe në rezervimet e shprehura lidhur me rëndësinë kulturore dhe ndikimin e saj në pajtimin vendor.

94 Degruson (2014), p11

95 Lambourne (2008) ; Mani (2002)

96 Ibid, p128

97 Degruson (2014)

98 photo: Kersten M. <http://justiceinconflict.org/2011/10/18/revisiting-the-peace-justice-debate-in-northern-uganda/>

### 1. Drejtësia ndërkombëtare përballë kornizës së drejtësisë vendore dhe drejtësia retributive përballë drejtësisë restorative është thellësisht e goditur në Uganda

- Një nga kritikët e mëdha të përfshirjes së GJPN në Uganda ka qenë se drejtësia retributive nuk i është përgjigjur viktimave dhe se intervenimet e GJPN kanë qenë një heqje e parapëlqimeve të drejtësisë zakonore, një sistemi të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për një kohë të gjatë i bazuar në faljen dhe në rimëkëmbjen e anëtarësisë së klanit. Këta mekanizma tradicional duket se kanë premtuar një pronësi më të thellë vendore dhe një pranueshmëri kulturore në Uganda.<sup>99</sup>
- Megjithëkëtë, kundërvënja e këtyre mekanizmave ndaj drejtësisë penale si një tërësi ka qenë se tepërmi thjeshtësuese, ashtu siç anketat kanë treguar se qëndrimet kundrejt kuptimit të drejtësisë kanë qenë të formuara nga përvojat personale të dhunës, nga anëtarësia e grupit, nga përkatësia kulturore dhe, së këndejmi, ka qenë dinamike dhe në asnjë mënyrë e përgjithësuar. Ngaqë angazhimi substancial drejt llogaridhënies ka qenë i regjistruar, kjo ka pasur kuptimin se mekanizmat e bazuar në faljen nuk e kanë shtypur kërkesën për llogaridhënie nga pjesë të caktuara të shoqërisë së Ugandës Veriore.<sup>100</sup>
- Polarizimi i debatit midis drejtësisë ndërkombëtare dhe asaj vendore dhe drejtësisë retributive përballë asaj restorative është së tepërmi përthjeshtësues, ngaqë asnjëra prej tyre vetëm nuk ka gjasë që në mënyrë adekuate të përmbush kërkesat e drejtësisë vetëm në një konflikt ashtu kompleks dhe shumështrësor. Si GJPN ashtu edhe mekanizmat tradicional janë të gërryer në lidhje me faktin se ato pohojnë legjitimitetin e padiskutueshëm dhe universal të mënyrës se si ata kërkojnë për ta sjellë drejtësinë. Në të vërtetë, ato janë në të dyja mënyra legjitime për të trajtuar trashëgiminë e konfliktit në Ugandën Veriore.<sup>101</sup>

### 2. Përfshirja e GJPN ka dështuar për t'iu përgjigjur kompleksitetit të konfliktit, duke e penguar pajtimin vendor

- Në Uganda, dikotomia viktimat/kryerësit, e shfrytëzuar në gjykime është e padobishme në të kuptuarit e dinamikave të kësaj lufte, të karakterizuar nga mizoritë e të gjitha palëve dhe ku 85% e LRA është e përbërë nga fëmijët e rrëmbyer, së këndejmi, në mënyrë simultane nga kryerësit dhe viktimat. Në këtë kontekst, sfida e njëmendët ka qenë reintegrimi dhe pajtimi për ata individë dhe disa njerëz kanë pohuar se kjo do të arrihej më mirë përmes rritjeve restorative tradicionale, që fokusohen në faljen dhe në kërkimin e një mënyre të bashkëjetesës midis ish palëve, se sa në ndjekjen penale individuale përçarëse.<sup>102</sup>
- Për më shumë, modeli i ndjekjeve penale të GJPN – i cili fokusohet vetëm në rebelët dhe i përjashton zyrtarët qeveritarë – ka sjellë një paraqitje shumë të paplotë të dhunës dhe të llogaridhënies, kur kihet parasysh historia e gjatë e Ugandës, e cila ka shumë shtresa të ndryshme të përgjegjësive që lëvizin nëpër kohë.<sup>103</sup>

- Në fund, GJPN nuk i ka trajtuar rrënjët strukturale (socio-ekonomike) të luftës, posaçërisht injorimin afatgjatë të veriut. Kur shtrohet çështja lidhur me këtë, rindërtimi ekonomik dhe social është shqetësimi më i madh që ushtron trysni mbi komunitetet e goditura dhe është e qartë se GJPN vet nuk do të sjellë paqen afatgjatë nëse nuk mbështetet nga zhvillimi i përgjithshëm.

*Rasti i Ugandës i tregon kufizimet e ndjekjeve penale në një kontekst të tillë të konfliktit post-konfliktual. Megjithëse ajo është e dëshirueshme dhe e nevojshme, duhet të dizajnohen gjykimet kujdesshëm dhe të përfundohen me anë të mjeteve të tjera siç është DT, programet e riintegritimit dhe asistencë materiale, ngaqë asnjë masë nuk i përshtatet të gjitha zgjidhjeve, që në mënyrë të mjaftueshme mund të rimëkëmbin drejtësinë për viktimat e Ugandës<sup>104</sup>*

## KAPITULLI 4: E DREJTA PËR TË DITUR & KOMISIONET E SË VËRTETËS

Arritja e një versioni të përbashkët të historisë përmes proceseve të kërkimit të së vërtetës, kujtesën e përbashkët për të kaluarën, është thelbësore për pajtimin dhe për ecjen përpara. Derisa shumë instrumente të DT-së i kontribuojnë kërkimit të së vërtetës (siç janë procedurat gjyqësore, regjistrimi i saktë i pësimeve të viktimave, deklasifikimi i arkivave etj.), një nga instrumentet më adekuate janë Komisionet e së Vërtetës (KV-të).

### 19. Qëllimet e kryera përmes të drejtës për të ditur

#### 19.1. E drejta për të ditur për zënë individuale: dobitë nga e vërteta

E drejta për të ditur lidhur me atë se çka ka ndodhur në prag të konfliktit të armatosur iu është njohur të gjitha shoqërive dhe individëve, si një formë e zisë e cila duhet të mbahet pas konfliktit. Gjykatat mund ta lejojnë këtë zi, por vetëm për disa viktimat për shkak të selektivitetit të tyre dhe, së këndejmi, e drejta për të ditur nuk mund të përmbushet plotësisht në gjykatë. E drejta për të ditur po ashtu i parandalon aproksimacionet e viktimave ose të modelit të dhunës, që është i dëmshëm për vet-respektin e viktimave, ashtu siç është konstatuar në kapitullin e parë mbi regjistrimin viktimave.<sup>105</sup>

#### 19.2. E drejta për të ditur dhe për të kuptuar modelin dhe gjerësinë e luftës

Ashtu siç është konstatuar më herët, gjykimet fokusohen në ngjarjet e vetme historike, ngaqë ato duhet të respektojnë parimin e sigurisë ligjore dhe për arsye se duhet të jenë selektiv. E vërteta, të cilën e paraqesin ata, është vetëm e pjesshme. E drejta për të ditur në të

99 Ssenyonjo (2007), p61, pp64-5 ; Hovil & Quinn (2005), p24 ; Nagy (2013),

100 Otim & Wierda (2010)

101 Hovil & Quinn (2005), p31; Branch (2007), p193

102 Nagy (2013)

103 Nagy (2013)

104 Allen (2006), p160

105 Nisma KOMRA' (2012)

vërtetë shkon përtej të “vërtetës” së pastër gjyqësore, me qëllim që viktimat të kuptojnë modelin e dhunës, i cili është realizuar dhe ku humbjet e tyre individuale janë lokalizuar brenda një tabloje më të madhe të dhunës.

### 19.3. E drejta për të ditur për të parandaluar manipulimet politike

Askund më mirë se në Ballkan liderët e paskrupullt ballkanas nuk kanë krijuar mite të cilat iu shërbejnë ambicieve të tyre për pushtet përmes përzgjatjes së vuajtjeve. Në një kontekst post-konfliktual, është shumë e lehtë për lidhësit e ri për të përjetësuar ato mite përmes pohimit se pjesëtarët e grupit të tyre etnik janë viktimat të pafajshme, derisa të tjerët janë kryerës mëkatar, me qëllim që të përjetësoj animozitetet ndërgrupore. Mosnjohja e fakteve, në të vërtetë, do të thotë në një mënyrë shtruese se ato do të mbesin, në rastin më të mirë, të hapur ndaj interpretimit dhe në rastin më të keq ndaj fantazimit ideologjik. Ndjekjet penale mund të ndihmojnë në rekonstruktimin e krijimit të këtyre miteve të rrezikshme, por ato hedhin dritë vetëm mbi disa ngjarje. Jo vetëm kaq, kapitulli paraprak ka treguar se si vendimet gjyqësore po ashtu mund të kenë efekt kundërproduktiv në ndarjen në vija etnike. E drejta për të ditur me qëllim të konstatimit të fakteve dhe për të kundërshtuar revizionizmin shkon përtej të vërtetës që mund të sjellin gjykimet dhe i shërbehet asaj më mirë në një ndërmarrje të gjerë të kërkimit të së vërtetës.

### 20. Komisionet e së vërtetës: përkufizimi dhe mjetet në dispozicion

Komisioni i parë i së Vërtetës që është themeluar ndonjëherë ka qenë Komisioni Kombëtar i Argjentinës mbi Zhdukjen e Personave, i krijuar nga presidenti Raúl Alfonsín në datën 15 dhjetor të vitit 1983. Ky Komision ka lëshuar një raport me titullin *Nunca Más* (Kurrë më), i cili ka dokumentuar të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut që janë kryer nën diktaturën dhe e ka nxitur gjykimin e juntës. Duke filluar

nga origjina latino-amerikane, KV-të në mënyrë progresive janë bërë një mjet thelbësor i DT-së. Ato janë zbatuar në 30 raste të ndryshme deri më sot, në kuadër të formave të ndryshme, me ato të Afrikës së Jugut si shembulli më i famshëm.

KV-të janë panele jo-gjyqësore dhe të pavarura të hetimeve të themeluara për të përcaktuar faktet, rrënjët e shkaqeve si dhe pasojat shoqërore të shkeljeve në të kaluarën të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare. Ato përfshijnë një numër të hapave hetimor, nga konsultimi i arkivave deri te intervistat e individëve përmes dëgjimeve publike. KV-të, në përgjithësi, e bëjnë kërkimin e pavarur, e hartojnë mbështetjen materiale të viktimave dhe propozojnë rekomandimet e politikave për të nxitur reformën institucionale dhe ligjore si dhe për të parandaluar përsëritjen e krimeve të luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Puna e tyre po ashtu mund të hap rrugë për ndjekjet penale, edhe pse dënimi nuk është fokusi i DT-së, që po ashtu mund të ofrojë amnistitë e pjesshme ose të plota.<sup>106</sup> Ato, po ashtu, kanë për qëllim për të arritur një narrativ përfundimtar historik lidhur me të kaluarën si dhe për të dëshmuar një model të abuzimit gjatë një periudhe të caktuar të kohës më parë se sa një ngjarje specifike.

### 21. Anët e forta dhe kontributet e komisioneve të së vërtetës

KV-të i kontribuojnë DT-së në disa mënyra dhe anët e forta të tyre shpesh shihen në dritën e kontrastit me kufizimet e ndjekjeve penale. Në të vërtetë, pasuria më e madhe e KV-ve është se ato përbëjnë drejtësinë retributive, përmes sigurimit të shënimeve historike (e vërteta) dhe një platformë për viktimat lidhur me pranimin e plagëve të tyre. Pos kësaj, KV-të mund t'i kontribuojnë instrumenteve të tjera të DT-së në disa mënyra.

<sup>106</sup> Broshurë e GJNPJ (2008)

### 21.1. KV-të sjellin të vërtetën dhe një platformë për viktimat

Komisionet e së vërtetës e kanë potencialin për të ndërprerë ciklin e dhunës përmes ofrimit të drejtësisë restorative për viktimat. Drejtësia restorative është një teori e drejtësisë e bazuar në supozimin se, ndryshe prej drejtësisë retributive, drejtësia mund t'iu ofrohet viktimave përmes shërimit më parë se sa përmes dënimit. Në këtë pikëpamje është parashtruar forca shëruese e bisedimit lidhur me të kaluarën dhe ajo e njohjes së të vërtetës. Përpos kësaj, shmangia nga fokusimi në dënimin vjen nga një objektivi i të jetuarit së bashku, Desmond Tutu, duke e arsyetuar krijimin e KV-ve dhe përdorin e amnistisë, ka deklaruar: "Derisa Aleatët mund të paketohen dhe të shkojnë në shtëpitë e tyre pas Nurembergut [gjykatë e krimeve të luftës pas Luftës së Dytë Botërore], ne, në Afrikën e Jugut, duhet të jetojmë me njëri-tjetrin." Pajtimi shoqëror është njëmend shpesh një objektivi i deklaruar i komisioneve të së vërtetës.<sup>107</sup>

Në lidhje me drejtësinë individuale të ofruar për viktimat, kapitulli paraprak i ka theksuar kufizimet e një qasjeje të pastër retributive ndaj drejtësisë.<sup>108</sup> Në gjykime, dëshmitë e viktimave shfrytëzohen për të konstatuar fajin dhe roli i tyre mund të duket sekondar me atë të kryerësve. Është pohuar se KV-të, duke i vënë viktimat në qendër, kontribuojnë më shumë në procesin e tyre shërues dhe janë një platformë e njohjes së plagëve të tyre.<sup>109</sup>

Pos kësaj, për arsye se gjykimet janë të kushtueshme dhe zgjasin shumë, drejtësia e siguruar është pashmangshëm simbolike.<sup>110</sup> Kryerësit kryesor dhe disa nga viktimat e tyre do të dëgjohen, por shumica e viktimave jo.<sup>111</sup> Jo vetëm që kjo do të pikturoj një tablo të pjesshme të ngjarjeve historike (vërtet se do të hetohen vetëm ata brenda procedurave gjyqësore), por, po ashtu, do të sjellë kënaqësi të pjesshme për viktimat. Më tutje, ato viktima, të cilat janë dëgjuar në gjykatë pashmangshmërisht do t'i nënshtrohen procedurave frustruese të marrjes së tërthortë në pyetje dhe sfidës

107 Brahm (2004)

108 Clark (2009), p464

109 Shih çështjet me këtë term mjekësor në Kerr & Mobekk (2007), p136

110 Për shkak se miliona njerëz janë të prekur, posaçërisht për faktin se një aktakuzë e vetme i kërkon disa vite, shumë dokumente dhe dëshmi, gjyqtarë dhe avokatë etj. shih Akman (2008), p132

111 Tepperman (2002) [online]

ligjor karakteristike për sistemin armiqësor në gjykatë.<sup>112</sup> Drejtësia restorative e ofruar nga KV-të, megjithëkëtë, i shmang procedurat e gjata dhe të vështira ligjore përmes sigurimit të një platforme zyrtare e, prapëseprapë, fleksibile për secilën viktimë për të pasur mundësinë për t'u dëgjuar.<sup>113</sup> Përvoja e Afrikës së Jugut, për shembull, e ka demonstruar aftësinë për të dëgjuar me mijëra prej viktimave pa inercionin e dokumenteve ose të burokracisë dhe në një mënyrë shumë ekonomike.<sup>114</sup> Në të vërtetë, KV-të "iu japin zë atyre që janë të pazë".<sup>115</sup> Përmes vendosjes së një platforme për të gjitha viktimat pa dallim dhe pa proceduar me as farë selektiviteti, i cili ka përfshirë gjykimet, drejtësia restorative e ofruar nga KV-të iu mundëson viktimave për të rrëfyer historitë e tyre, me çka arrihet një formë e trajtimit të drejtë si dhe rimëkëmbja e një pjese të dinjitetit të tyre.<sup>116</sup>

### 21.2. Kontributi i KV-ve ndaj instrumenteve të tjera të DT-së: reformat institucionale, reparacionet dhe ndjekjet penale

Përmes konkluzave dhe gjetjeve të veta, shpesh të grupuara në një raport përfundimtar, KV-të i kontribuojnë disa instrumenteve të tjera të DT-së. Ato ofrojnë rekomandimin, i cili mund të çojë tek reformat institucionale dhe ligjore të qeverisë në pushtet, me qëllim që të parandalojë ripërsëritjen e së kaluarës së dhunshme, si dhe ofrojnë programet e reparacioneve me qëllim të trajtimit të drejtë material për viktimat. Në fund, përmes konstatimit se kush ka qenë përgjegjës, ato, po ashtu, mund të çojnë deri te ndjekjet penale. Përmes këtyre kontributeve të ndërlidhura, KV-të ua krijojnë shansin shoqërive më përpara të përçara për të iniciuar procesin e rindërtimit të besimit qytetar midis komuniteteve dhe qytetarëve si dhe besimin institucional në institucionet përkatëse.

112 Corliss (2013)

113 Akman (2008), p134

114 Ibid

115 Kerr & Mobekk (2007), p138

116 Brahm E. (2004)

### Kontributet e KV-ve për DT-në: Rasti i Perusë<sup>117</sup>

KV-ja e themeluar në Peru në muaji qershor të vitit 2001 ka pasur për detyrë të hetojë abuzimet e kryera nga zyrtarët e shtetit dhe nga kryengritësit. Për ta bërë këtë, i ka hetuar kushtet, të cilat kanë çuar deri te shpërthimi i dhunës, dhe e ka përfunduar një raport në datën 28 gusht të vitit 2003, në të cilin i dënon mizoritë e kryera nga të gjitha palët. KV-të i kanë kontribuar inicimit të reformave politike, ndjekjeve penale si dhe programeve të reparacionit për viktimat, duke i kontribuar tranzicionit demokratik të Perusë.

KV-të e ndryshme do të kenë ndikime të ndryshme mbi situata të ndryshme post-konfliktuale. Megjithëkëtë, ato, po ashtu, i kanë kufizimet e veta inherente dhe të konstruktura.

## 22. Kufizimet dhe dobësitë e KV-ve

Efikasiteti dhe kontributi i KV-ve në sjelljen e drejtësisë dhe të pajtimit për viktimat, ashtu siç është pohuar më sipër, ka treguar disa limite. Në anën tjetër, ashtu siç e kemi vëzhguar lidhur me gjykimet, ekzistojnë disa kufizime inherente në lidhje me atë se çfarë mund të arrijë KV, për shkak të limiteve të drejtësisë retributive dhe të efektit terapeutik të së vërtetës. Në anën tjetër, disa komisione të së vërtetës kanë qenë të goditura që nga vet themelimi për shkak të faktorëve të jashtëm ose për shkak të mandatit të tyre vetjak. Në këtë pikëpamje, rasti i Komisionit të së Vërtetës dhe i Pajtitimit i Afrikës Jugore është ilustrues. Në mënyrë më të përgjithshme, tamam si për gjykimet, të pritmet e përgjithshme lidhur me atë se çka mund të arrijnë KV-të kanë qenë së tepërmi optimiste dhe kjo e shpjegon kritikën e tyre të mëvonshme.<sup>118</sup>

### 22.1. Përfitimet e diskutueshme të së vërtetës

Përfitimet terapeutike të viktimave që dalin para KV-së nuk janë të drejtpërdrejta. Është pohuar se shansi i dhënë viktimave për të treguar historitë e tyre dhe për të dëgjuar për fatet e të afërmeve

117 Broshurë e GJNPJ II (2008)

118 Brahm E. (2004)

të tyre është i dobishëm për procesin e tyre shërues. Derisa kjo është e vërtetë në shumicën e rasteve, për disa viktimat ka qenë një përvojë fare traumatizuese, që e ka rikthyer trazimin e vjetër dhe, së këndejmi, ka shkaktuar shumë trazime të tjera të reja.<sup>119</sup> Përfitimet, të cilat mund t'i marrin viktimat nga rrëfimi i historive të tyre, me qëllim që ato të jenë plotësisht të përmbushura, kanë nevojë për të qenë pjesë e një procesi afatgjatë. Në KV, sidoqoftë, viktimat nuk kanë gjithmonë mjaft kohë në dispozicion dhe shpesh atyre iu mungojnë burimet e mjaftueshme për të siguruar mbështetjen në vazhdimësi. Në të vërtetë, studimet empirike kanë treguar se aftësia e KV-ve për të zbutur ndjenjat negative të viktimave ka qenë e përzier. Derisa një anketë e zhvilluar në Afrikën e Jugut ka konstatuar se më shumë se gjysma e respondentëve kanë ndjerë se KV mund t'i ketë bërë njerëzit edhe më të hidhëruar, në El Salvador është raportuar një përkrahje me një shtrirje të gjerë për gjetjet e komisionit.<sup>120</sup>

### 22.2. Kufijtë pragmatik lidhur me atë se çka mund të arrijnë KV-të

KV-të mund të shfrytëzohen si mjete politike. Ky ka qenë rasti i Ugandës dhe i Çadit, ku gjetjet e KV-ve kanë shërbyer për të diskretituar regjimin paraprak dhe për të legjitimuar qeveritë e reja. Si kontrast, në Zimbabve, gjetjet e KV-ve kurrë nuk janë publikuar për arsye se ato kanë qenë së tepërmi kritike ndaj qeverisë së re. Në Ekuador dhe në Bolivia, KV-të janë shpërbërë, për arsye se atje puna është vlerësuar së tepërmi politikisht e ndjeshme.<sup>121</sup> Pos kësaj, kapaciteti i KV-ve për të shkuar mjaftueshëm larg në ndërmarrjet e tyre në trajtimin e së kaluarës dhe në prodhimin e pajtimit është i kufizuar nga mungesa e tyre e pushtetit implementues: ato nuk kanë pushtet për të ndëshkuar si dhe as kompetenca për të zbatuar reformat, të cilat i rekomandojnë ata dhe gjerësisht varen nga mbështetja politike.

119 Nisma KOMRA' (2012)

120 Brahm E. (2004)

121 Brahm E. (2004)

### 22.3. Kufijtë e drejtësisë restorative dhe çështja e amnistive

KV-të janë menduar si organe restorative, që fokusohen në shërimin dhe në rimëkëmbjen e marrëdhënieve më parë se sa në dënimin penal. Ky tipar i brendshëm shpesh e ndalon përmbushjen e llogaridhënies, që është një kërkesë shumë e shpeshtë në mesin e viktimave. Njëmend, një satisfaksion i pastër qëndron për viktimat në dhënien fund të mosndëshkimit dhe në dënimin e atyre, të cilët viktimave iu kanë bërë keq.<sup>122</sup> Praktika e KV-ve për ‘spastrimin e mosmarrëveshjeve’, i cili shpesh rezulton në amnisti, është kontradiktore. Derisa e mundëson pjesëmarrjen e gjerë dhe e shmang fokusimin rigid në dënimin, ato, po ashtu, e shfuqizojnë të drejtën e viktimave për të kërkuar zhdëmtim, që shpie tek frustrimi individual dhe urrejtja, ngaqë konkretisht nga ajo përfitojnë ata të cilët kanë kryer vepra, me çka dëmtohet vet-respekti i viktimës dhe e drejta për drejtësi. Në El Salvador, amnistitë totale iu janë dhënë shumicës dërmuese të oficerëve ushtarak përmas KV-ve, duke krijuar një ankth të madh në shoqërinë civile.<sup>123</sup> Në mënyrë plotësuese, shfrytëzimi i amnistisë i kundërvihet parimeve të sundimit të ligjit, posaçërisht duke dëmtuar parimet kyçe, të cilave njerëzit duhet t’iu përgjigjen për krimet e tyre. Në pajtim me këtë, nuk janë të kënaqura të gjitha viktimat me drejtësinë retributive (ndëshkuese).<sup>124</sup>

122 Orentlicher (2010), p13

123 Kerr & Mobekk (2007), p139-140

124 Brahm E. (2004)

#### Gjykimet dhe Komisionet e së Vërtetës: debati për drejtësinë restorative vs drejtësinë retributive

- **Përfitimet e drejtësisë restorative lidhur me drejtësinë e ‘gjykimeve’**
  - Procedura e lehtë, platforma fleksibile: mund të dëgjohen shumë më shumë viktimat
  - Viktimat janë në qendër të procesit: shërimi më i madh është i mundshëm
- **Kufijtë e drejtësisë restorative: ua merr viktimave të drejtën e llogaridhënies**
  - Kërkesa e indigjenëve për ndëshkim të shkelësve
  - Shpesh, frustrimi i madh i viktimave me amnistinë
- **Pro-të dhe kon-tratë për të dyja sistemet e drejtësisë:**
  - KV-të janë një platformë më e mirë për zërat e viktimave dhe për të vërtetën shteruese
  - Gjykimet ua ofrojnë viktimave llogaridhënien, të cilën e kërkojnë, ndryshe prej shumë KV-ve.

*Duke e përcjellë shembullin e këtyre sugjerimeve se KV-të në ish Jugosllavi mund të “kompletojnë pjesën, e cila mungon, të mozaikut të GJNPJ”, duket se KV-të dhe ndjekjet penale kanë pro-të dhe kontra-të e ndryshme dhe janë komplementare më parë se sa përjashtuese të njëra-tjetrës.<sup>125</sup>*

125 Akman (2008), p140

## 22.4. Çështjet e mandatit dhe të mjeteve: nuk ka recetë të përsosur për sukseset e KV-ve

Rasti i studimit: Komisioni i të Vërtetës dhe i Pajtimit i Afrikës së Jugut, midis sukseseve dhe limiteve<sup>126</sup>



127

- **Konteksti:** nga viti 1948 deri në vitin 1992, aparteidi në Afrikën Jugore ka qenë politika zyrtare e shtetit, ku jugo-afrikanët jo-të bardhë kanë qenë të deprivuar nga të drejtat themelore politike dhe socio-ekonomike, siç është e drejta në liri dhe për tubim, e drejta në arsimim dhe në kujdesin shëndetësor. Rreth 200.000 jugo-afrikanë me ngjyrë janë arrestuar në mënyrë arbitrare, shumica prej të cilëve i janë shtruar torturës gjatë kohës së kanë qenë të ndaluar dhe, ndonjëherë, edhe ekzekutimit përfundimtar. Pas shumë viteve të sanksioneve dhe të dënimit ndërkombëtarë dhe kur Mendela, lideri i Kongresit Kombëtar Afrikan (KKA), ka qenë liruar nga burgu në të cilin i ka kaluar 27 vite, në vitin 1991, negociatat kanë filluar me Partinë Kombëtare (PK), aso kohe në pushtet. Mospajtimet kanë qenë të egra, ngaqë PK e dëshironte amnistinë, kurse KK ngulte këmbë në sjelljen e njerëzve të bardhë përgjegjës para drejtësisë. Në muajin prill të vitit 1994, KKA i ka fituar zgjedhjet dhe Mendela bëhet president.
- **Mandati i KV-ve:** KV jugo-afrikane është themeluar në muajin maj të vitit 1995, si produkt i kompromisit politik, me kompetencën që të hetojë ngjarjet nga muaji mars i vitit 1960 deri në muajin dhjetor të vitit 1993. Komisioni e ka pasur për detyrë për të përgatitur në raport të të gjeturave dhe për të lëshuar rekomandimet mbi reparacionet dhe amnistinë. Pjesëtarët e tij ishin zgjedhur për të përfaqësuar tërësinë e shoqërisë së Afrikës së Jugut (shtatë njerëz me ngjyrë të zezë, gjashtë të bardhë, dy me ngjyrë dhe dy indian), dhe janë kryesuar nga kryepeshkopi Desmond Tutu. Ky institucion ka qenë themeluar me qëllim që të krijojë një histori të përbashkët lidhur me të kaluarën, gjë që do t'iu mundësonte ish viktimave dhe kryerësve të jetojnë së bashku.

126 Broshurë e GJNPJ II (2008)

127 photo: <http://www.trial-ch.org/en/resources/truth-commissions/africa/south-africa.html>

- **E arritura e paprecedent e së vërtetës:** pas tri viteve, është krijuar raporti i KV-së, në të cilin janë grumbulluar dëshmitë e 20,000 njerëzve, dhe përfundimi i dëgjimeve publike është organizuar në 80 komunitete anë e kënd vendit, që pikturon një tablo më të plotë të krimeve të Apartheidit si dhe i ka prezantuar shumë ngjarje të fshehta.
- **Kufizimet dhe kritikët:** përkundër kësaj të arriture, KV ka pasur një numër të metash, që e kanë ndaluar pajtimin e vërtetë:
  - **Mandati i kufizuar:** për shkak të natyrës së tij me karakter negociator, personat, të cilët dëgjohen përpara KV-së, janë kufizuar në ato viktima të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut me një objektiv politik. Si rezultat i kësaj, nga mandati i KV-së kanë qenë të përjashtuara viktimat e zhvendosjeve të dhunshme, kushtet e varfra të jetesës, ose shkeljet e të tjera që nuk kanë shkakuar dëmtim të drejtpërdrejtë tek njerëzit, por të cilët kanë qenë po aq të rëndësishëm për t'i trajtuar.
  - **E vërteta e kufizuar:** ngaqë KV-të nuk kanë pushtet për të thirrur pjesëmarrjen ose vijimin, shumë figura kyçe politike mbesin jashtë.
  - **Mospërputhja midis dispozitave të amnistisë dhe programit të reparacionit:** dispozitat e amnistisë së KV-ve kanë qenë elementet më të debatuar të KV-ve. Ato kanë qenë të kushtëzuara dhe të dhëna për aq sa krimet kanë qenë politikisht të motivuara dhe plotësisht të zbuluara para Komisionit. Edhe pse janë prezantuar 7115 persona, shumë të tjerë kanë abstenuar dhe ata që janë paraqitur vetëm pjesërisht i kanë rrëfyer krimet e tyre. Prej tyre, 5392 iu është refuzuar amnistia, por shumë pak veprime gjyqësore janë ndërmarrë pas kësaj. Për t'iu kundërvënë karakterit jopopullor të dispozitave të amnistisë, janë bërë rekomandime mbi reparacionet. Prej 90.000 viktimave, të cilat kanë aplikuar për reparacione me anë të në KV, më pak se një e treta e kanë fituar këtë të drejtë, kurse pagesat, për shkak të mungesës së burimeve, kanë qenë të vonuara dhe të lodhshme. Dallimi i madh në trajtimin e kryerësve dhe të viktimave ka qenë faktori kryesor, i cili e ka penguar drejtësinë e vërtetë dhe pajtimin në Afrikën e Jugut.
- **Konkluzion:** KV-të e Afrikës së Jugut janë vlerësuar si një model unik në tranzicionin drejt demokracisë. Falë komponentit të 'amnistisë për të vërtetën', shumë të vërteta janë zbuluar dhe kanë marrë pjesë shumë njerëz. Megjithatë, kufizimet e cekura hollësisht më lartë kanë lënë hapësirë për debat lidhur me efikasitetin e së vërtetës për pajtimin, e pakta në këtë rast të veçantë. Nuk duhet të na befasojë fakti se në një shoqëri, e cila ka qenë e përçarë për një kohë aq të gjatë, mbesin edhe sot perceptime të ndryshme të historisë dhe kështu disa njerëz ende e mohojnë se ka pasur apartheid si pjesë e një politike sistematike. Pos kësaj, humnera e mbetur e mosndëshkimit ka krijuar frustracione në mesin e viktimave, gjë që është përkeqësuar nga mungesa e një programi të gjithmbarshëm të reparacioneve.

### 23. Udhëzime për sukses: rëndësia e komplementaritetit

Edhe pse KV-të dallojnë për nga kapaciteti dhe rezultatet e tyre, shembulli i KV-së së Afrikës së Jugut me shpresë e mundëson nxjerrjen e disa mësimëve për hartimin e disa udhëzimeve për sukses të KV-ve. Pavarësia nga qeveria është thelbësore, për arsye se sukcesi i tyre do të varet nga kredibiliteti dhe transparenca para syve të publikut të përgjithshëm. Viktimat duhet të mbesin në qendër dhe atyre duhet t'iu jepet sa të jetë e mundur më shumë kohë me qëllim që të përmbushin procesin e shërimit, të cilin mund ta ofrojnë KV-të. KV-të, po ashtu, kanë nevojë për të qenë fleksibile dhe të ndërgjegjshme për nevojat e shoqërisë, në të cilën jetojnë: amnistitë mund të jenë opsion i mirë për të mbledhur një pjesëmarrje më të gjerë, por, po ashtu, mund të krijojë mosdurim, kështu që ndjekjet penale nuk duhet të përjashtohen. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, KV-të duhet të dizajnohen në komplementaritet me mjete tjera të DT-së, si pjesë e një strategjie të gjithmbarshme të Drejtësisë Tranzicionale. KV-të do të punojnë më mirë nëse rreshtohen me të drejtën e viktimës ndaj drejtësisë retributive dhe me reparacionet më parë se sa kur zëvendësohen me ato të drejta, ngaqë shprehja e së vërtetës lidhur me krimet e së kaluarës do të jetë jashtëzakonisht frustruese nëse nuk e ka edhe dënimin e kryerësve, nëse nuk e sjellë asistencën materiale për viktimat dhe reformën institucionale.<sup>128</sup> Në veçanti, anketat e kryera në Afrikën e Jugut – që kanë gjetur se shumica e viktimave janë ankuar lidhur me mungesën e reparacioneve – e kanë treguar rëndësinë e asistencës materiale për viktimat në Drejtësinë Tranzicionale. Para se t'i kthehemi këtij aspekti, kapitulli në vijim do të përqendrohet në përpjekjen më të re të kërkimit të së vërtetës në ish Jugosllavi.

128 Broshurë e GJNPJ I (2008)

### Komplementariteti i mjeteve: Rasti i Ruandës<sup>129</sup>



130

- **Konteksti:** E pavarur që nga viti 1962, Ruanda herët e ka parë betejën e dhunshme të pushtetit midis shumicës së saj Hutu (80% e popullatës) dhe minoritetit Tutsu, që e ka arritur kulmin në luftën qytetare në vitin 1994. Të dyja grupet kanë qenë etnikisht të ndara që nga kolonizimi Ruandës që përgjithmonë e ka ndryshuar atë që më përpara ka qenë një dallim fluid, në thelb socio-ekonomik midis Tutsuve – kryesisht blegtor – dhe Hutuve – kryesisht bujq. Qartazi, sundimi belg i ka etnicizuar marrëdhëniet përmes vendosjes së kartave të identitetit që e shënojnë racën si dhe përmes favorizimit të gjerë të Tutsuve, të cilët i kanë caktuar si përgjegjëse të administratës së tyre koloniale, gjë që ka çuar deri te urrejtja e madhe e Hutuve, të cilët e kanë kthyer kontrollin pas dekolonizimit. Ndërsa lufta civile ka përfunduar në fillim të vitit 1994, dhuna në mënyrë dramatike e ka arritur kulmin në muajin prill të vitit 1994: për tre muaj, 800,000 Tutsus, Tvas dhe Hutu të moderuar në mënyrë brutale janë vrarë nga fqinjët e tyre Hutu.
- **Llojlojshmëria e mjeteve të DT-së:** Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën (GJPNR) është themeluar nga Këshilli i Sigurimit në muajin nëntor të vitit 1994 që të sjellë para drejtësisë ata të cilët e kanë planifikuar gjenocidin dhe kanë marrë pjesë në te. Gjykimet vendore, gjykatat e Gacacas, po ashtu kanë marrë pjesë për të gjykuar me mijëra persona të akuzuar se kanë marrë pjesë në masakra. Përfundimisht, Komisioni i së Vërtetës dhe i Pajtitimit i Bashkimit Kombëtar (KVPBK) është krijuar në vitin 1999 për t'i dhënë fund diskriminimit dhe për të nxitur bashkëjetesën midis komuniteteve.

129 GJYKIMI

130 photo: <http://archive.worldvisionmagazine.org/story/faqs-rwanda-genocide-and-aftermath-3>



- **Operacionet e KVPBK:** për arsye se kjo detyrë tashmë ishte përbushur nga GJPNR dhe Gacaca, mandati i GJPNR-së nuk e ka përfshirë komponentin e gjetjes së të vërtetës. Në vend të kësaj, Komisioni ka shfrytëzuar një numër të mjeteve, siç janë Programet e Ndërtimit të Paqes dhe të Pajtimit, që kishin për synim tubimin e popullatës së Ruandës për të debatuar mbi politikat kombëtare ose kampet e solidaritetit, duke i nxitur pjesëmarrësit e tyre drejt parimeve të bashkëjetesës paqësore dhe tolerancës. Disa samite kombëtare po ashtu kanë qenë organizuar me qëllim që procesit t'i japin karakter pjesëmarrës dhe "klubet e pajtimit kanë qenë themeluar nëpër shkolla dhe universitete".
- **Trashëgimia:** një Raport është publikuar në vitin 2001, duke i konstatuar gjetjet e GJPNR, midis të tjerash, lidhur me origjinën e konfliktit në Ruanda, shkaqet e dhunës pas gjenocidit dhe kohezionin social në Ruanda. Komisioni ka ndihmuar për të hartuar një ligj mbi shtypjen e diskriminimit dhe për të siguruar se tekstet e ligjeve ekzistuese kanë qenë konsistente me qëllimin e pajtimit. Sot, kartat e identitetit nuk e konstatojnë identitetin racor dhe Hutut dhe Tutsit janë integruar në një forcë të vetme të armatosur. Është vlerësuar se pajtimi, falë punës komplementare të mjeteve të ndryshme, ka qenë një sukses i gjithmbarshëm.

## KAPITULLI 5: NISMA KOMRA



Procesi KOMRA (Komisioni ndërshtetëror për Konstatimin dhe Zbulimin e Fakteve për Viktimat e Krimeve të Luftërave Civile dhe të Shkeljes së të Drejtave të Njeriut në Territorin e ish Jugosllavisë 1991 – 2001) është iniciuar në muajin maj të vitit 2006 me qëllim që të sigurojë përpjekje kolektive, rajonale të kërkimit të së vërtetës. Udhëhiqet nga Koalicioni Rajonal për KOMRA-n i përbërë prej më shumë se 1900 anëtarëve – organizata dhe individë nga të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë. Pas viteve të tëra të lobimit, pritet se një komision rajonal i së vërtetës do të themelohet në të ardhmen e afërt.

### 24. Qëllimet që ndiqen nga KOMRA

Për shkak të karakterit rajonal të luftërave në ish Jugosllavi, duke e përfshirë edhe konfliktin në Kosovë, si dhe për shkak të lëvizjes së viktimave dhe të kryerësve përgjatë rajonit, bashkëpunimi rajonal duhet të jetë një nga elementet thelbësore i çfarëdo përpjekjeje të Drejtësisë Tranzicinale. Objektivi i gjithmbarshëm i KOMRA-s është që të themelojë një konsensus rajonal të bazuar në faktet lidhur me të kaluarën si dhe përparimi i procesit të pajtimit midis komuniteteve të ndryshme dhe midis vet shteteve. Fatkeqësisht, të dyja agjendat politike kombëtare anë e kënd Ballkanit dhe vetëdija e ulët për projektet rajonale brenda popullatës shpesh e pengojnë përparimin në këtë fushë.

Pa e pasur qëllimin që të jetë një alternativë e gjykimeve të luftës që zhvillohet në Ballkan, KOMRA përpiqet për të kompensuar për

kufizimet e një qasjeje të orientuar në kryerësit dhe të orientuar në faktet individuale ndaj së vërtetës dhe drejtësisë që bëhet nga gjykimet. Njëmend, në vendet e ish Jugosllavisë dhe në Kosovë, ashtu siç e demonstroi kapitulli 3, ndjekjet penale nuk kanë çuar në kurrfarë debati publik mbi të kaluarën si dhe as që është perceptuar si një mekanizëm legjitim për të konstatuar të vërtetën lidhur me të kaluarën (qartazi për shkak se verdiktet e saj shikohen përmes një prizmi etnik). Përballë kërkesës vendore për të konstatuar këtë të vërtetë, KOMRA është formuar si një nismë vendore, që e nxjerrë legjitimitetin e vet nga pronësia e projektit nga një numër i organizatave lokale të shoqërisë civile.<sup>131</sup> Thelbi i idesë së që qëndron pas KOMRA-s, së këndejmi, është të konstatojë faktet që qëndrojnë pas krimeve të luftës dhe për të nxitur debatin publik lidhur me këto fakte.

Një nga aspektet thelbësore të KOMRA-s është konstatimi përfundimtar i viktimave të luftës, përmes krijimit të një liste përfundimtare të të gjithë atyre që janë vrarë dhe janë zhdukur. Njohuritë mbi fatin e të vdekurve dhe të të zhdukurve janë thelbësore për të trajtuar trashëgiminë e luftës. Në këtë pikëpamje, do të jetë në gjendje për t'u mbështetur në punën e cila tashmë është bërë në këtë drejtim nga organizatat e shoqërisë civile (FDH, FDH Kosovë, Dokumenta, etj.). Kjo punë përgatitore njëmend e bënë objektivin e KOMRA-s realist dhe të arritshëm.<sup>132</sup> Pos kësaj, faktet e konstatuara nga KOMRA do ta parandalojnë manipulimin e tyre politik, që do të përkeqësonte ndjenjat ekskluziviste nacionale.<sup>133</sup> Do të ndihmojë, po ashtu, në krijimin e një mekanizmi të gjithmbarshëm, përmes të cilit viktimat mund të kërkojnë reparacionet.

## 25. Koalicioni për KOMRA-n, përkrahja publike dhe pronësia vendore

Koalicioni për KOMRA-n, i formuar në Prishtinë në vitin 2008, është një rrjet i disa qindra shoqatave të shoqërisë civile dhe individëve (në vitin 2013 më shumë se 1900) – duke përfshirë shoqatat e viktimave,

131 'Memo: Nisma KOMRA – Rasti për të përkrahur Bashkimin Evropian ' (2009)

132 Nisma KOMRA' (2012)

133 Nisma KOMRA' (2012)

grupet e të drejtave të njeriut, ish personat e burgosur në kampet e përqendrimit, grupet e veteranëve, organizatat e rinisë, grupet e grave, historianët, gazetarët dhe artistët – që avokojnë nga qeveritë e vendeve të ish Jugosllavisë.<sup>134</sup>

Pas themelimit të koalicionit, është nisur një fushatë në vitin 2011 e cila ka mbledhur 542.000 nënshkrime nga anëtarët e publikut për të përkrahur krijimin e KOMRA-s. Njerëzit, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike, kanë nënshkruar, me çka, së këndejmi, kanë treguar interesin dhe përkrahjen e tyre për këtë projekt.<sup>135</sup>

## 26. Miratimi i Statutit të KOMRA-s dhe sfida e përkrahjes politike

Koalicioni së shpejti i ka dhënë për detyrë një grupi prej 4 juristësh dhe 2 historianëve nga shtete të ndryshme për të hartuar Statutin e KOMRA-s, përkufizimin e qëllimeve të tij, detyrat dhe kompetencat, i cili ka marrë parasysh standardet ligjore ndërkombëtare, përvojat e përparshme të Komisioneve të së Vërtetës, si dhe veçantitë e sistemeve ligjore në rajon. Kuvendi i Përgjithshëm i Koalicionit e ka miratuar Projektstatutin e KOMRA-s në muajin mars të vitit 2011.<sup>136</sup>

Projektstatuti pastaj është dërguar për shqyrtim dhe për përkrahje tek të gjithë presidentët e shteteve post-jugosllave, me qëllim që të hulumtojë kushtet kushtetuese për themelimin e KOMRA-s në secilin vend. Në muajin nëntor të vitit 2014, koalicioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar ndryshimet, të cilat kanë qenë bërë nga të deleguarit e presidentëve, duke vlerësuar se e kanë ruajtur thelbin e projektstatutit.

Hapi i mëtejshëm janë votat e parlamenteve kombëtare për ta implementuar KOMRA-n. Kjo ende nuk është bërë, ngaqë KOMRA ka hyrë në fazën e tij më të rëndësishme: në atë të përkrahjes së nivelit të shtetit.<sup>137</sup> Vullneti i qeverive të rajonit për t'u angazhuar në mënyrë efikase ndaj këtij procesi do të jetë para sprovës në muajt e ardhshëm.

134 'Memo: - Rasti për të përkrahur Bashkimin Evropian ' (2009)

135 Nisma KOMRA' (2012)

136 STATUTET e KOMRA-s

137 Nisma KOMRA (2015).

## KAPITULLI 6: REPARACIONET

E drejta në reparacione është një aspekt jashtëzakonisht i rëndësishëm i ofrimit të drejtësisë për viktimat dhe, me këtë, një komponentë esenciale e drejtësisë tranzicionale. Ajo është pjesë integrale e ligjit penal ndërkombëtar, që reflekton vëmendjen në rritje e sipër që i kushtohet viktimave, evidente në dispozitat e Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare,<sup>138</sup> si dhe pjesë e Parimeve Themelore mbi Reparacionet të Kombeve të Bashkuara (2006).<sup>139</sup> Me gjithë këto dispozita ndërkombëtare, sidoqoftë, përgjithësisht është pranuar se përgjegjësia për reparacionet është përgjegjësi e shtetit.

### 27. Format e ndryshme të reparacioneve që rimëkëmbin aspekte të ndryshme të drejtësisë

Reparacionet mund të jenë materiale ose simbolike. Kur është fjala për ato materiale, kompensimi në të holla është forma më e zakonshme e reparacioneve, por një numër i madh i metodave të ndryshme mund të përdoren (dëmshpërblimi, kompensimi, rehabilitimi, përfitimet sociale, satisfaksioni dhe garancitë e mos-përsëritjes). Kjo e fundit mund të marrë formën e kërkimfaljes zyrtare, të dënimit publik, monumenteve dhe memorialëve dhe zakonisht kësaj i referohen si memorializim.<sup>140</sup> Pavarësisht nga natyra dhe forma e tyre, të gjitha reparacionet përmbajnë funksione të rëndësishme psikologjike dhe sociale të rehabilitimit dhe të respektimit të viktimave. Ato, po ashtu, i kontribuojnë pajtimit duke i sjellë palët e ndryshme në sferën publike të përkujtimit.<sup>141</sup> Jo vetëm kaq, pohohet se e drejta në reparacione është një nga dimensionet më 'konkrete' të Drejtësisë Tranzicionale.

138 Shih Nenin 75 të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

139 Parimet dhe Udhëzuesit Themelor të KB-ve mbi të drejtën në ankesë dhe reparacione për viktimat e shkeljeve të mëdha të ligjit për të drejtat njerëzore ndërkombëtare, preambula, e miratuar nga Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut në datën 19 prill të vitit 2005.

140 Gjorgjeviq (2002).

141 Naidu (2004).

### Llojllojshmëria e masave të reparacioneve nëpër histori.<sup>142</sup>

#### Kile

- Pas konfliktit në Kile, qeveria ka paguar rreth 1.6 miliarda dollar të pensioneve për viktimat e regjimit të Pinoçetit (nga viti 1996 deri në vitin 2008). Ajo po ashtu ka themeluar një program specifik të kujdesit shëndetësor për të mbijetuarit dhe publikisht ka kërkuar falje për vuajtjet e tyre.

#### Sierra Leone

- Kryetari, në vitin 2010, zyrtarisht ka kërkuar falje ndaj femrave viktime të luftës, deri më tash të lëna jashtë procesit të rehabilitimit.

#### Kamboxhia

- Reparacionet simbolike dhe kolektive janë urdhëruar nga Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatës së Kamboxhias (DHJGK) pas dënimit të krimit të parë kundër njerëzimit. DHJGKT po ashtu i ka detyruar kryerësit që të kërkojnë falje ndaj viktimave të tyre.

Të dyja, si reparacionet materiale, ashtu edhe ato simbolike sjellin drejtësi simbolike për viktimat, përmes afirmimit publik se viktimat janë posedues të së drejtës që e kanë të drejtën e zhdëmtimit, të pranimit të vuajtjeve të tyre dhe të respektit për kujtimin e tyre. Ato, po ashtu, simbolizojnë pranimin zyrtar nga ana e shtetit për veprat e veta në të kaluarën.<sup>143</sup>

### 28. Reparacionet materiale e rimëkëmbin një formë të drejtësisë materiale.

Programet e reparacioneve materiale dhe sfidat e tyre Përkundër pragmatizmit të tyre të dëshiruar, hartimi dhe implementimi i një procesi efikas të reparacioneve është i mbarsur plot me vështirësi.

#### 28.1. Drejtësia materiale: Drejtësia në konkretësinë e saj

Konflikti i armatosur zakonisht ndikon mbi grupet e varfra dhe të rrezikuara më shumë se sa mbi grupet e tjera. Reparacionet janë një element i paçmueshëm i drejtësisë post-konfliktuale me qëllim

142 Faqja e internetit e GJNPJ

143 Hamber (2000)

që viktimat të jenë në gjendje për ta rimëkëmbur dinjitetin e tyre, rikthyer jetën e tyre dhe për të marrë pjesë në shoqëri në mënyrë të barabartë. Shumë studime të bëra lidhur me perceptimin e drejtësisë nga viktimat kanë treguar njëfarë rezistence përballë përkufizimit të “drejtësisë”, e cila është përqendruar vetëm në dënimin e kriminelëve të dyshuar të luftës, për arsye se drejtësia duhet të përfshijë një përmbledhje të të drejtave sociale dhe ekonomike si kompensim për viktimat.<sup>144</sup> Mësimet e mësuara nga ad hoc tribunalet e themeluara nga KB-të, ku fare pak vëmendje i kushtohet vet viktimave dhe të drejtave të tyre (duke e përfshirë edhe të drejtën e tyre në reparacione), kanë hedhur dritë mbi efektin dëmtues, që peshimi i këtillë i prioriteteve ka mbi perceptimin e viktimave të drejtësisë – qartazi të padrejta dhe shpërfillëse ndaj realitetit të tyre tragjik – dhe, së këndejmi, edhe në objektivat e promovuar nga vet drejtësia ndërkombëtare. Në të vërtetë, shembujt e Ugandës dhe të Afrikës së Jugut, të shqyrtuara më herët, kanë treguar, kur janë pyetur, se rindërtimi social dhe ekonomik janë preokupimet më prioritare të komuniteteve të goditura. Gjykimet e së vërtetës nuk do të sjellin paqen afatgjatë si dhe as ndjenjën se drejtësia është çuar në vend nëse nuk përkrahen nga zhvillimi i përgjithshëm dhe asistencë materiale.<sup>145</sup>

## 28.2. Varësia e reparacioneve nga regjistrimi i viktimave

Në mënyrë paraprake, hartimi i një programi të gjithmbarshëm të reparacioneve pas konfliktit nuk është një detyrë e lehtë. Në të vërtetë, ai e kërkon identifikimin e të gjitha viktimave dhe përcaktimin, që cili prej tyre e ka të drejtën në reparacione. Parakushti i reparacioneve është, së këndejmi, një listë e saktë e viktimave, që lidh dy mjete të drejtësisë tranzicionale: reparacionet dhe regjistrimin e viktimave. Në shtetet e ish Jugosllavisë, për shembull, hendeqet e rëndësishme që mbesin në të dhënat për viktimat e kanë penguar vlerësimin e saktë se sa prej tyre kanë nevojë për reparacione.<sup>146</sup>

144 Stover (2005)

145 ‘Vizit nga ICC Palët Shtetërore të Deleguara në Uganda’ (2010), p37

146 an der Auweraert (2013)

## 28.3. Rreziqet politike të reparacioneve

Nëse hartohet gabimisht, programi i reparacioneve mund të përkeqësojë tensionet politike. Në të vërtetë, në shtetet post-konfliktuale që i shtrohen tranzicionit politik, duhet të shqyrtohen vëzhgime të ndryshme, siç është çështja e asaj se si perceptohet procesi i reparacioneve nga pjesë të ndryshme të popullatës si dhe çështjen se si ndikohet nga to drejtpeshimi i pushtetit. Shpërndarja me karakter animi dhe i paragjykuar i reparacioneve, diferencimi midis viktimave, do të përçajë më tutje shoqërinë dhe do të përkeqësojë urrejtjen.

## 28.4. Frustrimet individuale dhe deprivimi i shkaktuar nga reparacionet

Të gjitha programet e reparacioneve do të kenë një prag të diskrecionit, duke e përfshirë detyrën e pamundshme të vendosjes së vlerës monetare në vuajtjen e viktimës. Ngaqë vlera të ndryshme do të shpërblehen për viktimat të ndryshme, dhe disa nga viktimat nuk do të kualifikohen brenda këtij pragu dhe, së këndejmi, do të përjashtohen nga proceset e reparacioneve, kjo mund të krijojë ndjenja të padrejtësisë dhe të frustrimeve.<sup>147</sup> Kjo ka ndodhur në Afrikën e Jugut, ku e kanë pasur këtë të drejtë të reparacioneve vetëm ato viktimat të ‘shkeljeve të mëdha’, që do të thotë, me dëmtim fizik, duke i përjashtuar ata që kanë vuajtur nga shkeljet e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale (deportimi, përjashtimi nga shkollat dhe spitalet etj.).<sup>148</sup> Pos kësaj, në shumicën e kohës, veteranët do të shpërblehen me një masë dukshëm më të madhe të reparacioneve se sa viktimat civile, simptomatike për diskursin mbizotërues, duke i ekzaltuar ata të cilët kanë luftuar në anën ‘tonë’.<sup>149</sup> E kundërta, caktimi i viktimizimit për qëllime të reparacioneve mund të përjetësojë një pjesë të identitetit të viktimës të zhvilluar gjatë konfliktit, me çka, së këndejmi, do të krijohet një ndarje e mëtejme midis grupeve.

147 Van der Auweraert (2013)

148 Hamper (2000)

149 Van der Auweraert (2013)

## 28.5. Kufijtë e kompensimit monetar

Humbjet e luftës vërtet nuk mund të kompensohen me anë të të hollave dhe veprimi i këtyre me anë të reparacioneve ndonjëherë është vlerësuar si blerje e heshtjes së viktimave. Së këndejmi – dhe megjithëse ato janë të mirëseardhura për viktimat në nevojë për asistencën materiale – në thelb, reparacionet materiale janë pastër një formë tjetër e reparacioneve simbolike.

### Reparacionet materiale në Kosovë: ligji diskriminues

- Në Kosovë, Ligji<sup>150</sup> i cili i siguron reparacionet për krimet e luftës është i përfshirë me një numër të madh të të metave. Çështja më e rëndësishme është përkufizimi diskriminues me ligj i viktimës civile. Në të vërtetë, Ligji e përkufizon viktimën civile si "një person, i cili ka vdekur ose është plagosur nga forcat armike dhe pastaj ka vdekur midis datës 27/02/1998 dhe 20/06/1999."
- Kjo i përjashton të gjitha viktimat e luftës të forcave jo-armike, pra, nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ose NATO-ja, nga rrethi i atyre që kanë të drejtë në reparacione si dhe shumë viktimat të cilat kanë vdekur brenda kufijve të caktuar kohor, në mënyrë specifike ata të vrasjeve hakmarrëse të serbëve nga shqiptarët fitimtarë.
- Qartazi, ky ligj është posaçërisht në disfavor të viktimave serbe të luftës, por jo vetëm të atyre, për arsye se disa shqiptarë etnik po ashtu janë bërë viktimat jashtë kësaj kornize kohore, si dhe pjesëtarët e komuniteteve RAE.
- Megjithëkëtë, paragjykimi i perceptuar kundër shkelësve serb e ka përjetësuar narrativin e gabuar 'bardh e zi' lidhur me luftën, duke e parandaluar një të vërtetë të saktë dhe të bazuar në faktet. Po ashtu perceptohet si politikisht i motivuar dhe diskriminues, gjë që krijon përçarje midis komuniteteve viktimat dhe i dëmshëm për pajtimin, ngaqë serbët nuk kanë të pranuar të qenët viktimë sipas këtij Ligji.
- Është një nga projektet më të mëdha të FDH-së Kosovë për të korigjuar këtë diskriminim përmes – duke u bazuar në gjetjet e Librit të Kujtimit të Kosovës – identifikimit të të gjitha atyre viktimave që e kanë të drejtën e reparacioneve dhe për të avokuar për një kornizë legjislative më përfshirëse.

## 29. Reparacionet simbolike: thika me dy teha e memorializimit

### 29.1. Kontributi i memorializimit për paqen dhe drejtësinë<sup>151</sup>



Trëndafilat e Sarajevës (Degruson)



Memoriali i viktimave myslimane në varrezën e Vishegradit (Degruson)

Reparacionet simbolike mund të marrin formën e kërkimfaljes, të komemoracioneve publike (ditët përkujtimore, emrat e rrugëve) dhe memorialët (memorialët arkitektural, muzetë). Memorializimi e ka për qëllim të mbaj mend - të sigurohet se ruhet mbamendja e shkeljeve të të drejtave të njeriut të së kaluarës – dhe për të përkujtuar – si një respekt për viktimat, një pranim i fakteve, të cilat e parandalojnë dënimin dhe si shenjë për mos-përsëritje.<sup>152</sup> Në këtë pikëpamje, reparacionet simbolike i kontribuojnë krijimit të një dosjeje të pakundërshtueshme historike të së kaluarës dhe transmisionit midis gjeneratave të një kujtese të përbashkët historike.<sup>153</sup> Kjo, nga ana tjetër, i formëson narrativët e ardhshëm dhe, së këndejmi, sjelljet e ardhshme dhe prandaj e ka potencialin për të nxitur tolerancën, pranimin e tjetrit dhe pajtimin.<sup>154</sup>

150 Emri i plotë i ligjit është : "Ligji mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre". Më tutje do t'i referohemi si Ligji mbi Reparacionet.

151 Gjorgjeviq (2002)

152 'Kërkesa për të përkujtuar: Roli i Memorialeve në Rikonstruktimin Social dhe Drejtësia Tranzicionale, (2007), „The Urge to Remember: The Role of Memorials in Social Reconstruction and Transitional Justice’ (2007)

153 Hamber (2000)

154 'Memorializimi i pasluftës dhe trajtimi i së kaluarës në Republikën e Kosovës, (2015), (Post-war Memorialisation and Dealing with the Past in the Republic of Kosovo’ (2015)

<b>Nismat e ndryshme memorializuese në histori:</b>
<b>Ish Jugosllavia<sup>155</sup></b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Memoriali i viktimave të Srebrenicës në Potoçari ; Trëndafilat e Sarajevës në nderim të viktimave të rrethimit ; kërkimfalja publike nga presidenti i Malit të Zi Milo Gjukanović para popullit kroat në muajin qershor të vitit 2000.</li> </ul>
<b>Afrika e Jugut</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kushtetuta Hill në Johannesburg, ish burg që tash është Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut, që tregon se si hapësirat mund të transformohen pas konfliktit për të simbolizuar tranzicionin.</li> </ul>
<b>Argjentina</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Çdo vit, data e 24 marsit sheh demonstrata të mëdha për të shënuar fillimin e diktaturës ushtarake të viteve '70-të.</li> </ul>

Në qoftë se trajtohet me kujdes dhe me ndjeshmëri, memorializimi njëmend mund të ndihmojë qëllimet e Drejtësisë Tranzicionale të paraqitjes së të vërtetës, duke ofruar një formë të drejtësisë për viktimat dhe duke shërbyer si flamur për të ardhmen dhe për gjeneratat e tashme, që mishëron një retorikë jo të dhunshme.<sup>156</sup> Fatkeqësisht, ai shpesh keqpërdoret, me çka i pengon qëllimet e DT-së.

## 29.2. Keqpërdorimi dhe të metat e memorializimit

Si mekanizëm i paraqitjes së të kaluarës, memorializimi është një thikë me dy teha. Derisa e ka potencialin për të përkrahur proceset e drejtësisë tranzicionale, ai mund të jetë, po ashtu, shumë përçarës. Kur ai mbetet i parregulluar, ai del jashtë kontrollit, por kur kontrollohet, ai shpesh shndërrohet në mjet politik.

### • Mungesa problematike e kontrollit lidhur me llojin e memorialëve të ndërtuar

Në Ballkan, me qindra memoriale të luftës janë parë të ndërtohen që nga lufta, me shumë pak ose pa kontroll lidhur me atë se sa para publike janë shpenzuar në to ose nëse ato i përjetësojnë ndarjet etnike. Organet kompetente administrative (përgjithësisht komunat)

<sup>155</sup> Gjorgjeviq (2002)

<sup>156</sup> "Memorializimi i pasluftës dhe trajtimi i së kaluarës në Republikën e Kosovës, (2015), ('Post-war Memorialisation and Dealing with the Past in the Republic of Kosovo' (2015)

nuk janë mjaft të kujdesshme, gjë që ka rezultuar në shumëzimin e memorialëve individualisht të sponsorizuar. Kjo mungesë e kontrollit lidhur me atë se çfarë lloji i monumentit ndërtohet është problematike: pa mbikëqyrje, ato mund të ofrojnë pikëpamje selektive të historisë, të jenë etnikisht të paragjykuara ose nxitëse, të lavdëroj kriminelët e luftës dhe ta minojnë vet-respektin e viktimave. Dhe me të vërtetë, shumica e monumenteve i përkujtojnë luftëtarët, viktimat, të ashtuquajturit heronj në kuptimin mono-etnik, gjë që parandalon narrativët alternativ shoqëruar me pak ose aspak përpjekje për të nxitur inkluzivitetin dhe pajtimin. Në Bosnjë, për shembull, shumica e pllakave memoriale të viktimave të rrethimit të Sarajevës kanë qenë financuar në mënyrë të pavarur nga viktimat, veteranët dhe donatorët privat. Emrat e cekur nuk janë kontrolluar nga autoritetet kompetente, duke mundësuar dublikate dhe mospërputhje. Disa nga njerëzit e cekur, në të vërtetë, ende janë të gjallë. Pavarësisht nëse këto lëshime janë të vullnetshme ose jo, ato e ushqejnë manipulimin e figurave, që sigurisht se shërben si një agjendë e veçantë politike.

### • Manipulimi i politik i kontrolluar i memorialëve

Pavarësisht nga ky çrregullim, qeveritë që i ngrisin monumentet ndonjëherë i shfrytëzojnë ato si një mjet për të nxitur legjitimitetin e tyre. Duke e drejtuar gishtin tek 'të tjerët' dhe duke imponuar një status rigid të kujtimit të viktimave dhe të kryerësve, ai shfrytëzohet si truall beteje për agjendat e tyre vetjake dhe promovon vizionin e vet për të kaluarën.<sup>157</sup> Në këtë pikëpamje, është interesante për të vërejtur se forma dhe qëllimi i memorialëve ndryshon në pajtim me natyrën e konfliktit. Vërtetë, në kontekstet post-etnike, komunitetet e përçara zakonisht ndërtojnë memoriale që nderojnë një grup etnik social ngushtësisht të përkufizuar dhe të ashtuquajturit martir të vet.<sup>158</sup> Narrativi i cili i shkon për shtati grupit shumicë ka gjasë të shkojë në dëm të minoriteteve, duke e fuqizuar përjashtimin e tij, si dhe duke inkurajuar armiqësitë etnike.<sup>159</sup> Në Ruanda, memorialët e ngritura


<sup>157</sup> "Murali Kafranbel ngrit shqetësimin mbi të ardhmen e memorializimit" (2015), 'Kafranbel Mural Raises Concerns on The Future of Memorialization' (2015).

<sup>158</sup> 'Kërkesa për të përkujtuar: Roli i Memorialeve në Rikonstruktimin Social dhe Drejtësia Tranzicionale, (2007), 'The Urge to Remember: The Role of Memorials in Social Reconstruction and Transitional Justice' (2007).

<sup>159</sup> "Memorializimi i pasluftës dhe trajtimi i së kaluarës në Republikën e Kosovës, (2015), 'Post-war Memorialisation and Dealing with the Past in the Republic of Kosovo' (2015)

në kujtim të Tutsive nuk i përmendin 200.000 viktime të Hutuve të dhunës së pastajme hakmarrëse. Në një shoqëri ku Hututë janë pothuajse të margjinalizuar për shkak të peshës së të kaluarës, një mohim i tillë është edhe më tutje përçarës dhe përjashtues. Ngjashëm, në Kroaci, qeveria në mënyrë masive ka investuar në një monument të Fitores Kroate në Knin, pa e pas përmendur pastrimin etnik të serbëve që kishte ndodhur, me çka e ka mohuar kujtimin e këtyre viktimave.<sup>160</sup> Në mënyrë të ngjashme, deri në vitin 2002 më shumë se 2800 monumente të ngritura gjatë periudhës jugosllave kanë qenë shkatërruar në një lëvizje të de-memorializimit.<sup>161</sup> Me të vërtetë, memorialët po ashtu janë shfrytëzuar për të garuar për të kaluarën, ashtu siç është parë nga ceremonitë e kundërvëna përkujtimore të mbajtura në përvjetorin WWI në Bosnjë. Serbët e Bosnjës e kanë ngritur një statujë në nderim të Principit si hero i luftës një ditë para përvjetorit të atentatit të cilin e ka kryer ai që e kishte hapur luftën.<sup>162</sup> Kjo e ilustron se si monumentet mund të nxisin versionet përçarëse të së kaluarës, me çka i përkeqësojnë tensionet etnike deri në masën sa ato ndonjëherë sulmohen e përdhunohen.

#### Memorializimi në Kosovë:<sup>163</sup>



164



165

Procesi i memorializimit në Kosovë ilustron kurthet e kësaj ndërmarrjeje, përmes disa shqetësimeve të ndërlidhura, që tregojnë mungesën e përfshirjes së nismës së memorializimit brenda agjendës së Drejtësisë tranzicionale.

- **Asnjë qasje institucionale për memorializimin:** Në Kosovë nuk ekziston kurrfarë inventari ose shënime të shpenzimeve për monumentet. Vetëm Kompleksi Memorial Adem Jashari në Prekaz ka një bazë ligjore. Shumica dërmuese e memorialëve janë nisma private, qëllimi dhe domethënia e të cilave është e parregulluar dhe, së këndejmi, të tilla që e promovojnë një mesazh individualistik, me pak përpjekje për të tërhequr një kujtesë të luftës.
- **Memorializimi etno-nacionalist:** memorialët në Kosovë reflektojnë në vizion të përqendruar në etninë e së kaluarës, që nderojnë 'heronjtë' ose 'martirët', pa asnjë hapësirë për narrativ alternativ dhe për kujtimin e 'palës tjetër'. Derisa Kosova numëron një numër të madh të ditëve të përkujtimit për luftëtarët e UÇK-së dhe viktimat shqiptare (nga data 5 deri më 8 mars përkujtim zyrtar për të përkujtuar familjen e Adem Jasharit dhe të forcave të UÇK-së; 27 prillin si Ditë Kombëtare e Personave të Pagjetur në Kosovë në kujtim të masakrës së Mejës; 5 majin si Ditë të Martirëve të UÇK-së), nuk ka asnjë ditë përkujtuese për të gjitha viktimat e luftës. Ky memorializim i njëanshëm, i cili nuk lë hapësirë për diskurs alternativ ose viktimizim alternativ, i mban të gjalla ndjenjat përçarëse të luftës dhe e përjashton pajtimin.
- **Memoria legjendare:** ashtu siç është e shpeshtë në gjithë Ballkanin, në Kosovë memorialët kultivojnë legjendat e fitores dhe të heroizmit me një retorikë sureale. Në këtë pikëpamje, shumë memorialë nuk e reflektojnë identitetin e vërtetë të asaj që e paraqesin, por, në vend të kësaj, i mbajnë ato mite. Është vërejtur, për shembull, se Agim Ramadani, në monumente i paraqitur si një luftëtar i fortë, ka qenë në të vërtetë, një person i qetë dhe mjaft i shkurtër.
- **Memoria gjender:** gjendja e tashme e gjërave lë pak hapësirë për të përkujtuar rolin e grave në konfliktin e Kosovës dhe në shoqërinë, si tërësi. Memoriali i kohëve të fundit Heroinat, i ngritur në muajin qershor të vitit 2015, përpiqet për të përmirësuar këtë duke i bërë respekt viktimave të dhunës seksuale në luftë. Megjithëkëtë, ky monument ka ardhur si një veprim politik për ta kënaqur opinionin publik më parë se sa për të hapur një debat të vërtetë për dhunën seksuale. Pos kësaj, edhe njëherë i bënë nderim një kategorie etnike të viktimave.

*Peizazhi i tashëm i memorializimit në Kosovë paraqet një narrativ shumë të ngushtë dhe të njëanshëm, i cili nxit një trajtim partizanesk të së kaluarës, gjë që e parandalon pajtimin midis komuniteteve. Është rast i humbur për drejtësinë tranzicionale.*

160 "Ballkani i kapluar nga shërthimi kaotik i ndërtimit të monumenteve", (2013), 'Balkans Gripped by Chaotic Monument-Building Boom' (2013).

161 Gjordjeviq (2002).

162 Jukiq (2014)

163 "Ballkani i kapluar nga shpërthimi kaotik i ndërtimit të monumenteve", (2013), 'Balkans Gripped by Chaotic Monument-Building Boom' (2013); "Memorializimi i pasluftës dhe trajtimi i së kaluarës në Republikën e Kosovës, (2015), 'Post-war Memorialisation and Dealing with the Past in the Republic of Kosovo' (2015).

164 photo: <http://lajmi.net/heroinat-veper-origjinale-apo-kopje/>

165 photo: <https://connormoriartykosovo.wordpress.com/2014/07/06/adem-jashari-memorial/>

Ndjekja penale e kryerësve dhe kërkimi i së vërtetës janë domosdoshmëri, por ato, në vetvete, nuk janë elemente të mjaftueshme për ta sjellë drejtësinë për viktimat. E drejta në reparacione të drejta është pjesë e veçantë dhe po aq esenciale e sigurimit të drejtësisë post-konfliktuale për viktimat dhe për nxitjen e proceseve kombëtare të pajtimit. Sidoqoftë, ato, si të vetme, vetëm mund të plotësojnë në mënyrë të pjesshme të gjitha nevojat psikologjike të viktimave, të cilat do të mbesin të pakënaqura nëse nuk zbatohen në komplementaritet me instrumentet e tjera të drejtësisë tranzicionale.<sup>166</sup>

<sup>166</sup> Hamber (2000)

## KAPITULLI 7: REFORMA INSTITUCIONALE

Si pjesë e përpjekjeve të DT-së për të adresuar mizoritë masive dhe trashëgiminë e konfliktit, dhe ngaqë institucionet publike (siç janë policia, ushtria dhe gjyqësori) shpesh bëhen instrument i shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë konfliktit, është esenciale pas tranzicionit për t'i pastruar dhe për t'i reformuar me qëllim që të rimëkëmbë sundimin e ligjit, të heq mosndëshkimin dhe të rikthejë besimin qytetar në ta.<sup>167</sup> Reforma institucionale, së këndejmi, përfshin disa ndërmarrje. Në njërin anë, verifikimi është shfrytëzuar për t'i adresuar mangësitë individuale (përmes eliminimit nga shërbimi publik ose sanksioneve të zyrtarëve abuziv dhe të korruptuar që kanë marrë pjesë në aktet e paligjshme). Në anën tjetër, reformat strukturale dhe ligjore bëhen për të trajtuar mangësitë strukturale të institucioneve, duke i bërë të qëndrueshme me anë të standardeve të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Këto aspekte të ndryshme janë të ndërlidhura. Për shembull, reformimi i Sektorit të Sigurisë përfshin verifikimin e tij dhe ridizajnimin e tij struktural.

### 30. Trajtimi i mangësive individuale përmes procesit të verifikimit

#### 30.1. Çka është verifikimi: krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut si kriter për reformën institucionale

Si një vërejtje paraprake, duhet të thuhet se verifikimi nuk duhet të ngatërrohet me spastrimet dhe lustracionet, edhe pse këto terme ndonjëherë shfrytëzohen në literaturë për të zëvendësuar njëri-tjetrin dhe të mbulojnë qëllime të ngjashme, edhe pse të realizuara lehtësisht në mënyrë të ndryshme. Verifikimi, i kuptuar si proces i vlerësimit të integritetit individual për të përcaktuar përshtatshmërinë e tij ose të saj për punësim publik, një masë e rëndësishme e reformës institucionale në shoqëritë tradicionale si një mënyrë e reformimit

<sup>167</sup> 'Sundimi i ligjit për shtetet post-konfliktuale: Verifikimi: një kornizë operacionale' (2006)



të institucioneve abuzive përmes largimit të atyre që janë përgjegjës për ato abuzime. Janë dy arsye kryesore që qëndrojnë në bazën e procesit të verifikimit. Së pari, verifikimi e ka për qëllim për të legjitimuar institucionet publike për të përforcuar besimin publik, përmes përjashtimit të ish abuzuesve, të cilët kanë shkelur besimin e investuar në ta nga qytetarët. Së dyti, verifikimi e ka për synim për të parandaluar përsëritjen e abuzimeve përmes shpërbërjes së strukturave abuzive në institucionet publike dhe përmes instalimit të mekanizmit të llogaridhënies.<sup>168</sup>

Verifikimi është, së këndejmi, një proces largpamës, i kthyer drejtë ndërtimit të një të ardhmeje më të mirë për institucionet, i cili, në anën tjetër, do të përkrah tranzicionin, do të mbajë paqen dhe do të ruajë sundimin e ligjit. Edhe pse verifikimi në mënyrë inherente bartë aspektet ndëshkimore për personat pozitivisht të verifikuar, nuk duhet të shihet si proces prapa-shikues, ngaqë kjo do ta barazonte verifikimin në një formë të ndëshkimit dhe të hakmarrjes për sjelljen në të kaluarën. Në të vërtetë, përjashtimi nga postet publike nuk mund të shihet si një sanksion i duhur për komisionin për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe në prezantimin e i tij si i tillë do ta nënvizonte impotencën e sistemit gjyqësor dhe do ta ushqente perceptcionin e 'drejtësisë së lirë'. Ndëshkimi njëmend hyn brenda fushës së ndjekjeve penale, jo në atë të verifikimit, edhe pse këto dy mekanizma qartazi janë komplementar. Shumë shoqëri post-konfliktuale dhe post-autoritare e kanë përdorur verifikimin, spastrimet dhe lustracionin, duke përfshirë, *midis të tjerash*, Argjentinën, Salvadorin, Gjermaninë Lindore, Greqinë, Poloninë, Republikën Çeke, Hungarinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën (B dhe H). Nevojat, të cilat duhet vërejtur lidhur me atë nëse tranzicioni realizohet drejt një shteti post-konfliktual ose post-autoritar nënkuptojnë modele të ndryshme për verifikimin.<sup>169</sup>

168 Bruhman C. (2015)

169 Bruhman C. (2015)

#### Procesi i verifikimit në Serbi<sup>170</sup>

- Në vitin 2003, Parlamenti i Serbisë e ka votuar 'Aktin e Llogaridhënies për Shkeljen e të Drejtave të Njeriut', duke e synuar themelimin e **Komisionit për Hetim të Llogaridhënies për Shkeljen e të Drejtave të Njeriut** për të zhvilluar verifikimin në lidhje me shkeljet e kryera të të drejtave të njeriut pas datës 23 mars të vitit 1976 për personat të cilët aplikojnë ose i kanë pozitat më të larta në sferën politike, në gjyqësor dhe në administratën publike.
- Komisioni asnjëherë është formuar, ngaqë kurrfarë konsensusi nuk ka mundur për t'u arritur nga anëtarët e tij dhe në vitin 2013 periudha e aplikimit të Aktit ka skaduar. Që aso kohe, pak ose aspak progres ka qenë bërë; nevoja për verifikim, së këndejmi, ende mbetet.
- Megjithëkëtë, duket se nuk ka konsensus social në Serbi mbi nevojën e ballafaqimit me të kaluarën, ashtu siç është treguar me animozitetin kundruall GJNPJ, dështimit të një përpjekjeje për të themeluar një Komision të së Vërtetës ose fakti se disa individë mbesin të lavdëruar si heronj kombëtar përkundër aktakuzave të ngritura kundër tyre nga GJNPJ.
- Kjo mungesë e konsensusit është fuqizuar nga fakti se që prej aso kohe nuk ka pasur ndarje të qartë nga e kaluara, ngaqë personat, të cilët janë tash në pozita të pushtetit, shpesh janë njerëz të cilët kanë qenë në pushtet aso kohe dhe do të kishin shumëçka për të humbur sikur të bëhej procesi i verifikimit.
- Sidoqoftë, mungesa e reformës institucionale është pengesa kryesore në procesin e pajtimit në Serbi me fqinjët e saj, ngaqë njerëzit e dyshuar për përfshirje në krime mbesin në pozita të njohura. Kjo është posaçërisht e evidente në raportin për Operacionin Reka. Një numër i caktuar i këtyre njerëzve, të cilët e kanë kryer Operacionin Reka, janë duke mbajtur pozita të rëndësishme në institucionet e Serbisë. Kjo vlen posaçërisht për rastin e Momir Stojanoviqit, deputet i tashëm i Kuvendit të Republikës së Serbisë dhe Kryesues i Komisionit Parlamentar për Kontroll të Shërbimit të Sigurimit, përkundër faktit të qartë për pjesëmarrjen e tij në Operacionin Reka.<sup>171</sup>

170 Bruhman C. (2015)

171 'Operacioni Reka' (2015)

## 30.2. Karakteristikat e procesit të verifikimit me ndikim në efikasitetin e tij

### • Çështja e vullnetit politik

Vullneti politik për të kryer procesin e verifikimit është thelbësor për implementimin e tij të suksesshëm. Duke e pasur parasysh se verifikimi e rregullon qasjen ndaj pozitave të pushtetit dhe është një ndërmarrje në masë shumë të lartë politike, implementimi i tij ka gjasë për të hasur në rezistencë të fortë nga individët të cilët janë në rrezik të humbjes së fuqisë, në mënyrë të veçantë kur zyrtarët qeveritar nuk janë zëvendësuar pas konfliktit.<sup>172</sup>

### • Fushëveprimi dhe karakteristikat

Përcaktimi i fushëveprimit të procesit të verifikimit (cili është numri i njerëzve, të cilët duhet të kontrollohen dhe sanksionohen) është në masë të lartë i varur nga burimet dhe vullneti politik në dispozicion.<sup>173</sup> Së këndejmi, duhet të jetë i limituar dhe selektiv për disa institucione dhe për disa individë brenda tyre (zakonisht nivelet më të larta hierarkike). Si rregull e përgjithshme, procesi i verifikimit duhet të iniciohet sa të jetë e mundur më herët në fazën e tranzicionit me qëllim që të zvogëlojë ndikimin e abuzuesve të drejtave të njeriut në projektimin dhe në ndërtimin e institucioneve të reja. Në lidhje me njerëzit pozitivisht të verifikuar, ekziston një shkallë e gjerë e sanksioneve të ndryshme, duke përfshirë, *inter alia*, pezullimin në pritje të konfirmimit ose emërimit në një post tjetër; transferi; pensionimi i hershëm etj. Verifikimi mund të bëhet përmes rishqyrtimit (duke i pasur në shënjestër punonjësit në shërbim të një institucioni) ose (ri)emërimit (duke i pasur në shënjestër kandidatët për shërbime në një institucion publik).<sup>174</sup>

172 Bruhman (2015)

173 "Masat për të shpërbërë trashëgiminë e ish sistemeve komuniste totalitariste" (1996), 'Measures to dismantle the heritage of former communist totalitarian systems' (1996)

174 Mayer-rieckh & De Greiff (2007) ; Bruhman (2015)

### Procesi i rishqyrtimit: Verifikimi i policisë në Bosnjë<sup>175</sup>

Marrëveshja e Paqes e Dejtonit e vitit 1995 e ka caktuar një Task Forcë të Policisë Ndërkombëtare (TFPNF) – të udhëhequr nga Misioni i KB-ve në Bosnjë dhe Hercegovinë (MKBNBH) – për të reformuar policinë, duke reduktuar në mënyrë drastike numrin e saj dhe duke e bërë etnikisht më përfaqësimitare. Pas regjistrimit të grupit të njerëzve për verifikim (23,751 persona kanë qenë regjistruar), oficerët i janë nënshtruar një kontrolli të gjerë të veprimtarive të tyre dhe monitorimit të performancës nga MKBIBH. Një oficer nuk do të kualifikohet nëse do të kishte "baza për dyshim" se ai ose ajo nuk i ka respektuar të drejtat e njeriut. Përafërsisht 90% iu është dhënë certifikimi. Në mënyrë të gjithmbarshme, procesi i shqyrtimit të policisë i MKBIBH jo vetëm që ka çuar deri te verifikimi i përshtatshmërisë së zyrtarëve individual të policisë, por, po ashtu, e ka përmirësuar përfaqësimin etnik dhe gjinor, me çka pozitivisht ka ndikuar në performancën policore në disa zona të kthimit të minoriteteve.

### Procesi i riemërimit: verifikimi i gjyqësorit në Bosnjë<sup>176</sup>

Gjyqësori i Bosnjës pas vitit 1995 ka qenë skajshmërisht i dobët. Në vitin 2002, tre Këshilla të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial (KLGJP) kanë qenë themeluar dhe e kanë kryer procesin e riemërimit, i cili e ka synuar sigurimin e kualitetit të prokurorëve dhe të gjyqtarëve, në mënyrë drastike duke e reduktuar madhësinë e tij dhe duke siguruar përfaqësim më të mirë etnik. Nga gjyqtarët dhe prokurorët është kërkuar për të dorëzuar informacion të hollësishëm duke përfshirë edhe atë mbi aktivitetet në kohën e luftës. Megjithëkëtë, informacioni lidhur me konfliktin ka qenë i kufizuar në përdorimin e tij dhe nuk ka pasur një shqyrtim të kontekstit të gjithmbarshëm të aktiviteteve të ndërlidhura me konfliktin për të gjithë aplikantët. Sidoqoftë, si rezultat i këtij procesi të riemërimit, përbërja etnike e sistemit në mënyrë të dukshme është përmirësuar dhe është ngjirur besimi publik në gjyqësorin nga 60.2% në 74%.

### • Rreziqet: manipulimi politik dhe ndërprerjet e mundshme

Verifikimi është i prirë për manipulim politik dhe ndërhyrje arbitrare. Kjo është rezultat i natyrës së shkallës së gjerë të procesit, garancive procedurale shpesh të dobëta dhe mbikëqyrjes së mundshme që e ofron si dhe faktit se ajo që pezullon në balancë është (një shkallë e caktuar) kontrolli i institucioneve publike, një qëllim për të cilin ia vlen për t'u angazhuar në politikat e animit partizanesk.<sup>177</sup> Verifikimi po ashtu mund të shkaktojë një hendek institucional me anë të largimit të një numri të madh të të punësuarve publik, me çka e

175 Mayer-rieckh & De Greiff (2007) ; Bruhman (2015)

176 Mayer-rieckh & De Greiff (2007) ; Bruhman (2015)

177 Mayer-rieckh & De Greiff (2007)

ndërpret funksionimin e shërbimit publik. Në fund, verifikimi mund të jetë destabilizues, ngaqë personat pozitivisht të verifikuar mund t'i kthehen kriminalitetit, krimit të organizuar ose kundërshtimit të armatosur. Kjo është posaçërisht alarmuese në lidhje me ish personelin e sigurimit, të cilët mund të kenë njohuri kriminale si dhe mjete për të përdorur forcën dhe trajnimet e të cilëve shpesh nuk mundësojnë për të gjetur punësim tjetër. Rreziqet e tilla në mënyrë të kujdesshme duhet të vlerësohen para fillimit të procesit të verifikimit dhe duhet të zbuten përmes kombinimit të verifikimit me masa të tjera, siç është çarmatimi dhe programi i rifutjes (RDGJ), ndërsa në të njëjtën kohë duke i peshuar ato përballë të drejtës së viktimave në drejtësi përmes ndjekjeve penale.<sup>178</sup>

- **Rëndësia e koherencës dhe e komplementaritetit**

Në anën tjetër, verifikimi mund të jetë vetëm një aspekt i një reforme të gjerë institucionale që ka për qëllim jo vetëm rilegjitimizimin e institucioneve, por, po ashtu, edhe riformësimin e tyre me qëllim që t'i bëjë ato më efikase. Këtu, *inter alia*, mund të përfshihet reduktimi i institucionit në fushën e tij, shkrirja e institucioneve gërshetuese, përmirësimi i kompetencave profesionale të personelit të tij si dhe të përbërjes dhe të përfaqësimit të tij (gjinia, etniciteti, etj.). Në anën tjetër, dhe në mënyrë më të përgjithësuar, verifikimi duhet të jetë pjesë e një programi më të gjerë të Drejtësisë tranzicionale, i cili mund të konsistojë në, *inter alia*, ndjekjet penale, komisionet e së vërtetës ose gjetet simbolike. Në këtë pikëpamje, verifikimi mund të veprojë si një kusht i mundësimit të llogaridhënies penale: përmes largimit të atyre që janë përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të cilët kësaj i kundërshtojnë ndryshimet, verifikimi, së këndejmi, në mënyrë të konsiderueshme e dobëson rezistencën ndaj hetimit dhe dënimit të abuzimeve.<sup>179</sup>

<sup>178</sup> Bruhman (2015)

<sup>179</sup> Bruhman (2015)

### Komplementariteti i mjeteve: reforma e forcave të armatosura në Salvador<sup>180</sup>

Nga viti 1980 e deri në vitin 1992, Salvadori ka pësuar një luftë civile midis qeverisë militare dhe lëvizjeve guerile FMLN. Lufta ka përfunduar në muajin janar të vitit 1992 me anë të një marrëveshje të paqes të negociuar e cila e ka pasur për qëllim vendosjen e demokracisë dhe tejkalimin e militarizmit. Që të arrihet kjo, janë futur në veprim dy mekanizma, përkatësisht Komisioni i sponsorizuar i KB-ve dhe Komisioni mbi të Vërtetën (Komisioni i së vërtetës) – të cilave iu është besuar analizimi dhe raportimi mbi krimet më të egra dhe që ka bërë rekomandime me karakter detyrimor – dhe Komisioni Ad Hoc (KAH), të cilit i është besuar detyra e verifikimit të trupave të oficerëve të forcave të armatosura. KAH e ka kryer verifikimin e forcave të armatosura në bazë të performancës në të kaluarën të secilit oficer dhe e ka përfshirë edhe kriterin e të drejtave të njeriut. Pas katër muajsh, KAH ka rekomanduar që 103 oficer të transferohen ose të lirohen dhe kjo ka qenë pothuajse plotësisht në përputhje.

## 31. Reforma institucionale përtej verifikimit: trajtimi i mangësive strukturale

### 31.1. Procesi i reformimit të strukturës së institucioneve publike: integriteti dhe ndërtimi i legjitimitetit

Përpos verifikimit, përpjekjet për të shmangur përsëritjen e shkeljeve në kontekstet post-konfliktuale do të zbatojnë reformat strukturale të ndërtimit të integritetit me qëllim që t'i bëjnë ato të qëndrueshme përmes standardeve të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Ky ndërtim i integritetit do të bëhet në dy rrjedha të ndryshme. Së pari, përmes ristrukturimit të institucioneve e me qëllim të sigurimit në legjitimitetin, integritetin dhe pavarësisë e tyre (përmes reformës së strukturave organizative, sistemeve të informimit dhe praktikave të menaxhimit), e me qëllim që besimi i qytetarëve në to do të rimëkëmbët. Në të vërtetë, mungesa e disa masave mbrojtëse strukturale (siç është ndarja efikase e pushteteve, ndërhyra partizaneske etj) e lehtëson kryerjen e abuzimeve dhe mungesën e llogaridhënies së institucioneve publike. Së dyti, masat do t'i kenë në shënjestër anëtarët individual të institucioneve përmes sigurimit të masave edukative (programet e trajnimit për zyrtarët publik dhe të punësuarit në lidhje me respektimin e standardeve ndërkombëtare)

<sup>180</sup> Mayer-rieckh & De Greiff (2007) ; Bruhman (2015)

për të rritur njohuritë dhe të kuptuarit e standardeve profesionale. Pos kësaj, masat e ndërtimit të legjitimitetit po ashtu do të merren me qëllim që riafirmojnë angazhimin e shtetit lidhur me trajtimin e trashëgimisë së abuzimeve, përkrahjen e standardeve ndërkombëtare të demokracisë dhe për njohjen e qytetarëve të vet si bartës të të drejtave. Kjo, në përgjithësi, bëhet përmes miratimit të ligjeve të reja dhe amendamenteve si dhe ratifikimit të traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>181</sup>

### 31.2. Sfidat specifike të Çarmatosjes, Demobilizimit dhe Reintegrimit (ÇDR) dhe Reformat e Sektorit të Sigurisë (RSS)

Për arsye se shumica e abuzimeve përgjithësisht janë kryer nga institucionet që e posedojnë shfrytëzimin e forcës, pra, forcat e sigurisë dhe grupet jo-shtetërore të armatosura si dhe për arsye se menaxhimi i këtyre institucioneve është një nga sfidat më të rënda në tranzicionin imediat, shumica e literaturës mbi reformën institucionale i është bashkëngjitur studimit të Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS). Si pjesë e RSS, një nga nismat më të hershme të sigurisë pas konfliktit njëmend do të jetë Çarmatimi, Demobilizimi dhe Reintegrimi (ÇDR) i ish forcave të armatosura dhe të paramilitarëve në shoqëri dhe potencialisht në institucionet e rregullta të shtetit. RSS po ashtu do të kërkojë për të implementuar demilitarizimin e sektorit të zbatimit të ligjit, limitimin e roleve të forcave të armatosura në funksione të jashtme mbrojtëse. Verifikimi do të jetë një mjet i RSS-së, me qëllim që të përjashtojë kriminelët nga shërbimi publik si dhe me qëllim që të ndërtojë integritetin dhe legjitimitetin e sistemit të sigurisë.<sup>182</sup>

Derisa verifikimi preokupohet me mangësitë e individëve, reforma institucionale përtej verifikimit e involvon këtë herë shikimin në mangësitë strukturale të institucioneve publike, në një mënyrë të ndryshme, por komplementare.

181 Mayer-rieckh & De Greiff (2007)

182 "Drejtesia Tranzicionale, RDGI, dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë, (2010), 'Transitional Justice, DDR, and Security Sector Reform' (2010)

## 32. Reforma institucionale në Kosovë

### 32.1. Besimi publik në institucionet e tyre: kriteri i vlerësimit të reformës institucionale

Në Kosovë reformat strukturale dhe ligjore janë realizuar në një kornizë kohore të menjëhershme pas konfliktit si pjesë e përpjekjeve të ndërtimit të shtetit, nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut e pastaj të EULEX-it. 'Divizioni fuqizues' i këtij të fundit ka qenë që të monitorojë, të mentorojë dhe të këshilloj homologët vendor në fushën e policisë, të drejtësisë dhe të doganave me qëllim që të ndihmojë institucionet përkatëse për të ndërmarrë reformat e domosdoshme në respektim të standardeve ndërkombëtarisht të njohura dhe të praktikave më të mira evropiane. Në këtë pikëpamje, të arriturat e Misionit janë lavdëruar relativisht. Që nga hyrja e tij në Kosovë, autoritetet e sundimit të ligjit kanë bërë një përparim substancial, në veçanti shërbimi i doganave dhe në Policia e Kosovës, të vlerësuar si shumë profesional dhe si një nga forcat policore më të besuara në rajon.<sup>183</sup> Merita për të arriturat e tilla kryesisht janë të Kosovës, por edhe ndihma e EULEX-it e ka rolin e vet.<sup>184</sup> Sidoqoftë, fusha e drejtësisë mbetet shumë sfiduese dhe shumë më pak progres është arritur në këtë fushë, në veçanti në lidhje me pavarësinë gjyqësore.<sup>185</sup>

Pos kësaj, reforma institucionale ende mungon në disa aspekte.<sup>186</sup> Ka pasur një proces jo të plotë të verifikimit dhe shumë nga liderët më të njohur politik të shqiptarëve etnik të Kosovës kanë luajtur rol aktiv në konfliktin e vitit 1999 si pjesëtarë të UÇK-së. Derisa për disa prej tyre janë ngritur aktakuza ose janë subjekt i hetimeve, shumë prej tyre thjesht kanë mbetur në pushtet dhe sot janë lider të njohur. Në kuptimin e rimëkëmbjes së besimit të qytetarëve në institucionet e tyre, duket se detyrat e mbetura aty janë të papërfunduara. Në njërën anë, perceptioni i institucioneve publike nga grupet minoritare nuk vlerësohet në favor të tyre. Shumica e serbëve etnik besojnë se ekziston një mungesë e vullnetit të njëmendët politik për të mbrojtur të drejtat e tyre, me gjithë sistemin e gjerë legjislativ dhe

183 Barometri i Korrupsionit Global (2013), Global Corruption Barometer (2013)

184 Broshurë e EULEX-it

185 "Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet institucionale dhe funksionale"(2012), 'Independence of the Judiciary in Kosovo: Institutional and Functional Dimensions' (2012)

186 "Raporti i progresit i Kosovës" (2014), 'Kosovo Progress Report' (2014)

institucional, i cili është ndërtuar për të siguruar një multi-etnicitet në Kosovë, por i cili mbetet pjesërisht i pazbatuar (siç është treguar nga qasja e vështirë e institucioneve dhe e informacioneve publike në gjuhën serbe).<sup>187</sup> Në anën tjetër, popullata etnike shqiptare po ashtu nuk i beson institucionet publike për shkak të skandaleve të përsëritura me korrupsionin. Besimi publik në institucionet e tyre ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në sondazhe duket të jetë, madje, në zvogëlim në muajin e fundit.<sup>188</sup>

#### Verifikimi në Kosovë – një proces joefikas dhe me të meta<sup>189</sup>

##### • Verifikimi në Kosovë është bazuar në dy ligje:

- Ligji Nr. 03/L-178 2010 mbi Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë - i cili përkufizon qëllimin dhe fushëveprimin e verifikimit, atë të kategorive për klasifikim të informatave dhe caktimin e autoritetit të verifikimit, AKI
  - Ligji Nr. 03/L-063 2008 mbi Agjencinë Kosovare të Inteligjencës (AKI) – puna e së cilës mbikëqyret nga Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje (KPM)
- **Çështja 1: hendeku i qasjes.** Pa faqe të internetit, pa zëdhënës, pa mekanizëm të ankesës në dispozicion.
  - **Çështja 2: praktikat nepotiste dhe klientiliste** janë shënuar si edhe keqpërdorimi i verifikimit për hakmarrje politike.
  - **Çështja 3: konflikti i interesit:** për të përmbushur detyrat e tyre, anëtarët e KPM kanë nevojë për dhënien e verifikimit të sigurisë mbi të cilat AKI ka diskrecion, që në praktikë çon deri te subordinimi i organeve legjislative ndaj agjencisë ekzekutive, me çka e shfuqizon kapacitetin e saj për të mbikëqyrë aktivitetet e saj.
  - **Çështja 4: implementimi i dobët i Ligjeve** ka qenë regjistruar, ngaqë individët e verifikuar në mënyrën më negative refuzojnë për të lëshuar pozitat e tyre dhe janë në proces të ankimit, ndërsa mungesa e burimeve paraqet mungesën e përpunimit të këtyre ankesave.
  - **Çështja 5: atmosfera politike** e mungesës së besimit, mungesa e bashkëpunimit dhe dhembja personale është duke e penguar procesin.

187 “Çlirimi i Kosovës: Sfidat e mbetura” (2012), Setting Kosovo free: Remaining Challenges’ (2012)

188 Raport i Pulsut Publik (Public Pulse report) (2015)

189 “Sistemi i verifikimit i Kosovës: Një rast për reformën e mëtejme” (2015), ‘Kosovo’s Vetting System: a Case for Further Reform’ (2015)

## 32.2. RSS në Kosovë: TMK, FSK dhe PK

Pas përfundimit të luftës, një nga preokupimet më urgjente ka qenë ripërkufizimi i rolit të UÇK-së. Forcat e armatosura ushtarake dhe ato civile të Kosovës kanë qenë instaluar nën mbikëqyrjen ndërkombëtare pas luftës dhe kanë shërbyer si një bazë për rifutjen e pothuajse 27.723 ish luftëtarëve të UÇK-së. Në njërin anë, ajo që sot është forcë policore e Kosovës ka qenë formuar nga UNMIK-u (që ka përfshirë një komponent të policisë) dhe është shndërruar në agjenci qeveritare të Kosovës pas vitit 2008. Policia e Kosovës vazhdon të perceptohet si një nga institucionet më të besuara të sundimit të ligjit në Kosovë.<sup>190</sup> Një nga të arriturat më të mëdha të saj ka qenë përfundimi i nismave të suksesshme për të përfaqësuar të gjitha komunitetet etnike në procesin e vendimmarrjes dhe në praktikën e caktimit të zyrtarëve policor serb në komunitetet pakicë, që ka rezultuar në nivelin në masë të madhe të përmirësuar të besimit në policinë.<sup>191</sup>

Në anën tjetër, Rezoluta 1244 e miratuar në muajin qershor të vitit 1999, e ka caktuar procesin e demilitarizimit dhe krijimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), një formacion civil trashëgues i UÇK-së me detyrën e dhënë, *inter alia*, në përgjigjen ndaj fatkeqësive natyrore, deminim dhe në projektet humanitare. Pas pavarësisë, TMK-ja është shpërbërë dhe është zëvendësuar nga Forca e re Sigurisë e Kosovës lehtë e armatosur (FSK). Pas verifikimit të kryer nga NATO-ja, rreth 1,400 ish pjesëtarëve të TMK-së iu është caktuara detyra në FSK. Janë ndërmarrë garanci të veçanta të rekrutimit me qëllim që ta bëjnë etnikisht më reprezentative e, megjithëkëtë, ndryshe nga suksesi i PK, garancitë e përfaqësimit të minoriteteve nuk janë aq të avancuara. Me gjithë mandatin e saj ekskluzivisht civil, çështja e një armate të Kosovës, sidoqoftë, nuk është jashtë tavolinës. Në muajin mars të vitit 2014, aso kohe kryeministër, Thaqi ka deklaruar se armata e tillë do të formohet nga viti 2019, me një karakter ekskluzivisht mbrojtës ngaqë Kosova nuk ka aspirata territoriale; as farë progresi deri tash nuk është arritur në lidhje me këtë çështje.

190 “Raporti i progresit i Kosovës” (2014), ‘Kosovo Progress Report’ (2014)

191 Bjelodh, Elek, dhe Raifi (2014)

Lidhja midis reformës institucionale dhe drejtësisë tranzicionale si tërësi është e dyfishtë: në njërin anë, fare mirë mund të jetë një kusht që i mundëson kushtet për masat e tjera të DT-së, me fjalë të tjera, komisionet e së vërtetës, ndjekjen penale ose reparacionet).<sup>192</sup> Në anën tjetër, vet reforma institucionale nuk do të jetë e mjaftueshme dhe duhet të jetë pjesë e një qasjeje holistike të DT-së.

192 'Instrumentet e sundimit të ligjit për shtetet post-konfliktuale: Verifikimi: një kornizë operacionale' (2006), Rule of Law Tools for Post-Conflict States: Vetting: an operational framework' (2006)

## KONKLUZA E PËRGJITHSHME

*'Njeriu nuk duhet të pres shumë nga drejtësia, për arsye se drejtësia është vetëm një nga aspektet e një qasjeje të shumanshme, e cila ka nevojë për të siguruar paqen në shoqëritë tranzicionale'.*<sup>193</sup>

Bazuar në pandehmën se një shoqëri post-konfliktuale duhet të merret me të kaluarën e saj, është e domosdoshme për të bartur atë drejt paqes dhe demokracisë, DT nuk mundet vetëm për të bërë caktimin e gabimeve të së kaluarës, por duhet të krijojë kushte për të ardhmen.<sup>194</sup> Së këndejmi, ajo është prapavështruese – në lidhje me faktin se ka nevojë të sjellë llogaridhënien, drejtësinë dhe të vërtetën për kaluarën – dhe paravështruese, duke i dhënë të mbijetuarve të konfliktit mjetet simbolike dhe materiale për të shkuar përpara – me anë të reparacioneve, reformave institucionale dhe nismave të pajtimit.

### *Ndjeshmëria e konteksteve post-simbolike*

Para se të vlerësojmë ndikimin e DT-së, njeriu ka nevojë për të përkujtuar se është së tepërmi e vështirë dhe e ndjeshme ndërmarrja e cila bëhet në një kontekst shumë kompleks, të paqëndrueshëm dhe të rimëkëmbjes. Krimet, me të cilat merret DT janë të një natyre të tillë mizore sa që procesi i adresimit të tyre pashmangshëm do të jetë i papërfunduar dhe frustrues. Shpresohet se pesha e tyre mund të lehtësohet, por nuk ka gjasë se një mekanizëm do të jetë i mjaftueshëm.<sup>195</sup> Jo vetëm kaq, të pritmet e viktimave pas konfliktit – kërkesa e tyre për drejtësi – janë të llojllojshme, për arsye se lufta i godet viktimat në shumë mënyra të ndryshme, dhe do të formësohen nga niveli dhe natyra e mizorive, zakonet kulturore dhe prirjet individuale. Derisa ato shpesh përfshijnë kërkesën për ndëshkim, ky angazhim drejt ndëshkimit as nuk është absolut e as universal dhe shpesh është i shoqëruar nga nevoja e fortë për asistencë materiale ose pranim simbolik. Drejtësia e rikthyer nga DT ka nevojë të jetë

193 Goldstone (1995-6)

194 Lambourne (2008)

195 Orentlicher (2010) ; Lambourne (2008)

e lidhur me të gjitha dimensionet e drejtësisë, për arsye se ato janë komplementare dhe reciprokisht fuqizuese.<sup>196</sup>

**DT: një ndërmarrje e shumanshme e cila kërkon një qasje të integruar**<sup>197</sup>

Në pajtim me këtë, është argumentuar përgjatë këtij manuali se nuk ka një qasje të vetme të tipit të librit të kaltër se si të implementohet DT-ja. Ky argument i bënë jehonë një evoluimi të mirëseardhur në fushën e DT-së përballë njohjes së rëndësisë së sekuencimit dhe të kontekstualizimit.<sup>198</sup> Në të vërtetë, kjo ese ka treguar se si DT ndryshon prej një vendi në tjetrin, disa prej të cilave në mënyrë mbizotëruese i zgjedhin amnistitë (Afrika e Jugut), të tjerat duke parapëlqyer qasjet hibride (Ruanda dhe Sierra Leone), ose më shumë qasje vendore (Uganda). Ndërsa parapëlqimi ende shkon për ndjekjet penale ndërkombëtare, shpesh kombinohet me më shumë mekanizma 'vendore' ose ndëshkuese, në një përpjekje për të tejkaluar dikotominë së tepërmi rigide, e cila ka mbizotëruar deri fare afër kohëve të fundit. Zbatimi i DT-së është duke u bërë më kreativ, udhëhequr nga komplementariteti midis mjeteve dhe me drejtën për të qenë kreativ.

### **Krijimi i besimit qytetar në Kosovë**

Në DT, një nga konceptet kyçe është ai i rimëkëmbjes së besimit qytetar pas konfliktit, me fjalë të tjera ideja dhe pranimi i të jetuarit bashkë brenda të njëjtit shtet të së drejtës. Krijimi i marrëdhënieve të tilla pozitive e kërkon besimin horizontal midis qytetarëve dhe besimin vertikal midis qytetarëve dhe institucioneve të tyre.<sup>199</sup> Të gjitha elementet e DT-së e kanë potencialin e përfshirjes së të vërtetës - *inter alia*, ndjekjeve penale, përmes riafirmimit se askush nuk është mbi ligjin, tregimit të së vërtetës përmes sinjalizimit të dëshirës për t'u bërë i pastër, reparacioneve që tregojnë se shkelja e të drejtave të qytetarëve merret seriozisht dhe verifikimi përmes mishërimit

196 García-Godo & Sriram (2013)

197 Degruson (2014)

198 Davis L. (2014)

199 Mayer-rieckh & De Greiff (2007)

të tranzicionit.<sup>200</sup> Megjithëkëtë, kontributi i tyre për arritjen deri te nocioni shumë i vështirë i pajtimit, në kuptimin e ndërtimit ose të rindërtimit të ndjenjës së pranimit në komunitet, varet nga shumë faktorë dhe, në veçanti, nga vullneti politik. Në Kosovë, edhe pse komb-ndërtimi përfundimisht ka figuruar në rindërtimin e post-konfliktit, ka qenë një sukses shumë i vogël në ndërtimin e besimit qytetar. Në anën tjetër, qytetarët thellësisht nuk i besojnë institucionet publike dhe politikanët, pavarësisht nga etniciteti i tyre. Në anën tjetër, midis komuniteteve të ndryshme etnike nuk ka ndjenjë të përkatësisë së njëjtit komb, për shkak të ndarjes fizike të komuniteteve dhe niveleve të larta të mosbesimit.<sup>201</sup> Kjo është posaçërisht e vërtetë tek është fjala për relacionet midis serbëve dhe shqiptarëve etnik, dy komuniteteve të cilat janë detyruar artificialisht t'i kundërvihen njëri-tjetrit nga luftërat e viteve '90-të, edhe pse ata kanë jetuar së bashku në Kosovë me shekuj. Duke e pranuar se nuk ka koncepte unitare të të qenit viktimë ose të *drejtësisë*, dhe, së këndejmi, përmes adresimit të nevojave të të gjithë të mbijetuarve të luftës, aktivitetet e DT-së të ngritura nga FDH Kosovë kanë për qëllim për të ndrequr këtë kundërvënie të konstruktuar dhe për t'i kontribuar pajtimit të komuniteteve më herët të kundërvëna në Kosovë, në mënyrë që ato të mund të parashikojnë një të ardhme të përbashkët.

200 De Greiff (2011)

201 "Çlirimi i Kosovës: Sfidat e mbetura" (2012), 'Setting Kosovo free: Remaining Challenges' (2012)